

32002L0083

Direktiva 2002/83/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 nëntor 2002, për sigurimin e jetës

Gazeta Zyrtare L 345 , 19/12/2002 fq. 0001 – 0051

Direktiva 2002/83/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 nëntor 2002, për sigurimin e jetës

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 47 paragrafi 2 dhe nenin 55 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit [3],

Meqë:

(1) Direktiva e parë e Këshillit 79/267/KEE, datë 5 mars 1979, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë të jetës [4], Direktiva e dytë e Këshillit 90/619/KEE, datë 8 nëntor 1990, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë të jetës, për parashikimin e dispozitave për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe për ndryshimin e Direktivës 79/267/KEE [5] dhe Direktiva e Këshillit 92/96/KEE, datë 10 nëntor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë të jetës dhe për ndryshimin e Direktivave 79/267/KEE dhe 90/619/KEE (Direktiva e tretë për sigurimin e jetës) [6] janë ndryshuar në mënyrë substanciale disa herë.

Duke qenë se duhen bërë shtesa dhe ndryshime të tjera, është mirë që këto direktiva të hartohen nga e para, për efekt të qartësisë.

(2) Për të mundësuar fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të jetës, është thelbësore të eliminohen disa divergjenca që ekzistojnë ndërmjet legjislacioneve kombëtare të mbikëqyrjes.

Për arritjen e këtij objektivi dhe, në të njëjtën kohë, për sigurimin e mbrojtjes adekuate të policëmbajtësve dhe përfituesve në të gjitha Shtetet Anëtare, është mirë të bashkërendohen dispozitat në lidhje me garancitë financiare që u kërkohen ndërmarrjeve të sigurimit të jetës.

(3) Është e nevojshme të plotësohet tregu i brendshëm i sigurimit të drejtpërdrejtë të jetës, nga këndvështrimi i së drejtës së vendosjes dhe i lirisë për të ofruar shërbime në Shtetet Anëtare, për t'ua bërë më të lehtë ndërmarrjeve me zyra qendrore brenda Komunitetit që të mbulojnë angazhimet që ndodhen brenda Komunitetit dhe për t'ua bërë të mundur policëmbajtësve t'u drejtohen jo vetëm siguruesve të vendosur në vendin e tyre por edhe siguruesve me zyra qendrore brenda Komunitetit dhe të vendosur në Shtete Anëtare të tjera.

(4) Në bazë të Traktatit, ndalohet çdo diskriminim sa i takon lirisë për të ofruar shërbime për shkak të faktit se një ndërmarrje nuk është e vendosur në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet.

Ky ndalim zbatohet për shërbimet e ofruara nga çdo subjekt i Komunitetit, pavarësisht nëse është zyrë qendrore e një ndërmarrjeje apo nëse është një agjenci apo një degë.

(5) Për rrjedhojë, kjo direktivë përbën një fazë të rëndësishme të bashkimit të tregjeve kombëtare në një treg të integruar, dhe kjo fazë duhet plotësuar me instrumente të tjera të Komunitetit, me qëllim që t'u jepet mundësia të gjithë policëmbajtësve t'i drejtohen çdo siguruesi me zyrë qendrore brenda Komunitetit i cili ushtron veprimtari brenda Komunitetit në kuadër të së drejtës së vendosjes apo lirisë për të ofruar shërbime, duke u garantuar në të njëjtën kohë mbrojtje adekuate.

(6) Kjo direktivë bën pjesë në tërësinë e legjislacionit të Komunitetit në fushën e sigurimit të jetës, ku përfshihet edhe Direktiva e Këshillit 91/674/KEE, datë 19 dhjetor 1991, për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjeve të sigurimeve [7].

(7) Qasja e ndjekur konsiston në realizimin e një harmonizimi të tillë që të jetë thelbësor, i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të arritur njohjen e ndërsjellë të autorizimeve dhe sistemeve të kontrollit të matur, duke bërë kështu të mundur lëshimin e një autorizimi të vetëm të vlefshëm në mbarë Komunitetin dhe zbatimin e parimit të mbikëqyrjes nga Shteti Anëtar i origjinës.

(8) Për pasojë, fillimi dhe ndjekja e veprimtarisë tregtare të sigurimit të jetës i nënshtrohen lëshimit të një autorizimi zyrtar të lëshuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ka zyrën qendrore ndërmarrja e sigurimeve. Ky autorizim i lejon ndërmarrjes të ushtrojë veprimtari tregtare në të gjithë Komunitetin, në kuadër të së drejtës së vendosjes ose të lirisë për të ofruar shërbime. Shteti Anëtar i degës ose Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet nuk mund t'u kërkojë autorizim të ri ndërmarrjeve të sigurimeve që duan të ushtrojnë veprimtarinë tregtare të sigurimit në atë shtet dhe që janë autorizuar më parë në Shtetin Anëtar të origjinës.

(9) Autoritetet kompetente është mirë të mos e autorizojnë ose të mos e vijnë autorizimin e një ndërmarrjeje sigurimesh kur ka të ngjarë të pengohen nga ushtrimi i efektshëm i funksioneve mbikëqyrëse nga lidhjet e ngushta ndërmjet ndërmarrjes dhe personave të tjerë fizikë ose juridikë. Ndërmarrjet e sigurimeve të autorizuar më parë duhet t'i bindin autoritetet kompetente edhe në këtë aspekt.

(10) Përkufizimi i "lidhjeve të ngushta" në këtë direktivë parashikon kriteret minimale dhe nuk i pengon Shtetet Anëtare që ta zbatojnë në situata të tjera nga ato që parashikohen në përkufizim.

(11) Vetëm fakti i marrjes së një përqindjeje të ndjeshme të kapitalit të një shoqërie tregtare nuk përbën pjesëmarrje, sipas kuptimit të "lidhjeve të ngushta", nëse kjo pjesëmarrje është marrë në pronësi me qëllimin e vetëm të investimit të përkohshëm, që nuk e bën të mundur ushtrimin e influencës mbi strukturën e politikës financiare të ndërmarrjes.

(12) Parimi i njohjes së ndërsjellë dhe parimi i mbikëqyrjes nga Shteti Anëtar i origjinës kërkojnë që autoritetet kompetente të atij Shteti Anëtar të mos lëshojnë autorizime ose të tërheqin autorizime, kur faktorë të tillë si përmbajtja e programeve të operacioneve apo shpërndarja gjeografike e veprimtarive të ushtruara faktikisht tregojnë qartë se ndërmarrja e sigurimeve ka zgjedhur sistemin ligjor të një Shteti Anëtar, me qëllim që t'u shmanget standardeve më të rrepta në fuqi në një Shtet Anëtar tjetër, në territorin e të cilit ushtron ose synon të ushtrrojë pjesën më të madhe të veprimtarive të veta. Ndërmarrja e sigurimeve duhet ta marrë autorizimin në Shtetin Anëtar ku ka selinë e regjistruar. Gjithashtu, Shtetet Anëtare duhet të kërkojnë që zyra qendrore e ndërmarrjes së sigurimeve të jetë gjithmonë në Shtetin Anëtar të origjinës dhe që të ushtrrojë faktikisht veprimtari tregtare atje.

(13) Për arsye praktike, është e dëshirueshme të përkufizohet ofrimi i shërbimeve duke marrë në konsideratë si Shtetin Anëtar ku është vendosur siguruesi ashtu edhe vendin ku pritet të mbulohet angazhimi. Për rrjedhojë, është mirë të përkufizohet edhe angazhimi. Për më tepër, është e dëshirueshme të bëhet dallimi ndërmjet veprimtarive të ndjekura përmes vendosjes dhe veprimtarive të ndjekura përmes lirisë për të ofruar shërbime.

(14) Është i nevojshëm një klasifikim sipas klasave të sigurimeve, për të përcaktuar sidomos veprimtaritë që i nënshtrohen autorizimit të detyrueshëm.

(15) Është mirë që nga objekti i kësaj direktive të përjashtohen disa fonde kolektive të cilat, për shkak të statusit ligjor, përmbushin kriteret në lidhje me garancitë dhe me dorëzanitë e tjera specifike financiare. Është mirë të përjashtohen edhe disa organizata të caktuara veprimtaria e të cilave mbulon vetëm një sektor shumë të kufizuar dhe është e kufizuar me statut.

(16) Sigurimi i jetës i nënshtrohet autorizimit zyrtar dhe mbikëqyrjes në çdo Shtet Anëtar. Është mirë të përkufizohen kushtet për dhënie ose tërheqjen e një autorizimi të tillë. Duhet parashikuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës në rast refuzimi apo tërheqjeje të një autorizimi të tillë.

(17) Është e dëshirueshme të sqarohen kompetencat dhe mjetet e mbikëqyrjes që u jepen autoriteteve kompetente. Është po ashtu e dëshirueshme të parashikohen dispozita specifike në lidhje me fillimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime.

(18) Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të origjinës është mirë të jenë përgjegjëse për monitorimin e gjendjes financiare të ndërmarrjeve të sigurimeve, duke përfshirë edhe aftësinë paguese, krijimin e provigjoneve teknike të mjaftueshme dhe mbulimin e këtyre provigjoneve me aktive të përputhura.

(19) Duhet parashikuar mundësia e shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve ose organeve që, për shkak të funksionit që kanë, ndihmojnë në fuqizimin e stabilitetit të sistemit financiar. Për të ruajtur natyrën konfidenciale të informacioneve të përcjella, lista e personave të cilëve u përcillen këto informacione duhet t'u nënshtrohet kufizimeve të rrepta.

(20) Disa sjellje të caktuara, siç janë krimi ekonomik dhe abuzimi me informacionin e marrë si person i brendshëm, kanë mundësi të ndikojnë në stabilitetin, duke përfshirë edhe paprekshmërinë, e sistemit financiar, edhe kur kanë të bëjnë me ndërmarrje që nuk janë ndërmarrje sigurimesh.

(21) Është e nevojshme të përcaktohen kushtet në bazë të të cilave autorizohen shkëmbimet e lartpërmendura të informacioneve.

(22) Kur parashikohet që informacioni mund të bëhet i ditur vetëm me pëlqimin e dhënë shprehimisht nga autoritetet kompetente, këto të fundit, sipas rastit, mund t'ia nënshtrojnë dhënien e pëlqimit përmbushjes së kushteve të rrepta.

(23) Shtetet Anëtare mund të lidhin marrëveshje për shkëmbim informacioni me vende të treta, me kusht që informacioni i dhënë të jetë objekt i garancive të duhura të sekretit profesional.

(24) Me qëllim fuqizimin e mbikëqyrjes së kujdesshme të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe mbrojtjen e klientëve të ndërmarrjeve të sigurimeve, është mirë të kërkohet që një auditues të ketë detyrimin për të bërë raportim menjëherë pranë autoriteteve kompetente sa herë që, sipas parashikimeve të kësaj direktive, mëson gjatë kryerjes së detyrave për fakte të caktuara që kanë të ngjarë të kenë pasoja të rënda për situatën financiare ose për organizimin administrativ dhe kontabël të ndërmarrjes së sigurimeve.

(25) Duke mbajtur parasysh synimin, është e dëshirueshme që Shtetet Anëtare të parashikojnë që një detyrim i tillë të zbatohet në të gjitha rrethanat kur audituesi zbulon fakte të tilla gjatë kryerjes së detyrave në një ndërmarrje që ka lidhje të ngushta me një ndërmarrje sigurimesh.

(26) Detyrimi i audituesve për të komunikuar, sipas rastit, pranë autoriteteve kompetente fakte të caktuara, dhe vendimet në lidhje me ndërmarrjen e sigurimeve të cilat i zbulojnë gjatë kryerjes së detyrave të tyre në një ndërmarrje jo sigurimesh, në vetvete nuk e ndryshon natyrën e detyrave në ndërmarrjen në fjalë dhe as mënyrën me të cilën duhet t'i realizojnë këto detyra në atë ndërmarrje.

(27) Kryerja e operacioneve të administrimit të fondeve të pensioneve të grupit në asnjë rrethanë nuk mund të cenojë kompetencat që u janë dhënë autoriteteve përkatëse në lidhje me subjektet që i zotërojnë aktivet me të cilat lidhet administrimi.

(28) Disa dispozita të caktuara të kësaj direktive përcaktojnë standarde minimale. Shteti Anëtar i origjinës mund të parashikojë rregulla më të forta për ndërmarrjet e sigurimeve që autorizojnë autoritetet kompetente të tij.

(29) Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar duhet të kenë në dispozicion mjete të tilla të mbikëqyrjes, të nevojshme për të siguruar ndjekjen e rregullt të veprimtarisë tregtare nga ndërmarrjet e sigurimeve në të gjithë Komunitetin, pavarësisht nëse ushtrohen në kuadër të së drejtës së vendosjes apo në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime. Në veçanti, ato duhet të jenë në gjendje të miratojnë masat e duhura mbrojtëse ose të vendosin sanksione, me synim parandalimin e parregullsive dhe shkeljeve të dispozitave për mbikëqyrjen e sigurimeve.

(30) Është mirë që dispozitat për transferimin e portofolave të përfshijnë në mënyrë specifike dispozita për transferimin tek një ndërmarrje tjetër e portofolit të kontratave të lidhura në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime.

(31) Dispozitat për transferimin e portofolave duhet të jenë në përputhje me sistemin e vetëm të autorizimit ligjor që parashikon kjo direktivë.

(32) Është mirë që ndërmarrjet e themeluara pas datave të përmendura në nenin 18 pika 3, të mos lejohen të ushtrojnë njëkohësisht veprimtari të sigurimit jetë dhe jo-jetë. Është mirë të lejohen Shtetet Anëtare t'i lejojnë ndërmarrjet që, më datat përkatëse të përmendura në nenin 18 pika 3, i ushtrojnë këto veprimtari, të vazhdojnë t'i ushtrojnë ato njëkohësisht, me kusht që për secilën prej veprimtarive të ngrenë administrim më vete, në mënyrë që të mbrohen interesat përkatëse të policëmbajtësve jetë dhe policëmbajtësve jo-jetë dhe që detyrimet minimale financiare në lidhje me njërën prej veprimtarive të mos i mbajë veprimtaria tjetër. Është mirë t'u jepet Shteteve Anëtare mundësia që t'u kërkojnë ndërmarrjeve ekzistuese të vendosura në territorin e tyre që ushtrojnë njëkohësisht veprimtari të sigurimit jetë dhe jo-jetë t'i japin fund kësaj praktike. Gjithashtu, është mirë që ndërmarrjet e specializuara t'i nënshtrohen një mbikëqyrjeje të posaçme kur ndërmarrja jo-jetë i përket të njëjtit grup financiar ku bën pjesë edhe ndërmarrja jetë.

(33) Asnjë parashikim i kësaj direktive nuk e pengon ndërmarrjen e përbërë që të ndahet në dy ndërmarrje të reja, ku njëra të ushtrojë veprimtari në fushën e sigurimit të jetë, ndërsa tjetra në fushën e sigurimeve jo-jetë. Për të lejuar realizimin e një ndarjeje të tillë në kushte sa më të mira, është e dëshirueshme të lejohen Shtetet Anëtare që, në përputhje me rregullat e legjislacionit të Komunitetit për konkurrencën, të parashikojnë masa organizative tatimore të duhura, sidomos në lidhje me fitimin kapital që mund të lindë nga kjo ndarje.

(34) Ato Shtete Anëtare që dëshirojnë të veprojnë në këtë mënyrë është mirë t'i japin të njëjtës ndërmarrje autorizime për klasat e përmendura në Shtojcën I dhe për veprimtarinë e sigurimeve që bie në klasat 1 dhe 2 të Shtojcës së Direktivës së Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës [8]. Por kjo mundësi mund t'u nënshtrohet kushteve të caktuara në lidhje me përmbushjen e rregullave të kontabilitetit dhe rregullave për mbylljen e veprimtarisë tregtare.

(35) Është e nevojshme, nga këndvështrimi i mbrojtjes së jetës së siguruar, që çdo ndërmarrje sigurimesh të krijojë provigjone të mjaftueshme teknike. Llogaritja e provigjoneve të tilla bazohet, në pjesën më të madhe, në parimet aktuariale. Është mirë të bashkërendohen këto parime në mënyrë që të mundësohet njohja e ndërsjellë e rregullave të maturisë të zbatueshme në Shtete Anëtare të ndryshme.

(36) Është e dëshirueshme që, në interes të maturisë, të arrihet një minimum bashkërendimi i rregullave që e kufizojnë normën e interesit të përdorur në llogaritjen e provigjoneve teknike. Në funksion të këtij kufizimi, duke qenë se metodat ekzistuese janë njësoj të sakta, të kujdesshme dhe të barasvlershme, duket se zgjidhja e duhur është t'i lihet në dorë Shtetit Anëtar ta zgjedhë vetë metodën që do të përdoret.

(37) Duhet bashkërenduar rregullat që rregullojnë llogaritjen e provigjoneve teknike dhe rregullat që rregullojnë përhapjen, vendndodhjen dhe përputhjen e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike në mënyrë që të mundësohet njohja e ndërsjellë e rregullave të Shteteve Anëtare. Ky bashkërendim duhet të marrë në konsideratë liberalizimin e lëvizjes së kapitalit të parashikuar me nenin 56 të Traktatit dhe progresin e arritur nga Komuniteti në lidhje me bashkimin ekonomik dhe monetar.

(38) Shteti Anëtar i origjinës nuk mund t'u kërkojë ndërmarrjeve të sigurimeve t'i investojnë aktivet në mbulim të provigjoneve teknike në kategori të veçanta aktivesh, ngaqë një kërkesë e tillë nuk do të ishte në përputhje me liberalizim e lëvizjeve të kapitalit të parashikuara me nenin 56 të Traktatit.

(39) Është e nevojshme që, mbi nivelin e provigjoneve teknike, duke përfshirë edhe provigjonet matematikore, me vlerë të mjaftueshme për të shlyer përgjegjësitë e kontraktuara, ndërmarrjet e sigurimeve të kenë një rezervë shtesë, e njohur si niveli i aftësisë paguese, që përbëhet nga aktive të lira dhe, me pëlqimin e autoritetit kompetent, nga aktive të tjera të nënkuptuara, i cili vepron si rezervë mbrojtëse nga luhajtjet e padëshirueshme të veprimtarisë tregtare. Kjo kërkesë është një element i rëndësishëm i mbikëqyrjes së kujdesshme për mbrojtjen e personave të siguruar dhe policëmbajtësve. Për të siguruar që kërkesat e vendosura me këtë qëllim janë përcaktuar sipas kriterëve objektive, sipas të cilave ndërmarrjet me madhësi të njëjtë vendosen në të njëjtat kushte sa i takon konkurrencës, është e dëshirueshme të parashikohet që ky nivel të lidhet me të gjitha angazhimet e ndërmarrjes dhe me natyrën dhe shkallën e risqeve që paraqesin veprimtaritë e ndryshme që mbulon objekti i kësaj direktive. Për rrjedhojë, është mirë që ky nivel të ndryshojë sipas rastit nëse risku është risk investimi, risk i vdekjes apo risk i administrimit. Për këtë, është mirë të përcaktohet si provigjone matematikore dhe kapital i rrezikuar i marrë në sigurim nga ndërmarrja, si prime ose kontribute të arkëtuara, si provigjone vetëm ose si aktive.

(40) Direktiva 92/96/KEE parashikonte një përkufizim të përkohshëm për tregun e rregulluar, në pritje të miratimit të një direktive për shërbimet e investimeve në fushën e letrave me vlerë, e cila do ta harmonizonte këtë koncept në nivelin e Komunitetit. Direktiva e Këshillit 93/22/KEE, datë 10 maj 1993, për shërbimet e investimeve në fushën e letrave me vlerë [9] parashikon një përkufizim për tregun e rregulluar, edhe pse e përjashton atë nga objekti i saj për veprimtaritë e

sigurimit të jetës. Zgjidhja e duhur është të zbatohet koncepti i tregut të rregulluar edhe për veprimtaritë e sigurimit të jetës.

(41) Lista e zërave të nevojshëm për nivelin e aftësisë paguese që kërkohet me këtë direktivë mund të marrë në konsideratë instrumentet e reja financiare dhe instrumentet e financimit që u jepen institucioneve të tjera financiare për krijimin e fondeve të tyre. Në dritën e zhvillimeve të tregut për natyrën e mbulimit me risigurim të blerë nga siguruesit parësorë, ekziston nevoja që autoriteteve kompetente t'u jepet tagri për ta zvogëluar kërkesën për nivelin e aftësisë paguese në disa rrethana të caktuara. Për ta përmirësuar cilësinë e nivelit të aftësisë paguese, është mirë të kufizohet dhe të kushtëzohet mundësia e përfshirjes së fitimeve të ardhshme në nivelin e aftësisë paguese të disponueshme, dhe kjo mundësi në çdo rast është mirë të hiqet pas vitit 2009.

(42) Është e nevojshme të kërkohet një fond garancie, vlera dhe përbërja e të cilit të jenë të tilla që të ofrojnë garanci, se ndërmarrjet zotërojnë burime të mjaftueshme në momentin e themelimit dhe se në rrjedhën e mëpasshme të veprimtarisë tregtare niveli i aftësisë paguese nuk do të bjerë në asnjë rast nën minimumin e sigurisë. I gjithë ky fond garancie ose një pjesë e përcaktuar e tij duhet të përbëhet nga zëra aktivësh të shprehura.

(43) Për të shmangur rritjet e mëdha e të menjëhershme të vlerës së fondit minimal të garancisë në të ardhmen, është mirë të ngrihet një mekanizëm i cili ta parashikojë këtë rritje në përputhje me indeksin europian të çmimeve të konsumit. Është mirë që kjo direktivë të vendosë standarde minimale për kërkesat e nivelit të aftësisë paguese dhe që Shtetet Anëtare të mund të vendosin rregulla më të forta për ndërmarrjet e sigurimeve të autorizuar nga autoritetet e tyre kompetente.

(44) Dispozitat në fuqi në Shtetet Anëtare, në lidhje me legjislacionin e kontratës të zbatueshëm për veprimtaritë e përmendura në këtë direktivë, ndryshojnë nga shteti në shtet. Harmonizimi i legjislacionit të kontratave të sigurimeve nuk është kusht paraprak për arritjen e tregut të brendshëm të sigurimeve. Për rrjedhojë, ka të ngjarë që mundësia që u është dhënë Shteteve Anëtare për të vendosur zbatimin e legjislacionit të tyre për kontratat e sigurimeve që mbulojnë angazhime në territorin e tyre siguron masa mbrojtëse adekuate për policëmbajtësit. Në disa raste të caktuara, mund të jepet liria për të zgjedhur si legjislacion të zbatueshëm për kontratën një legjislacion të ndryshëm nga ai i shtetit të angazhimit, në përputhje me rregullat që marrin në konsideratë rrethanat specifike.

(45) Për kontratat e sigurimit të jetës, është mirë që policëmbajtësit t'i jepet mundësia e anulimit të kontratës brenda një afati nga 14 deri në 30 ditë.

(46) Në kuadër të tregut të brendshëm është në interesin e policëmbajtësit që të ketë mundësi shfrytëzimi të një game sa më të gjerë produktesh sigurimi brenda Komunitetit, në mënyrë që të mund të zgjedhë atë produkt që u përshtatet më mirë nevojave të tij. I takon Shtetit Anëtar të angazhimit të sigurojë që të mos ketë asgjë që ta pengojë marketingun në territorin e tij të të gjitha produkteve të sigurimit të ofruara për shitje brenda Komunitetit, për aq sa këto produkte nuk bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi që mbrojnë të mirën e përgjithshme në Shtetin Anëtar të angazhimit, dhe për aq sa e mira e përgjithshme nuk mbrohet me rregullat e Shtetit Anëtar të origjinës, me kusht që dispozita të tilla të zbatohen pa asnjë diskriminim për të gjitha

ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në atë Shtet Anëtar dhe që të jenë objektivisht të nevojshme dhe proporcionale me objektivin që kërkohet të arrihet.

(47) Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të sigurojnë që produktet e sigurimeve dhe dokumentet e kontratave, të përdorura në kuadër të së drejtës së vendosjes apo të lirisë për të ofruar shërbime, që mbulojnë angazhime brenda territorit të tyre, të respektojnë dispozitat e zbatueshme specifike ligjore që mbrojnë të mirën e përgjithshme. Sistemet e mbikëqyrjes që kërkohet të përdoren duhet të përmbushin kërkesat e tregut të brendshëm, por përdorimi i tyre nuk mund të përbëjë kusht paraprak për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të sigurimeve. Nga ky këndvështrim, duket se nuk justifikohen sistemet për aprovimin paraprak të kushteve të policave. Për rrjedhojë, është e nevojshme të parashikohen sisteme të tjera të përshtatura më mirë me kërkesat e një tregu të brendshëm të cilat t'i japin mundësi çdo Shteti Anëtar t'u garantojë mbrojtje adekuate policëmbajtësve.

(48) Është e nevojshme që të parashikohet një bashkëpunim ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare dhe midis autoriteteve në fjalë dhe Komisionit.

(49) Është mirë të parashikohet një sistem sanksionesh për t'u vendosur atëherë kur, në Shtetin Anëtar ku ndodhet angazhimi, ndërmarrja e sigurimeve nuk i zbaton dispozitat që mbrojnë të mirën e përgjithshme e të cilat janë të zbatueshme për të.

(50) Është e nevojshme të parashikohen masa në rastet kur pozicioni financiar i ndërmarrjes bëhet i tillë që e bën të vështirë përmbushjen e përgjegjësisë të kontraktuara. Në situatat specifike ku vihen në rrezik të drejtat e policëmbajtësve, ekziston nevoja që autoriteteve kompetente t'u jepet tagri të ndërhyjnë në një fazë mjaftueshmërisht të hershme, por gjatë ushtrimit të këtij tagri, është mirë që autoritetet kompetente t'i informojnë ndërmarrjet e sigurimeve për arsyet që e motivojnë një veprim të tillë mbikëqyrës, në përputhje me parimet e administrimit të shëndoshë dhe të procesit të rregullt. Është mirë që, sa kohë ekziston një situatë e tillë, autoriteteve kompetente të mos u lejohet të certifikojnë se ndërmarrja e sigurimeve e ka nivelin e mjaftueshëm të aftësisë paguese.

(51) Me qëllim zbatimin e parimeve aktuariale në përputhje me këtë direktivë, Shteti Anëtar i origjinës mund të kërkojë njoftimin sistematik të bazave teknike të përdorura për llogaritjen e shkallëve të primeve dhe të provigjoneve teknike, ku nga ky njoftim i tillë i bazave teknike të përjashtohet informacioni për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të policave dhe për shkallët tregtare të ndërmarrjes.

(52) Në një treg të brendshëm të sigurimeve, konsumatori do të ketë një mundësi më të gjerë dhe të shumëllojshme zgjedhjeje të kontratave. Nëse dëshiron të përfitojë plotësisht nga kjo larmi dhe nga rritja e konkurrencës, konsumatorit duhet t'i jepen të gjitha informacionet e nevojshme për t'i dhënë mundësi të zgjedhë atë kontratë që u përshtatet më mirë nevojave të tij a të saj. Kjo kërkesë për informim merr edhe më shumë rëndësi për shkak të faktit se periudha e angazhimeve mund të jetë shumë e gjatë. Prandaj, duhen bashkërenduar dispozitat minimale në mënyrë që konsumatori të marrë informacion të qartë dhe të saktë për karakteristikat thelbësore të produkteve që i propozohen, si edhe për organet ku mund të bëhen ankesat e policëmbajtësve, personave të siguruar ose përfituesve të kontratave.

(53) Publiciteti i produkteve të sigurimeve është një mjet thelbësor për të mundësuar ushtrimin e efektshëm të veprimtarisë tregtare të sigurimeve brenda Komunitetit. Është e nevojshme që t'u lihet e hapur mundësia ndërmarrjeve të sigurimeve që të përdorin të gjitha mjetet normale të publicitetit në Shtetin Anëtar të degës ose në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë respektimin e rregullave kombëtare të tyre në lidhje me formën dhe përmbajtjen e publicitetit, pavarësisht nëse këto rregulla janë parashikuar në përputhje me legjislacionin e Komunitetit për publicitetin apo janë miratuar nga Shtetet Anëtare për arsye të së mirës së përgjithshme.

(54) Brenda kuadrit të tregut të brendshëm, asnjë Shtet Anëtar nuk mund të vazhdojë të ndalojë ushtrimin e njëkohshëm të veprimtarisë së sigurimeve në territorin e tij në kuadër të së drejtës së vendosjes dhe të lirisë për të ofruar shërbime.

(55) Disa Shtete Anëtare nuk ia nënshtrojnë transaksionet e sigurimeve asnjë forme tatimi të tërthortë, ndërsa shumica e Shteteve Anëtare zbatojnë tatime të posaçme dhe forma të tjera kontributi. Strukturat dhe shkallët e tatimeve dhe kontributeve të tilla ndryshojnë ndjeshëm nga njëri Shtet Anëtar ku zbatohen në tjetrin. Është e dëshirueshme të parandalohen dallimet ekzistuese që sjellin shtrembërim të konkurrencës në shërbimet e sigurimeve ndërmjet Shteteve Anëtare. Në pritje të harmonizimit të mëposhëm, zbatimi i sistemeve tatimore dhe i formave të tjera të kontributit të parashikuara nga Shtetet Anëtare ku është marrë përsipër angazhimi, ka të ngjarë ta korrigjojnë problemin në fjalë dhe u takon Shteteve Anëtare të marrin masat organizative për të siguruar mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve të tilla.

(56) Është e rëndësishme të bëhet bashkërendimi në nivel komuniteti i mbylljes së veprimtarisë së ndërmarrjeve të sigurimeve. Për këtë arsye, është thelbësore të parashikohet që, në rastin e mbylljes së veprimtarisë së ndërmarrjes së sigurimeve, sistemi i mbrojtjes i ngritur në secilin Shtet Anëtar të garantojë barazinë në trajtim për të gjithë kreditorët e sigurimeve, pavarësisht nga shtetësia dhe nga mënyra e marrjes përsipër të angazhimit.

(57) Rregullat e bashkërenduara në lidhje me ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimeve të drejtpërdrejta brenda Komunitetit është mirë që, në parim, të zbatohen për të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në treg dhe, rrjedhimisht, edhe për agjencitë dhe degët në rastet kur zyra qendrore e ndërmarrjes ndodhet jashtë Komunitetit. Sa u takon mënyrave të mbikëqyrjes, në këtë direktivë parashikohen dispozita të posaçme për këto agjenci dhe degë, duke mbajtur parasysh faktin se aktivet e ndërmarrjeve të cilave u përkasin ndodhen jashtë Komunitetit.

(58) Është e dëshirueshme të parashikohet lidhja e marrëveshjeve të ndërsjella me një a më shumë vende të treta, në mënyrë që të mundësohet lehtësimi i kushteve të tilla të posaçme, duke respektuar në të njëjtën kohë parimin se agjenci dhe degë të tilla nuk duhet të përfitojnë trajtim më favorizues se ndërmarrjet e Komunitetit.

(59) Është mirë të parashikohet një procedurë më fleksibile për të mundësuar vlerësimin e reciprocitetit me vendet e treta në bazë Komuniteti. Synimi i kësaj procedure nuk është mbyllja e tregjeve financiare të Komunitetit, por, duke qenë se Komuniteti synon t'i mbajë të hapura tregjet e veta financiare për të gjithë botën, duhet të jetë rritja e liberalizimit të tregjeve financiare botërore në vendet e treta. Për këtë qëllim, në këtë

direktivë parashikohen procedurat për negocimin me vendet e treta.

(60) Është mirë që kjo direktivë të vendosë dispozita në lidhje me vërtetimin për reputacionin e mirë dhe mospasjen e procedurave të falimentimit në të shkuarën.

(61) Në mënyrë që të sqarohet regjimi juridik i zbatueshëm për veprimtaritë e sigurimit të jetës që mbulon kjo direktivë, është mirë të përshtaten disa dispozita të Direktivave 79/267/KEE, 90/619/KEE dhe 92/96/KEE. Për këtë qëllim, është mirë të ndryshohen disa dispozita që kanë të bëjnë me vendosjen e nivelit të aftësisë paguese dhe me të drejtat e fituara nga degët e ndërmarrjeve të sigurimeve të krijuara përpara datës 1 korrik 1994. Është mirë të përcaktohet edhe përmbajtja e skemës së operacioneve të degëve të ndërmarrjeve të vendeve të treta që kërkojnë të vendosen brenda Komunitetit.

(62) Mund të dalë nevoja që, herë pas here, t'u bëhen rregullime teknike rregullave të hollësishme të parashikuara në këtë direktivë, për të marrë në konsideratë zhvillimin e ardhshëm të sektorit ekonomik të sigurimeve. Komisioni do t'i bëjë këto rregullime sipas nevojës, pasi të konsultohet me Komitetin për Sigurimet të krijuar me Direktivën e Këshillit 91/675/KEE [11], në ushtrim të kompetencave zbatuese të cilat ia jep Traktati.

(63) Sipas nenit 15 të Traktatit, është mirë të mbahet parasysh shkalla e përpjekjeve që u duhet të bëjnë disa ekonomive që ndodhen në faza të ndryshme zhvillimi.

(64) Direktivat 79/267/KEE dhe 90/619/KEE parashikonin përjashtime të posaçme në lidhje me disa ndërmarrje ekzistuese në momentin e miratimit të dispozitave në fjalë. Këto ndërmarrje e kanë modifikuar më pas strukturën e tyre. Për rrjedhojë, nuk e kanë më të nevojshëm një përjashtim të tillë të posaçëm.

(65) Është mirë që kjo direktivë të mos prekë detyrimet e Shteteve Anëtare në lidhje me afatet e shndërrimit të saj në legjislacion të brendshëm dhe për zbatimin e direktivave të parashikuara në Shtojcën V seksioni "B",

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

PËRMBAJTJA

TITULLI I

PËRKUFIZIME DHE FUSHËVEPRIMI 10

Neni 1 Përkufizime 10

Neni 2 Fushëveprimi 11

Neni 3 Veprimtaritë dhe organet e përjashtuara 11

TITULLI II

FILLIMI I VEPRIMTARISË TREGTARE TË SIGURIMIT TË JETËS 12

- Neni 4 Parimi i autorizimit 12
- Neni 5 Fushëveprimi i autorizimit 12
- Neni 6 Kushtet për marrjen e autorizimit 12
- Neni 7 Skema e operacioneve 13
- Neni 8 Aksionarët dhe ortakët me pjesëmarrje influencuese 14
- Neni 9 Refuzimi i autorizimit 14

TITULLI III

KUSHTET QË RREGULLOJNË VEPRIMTARINË TREGTARE TË SIGURIMEVE 14

- Kreu 1 Parimet dhe metodat e mbikëqyrjes financiare 14
- Neni 10 Autoritetet kompetente dhe objekti i mbikëqyrjes 14
- Neni 11 Mbikëqyrja e degëve të vendosura në një Shtet Anëtar tjetër 14
- Neni 12 Ndalimi i cedimit të detyrueshëm të një pjese të marrjes në sigurim 14
- Neni 13 Informacionet e kontabilitetit, maturisë dhe statistikave: kompetencat mbikëqyrëse 14
- Neni 14 Transferimi i portofolit 15
- Neni 15 Pjesëmarrja influencuese 15
- Neni 16 Sekretet profesional 16
- Neni 17 Detyrimet e audituesve 18
- Neni 18 Ndjekja e veprimtarive të sigurimeve jetë dhe jo-jetë 18
- Neni 19 Veçimi i administrimit të sigurimeve jetë dhe jo-jetë 19
- Kreu 2 Rregullat e lidhura me provigjonet teknike dhe paraqitjen e tyre 19
- Neni 20 Krijimi i provigjoneve teknike 19
- Neni 21 Primet për veprimtaritë e reja tregtare 21
- Neni 22 Aktivitetet në mbulim të provigjoneve teknike 21
- Neni 23 Kategoritë e aktiveve të lejuara 21
- Neni 24 Rregullat për diversifikimin e investimeve 22
- Neni 25 Kontratat që kanë lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm ose me indeksin e aksioneve 23
- Neni 26 Rregullat e përputhjes 24
- Kreu 3 Rregullat në lidhje me nivelin e aftësisë paguese dhe fondin e garancisë 24
- Neni 27 Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese 24
- Neni 28 Niveli i kërkuar i aftësisë paguese 25
- Neni 29 Fondi i garancisë 26
- Neni 30 Shqyrtimi i shumës së fondit të garancisë 26
- Neni 31 Aktivitetet që nuk përdoren në mbulim të provigjoneve teknike 26
- Kreu 4 Legjislacioni që zbatohet për kontratën dhe kushtet e sigurimit 27
- Neni 32 Legjislacioni i zbatueshëm 27
- Neni 33 E mira e përgjithshme 27
- Neni 34 Rregullat në lidhje me kushtet e sigurimit dhe shkallët e primeve 27
- Neni 35 Afati i anulimit 27
- Neni 36 Informimi i policëmbajtësve 27
- Kreu 5 Ndërmarrjet e sigurimeve në situatë të vështirë ose në situatë parregullsie 28
- Neni 37 Ndërmarrjet e sigurimeve në vështirësi 28
- Neni 38 Plani i rimëkëmbjes financiare 28

Neni 39 Tërheqja e autorizimit 29

TITULLI IV
DISPOZITAT E LIDHURA ME TË DREJTËN E VENDOSJES DHE LIRINË PËR TË
OFRUAR SHËRBIME 29

Neni 40 Kushtet për vendosjen e degës 29

Neni 41 Liria për të ofruar shërbime: njoftimi paraprak drejtuar Shtetit Anëtar të origjinës 30

Neni 42 Liria për të ofruar shërbime: njoftimi nga Shteti Anëtar i origjinës 30

Neni 43 Liria për të ofruar shërbime: ndryshimet në natyrën e angazhimeve 30

Neni 44 Gjuha 30

Neni 45 Rregullat në lidhje me kushtet e sigurimit dhe shkallët e primeve 30

Neni 46 Ndërmarrjet e sigurimeve që nuk i respektojnë dispozitat ligjore 30

Neni 47 Publiciteti 31

Neni 48 Mbyllja e veprimtarisë 31

Neni 49 Informacioni statistikor për veprimtaritë ndërkufitare 31

Neni 50 Tatimet mbi primin 31

TITULLI V
RREGULLAT E ZBATUESHME PËR AGJENCITË OSE DEGËT E VENDOSURA BRENDË
KOMUNITETIT QË U PËRKASIN NDËRMARRJEVE ME ZYRA QENDRORE JASHTË
KOMUNITETIT

Neni 51 Parimet dhe kushtet e autorizimit 32

Neni 52 Rregullat e zbatueshme për degët e ndërmarrjeve të vendeve të treta 32

Neni 53 Transferimi i portofolit 33

Neni 54 Provigjonet teknike 33

Neni 55 Niveli i aftësisë paguese dhe fondi i garancisë 33

Neni 56 Përparësitë për ndërmarrjet e autorizuar në më shumë se një Shtet Anëtar 34

Neni 57 Marrëveshjet me vendet e treta 34

TITULLI VI
RREGULLAT E ZBATUESHME PËR FILIALET E NDËRMARRJEVE MËMA QË
RREGULLOHEN NGA LIGJET E NJË VENDI TË TRETË DHE RREGULLAT E
ZBATUESHME PËR MARRJEN NË PRONËSI TË PJESËMARRJEVE NGA ANA E
NDËRMARRJEVE MËMA TË LARTPËRMENDURA 34

Neni 58 Informacioni që Shtetet Anëtare i japin Komisionit 34

Neni 59 Trajtimi që u bëjnë vendet e treta ndërmarrjeve të sigurimeve të Komunitetit 34

TITULLI VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË TJERA 35

Neni 60 Përjashtime dhe heqja e masave kufizuese 35

Neni 61 Vërtetimi për reputacionin e mirë 35

TITULLI VIII DISPOZITA TË FUNDIT 36

- Neni 62 Bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit 36
- Neni 63 Raportet për zhvillimin e tregut në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime 36
- Neni 64 Rregullimi teknik 36
- Neni 65 Procedura e Komitetit 36
- Neni 66 Të drejtat e fituara nga degët dhe ndërmarrjet ekzistuese të sigurimeve 36
- Neni 67 E drejta për t'iu drejtuar gjykatës 37
- Neni 68 Shqyrtimi i shumave të shprehura në euro 37
- Neni 69 Zbatimi i dispozitave të reja 37
- Neni 70 Informacioni që i jepet Komisionit 37
- Neni 71 Periudha kalimtare për nenin 3 pika 6 dhe nenet 27, 28, 29, 30 dhe 38 37
- Neni 72 Direktivat e shfuqizuara dhe korrelacioni i tyre me këtë direktivë 37
- Neni 19 Hyrja në fuqi 38
- Neni 74 Entiteteve të cilave u drejtohet kjo direktivë 38

Shtojca I Klasat e sigurimeve 39

Shtojca II Rregullat e përputhjes 39

Shtojca III Informimi i policëmbajtësve 40

Shtojca IV 41

Shtojca V 45

Pjesa A Direktivat e shfuqizuara së bashku me shtesat dhe ndryshimet e njëpasnjëshme të tyre (të përmendura në nenin 72) 45

Pjesa B Afatet për zbatimin (të përmendura në nenin 72) 45

Shtojca VI Tabela e korrelacionit 46

TITULLI I PËRKUFIZIMET DHE FUSHA E VEPRIMIT

Neni 1 **Përkufizime**

1. Për qëllimet e kësaj direktive:

(a) "ndërmarrja e sigurimeve" është ndërmarrja që ka marrë autorizimin zyrtar në përputhje me nenin 4;

(b) "dega" është agjenci ose degë e ndërmarrjes së sigurimeve;

Çdo prezencë e përhershme e një ndërmarrjeje në territorin e një Shteti Anëtar trajtohet në të njëjtën mënyrë me të cilën trajtohet një agjenci apo degë, edhe sikur kjo prezencë të mos marrë formën e një dege apo agjencie, por të konsistojë vetëm në një zyrë të administruar nga personeli i vetë ndërmarrjes ose nga një person i pavarur por me autoritet të përhershëm për të vepruar për llogari të ndërmarrjes, njësoj siç do të vepronte edhe një agjenci;

(c) "subjekti" është zyra qendrore, agjencia ose dega e ndërmarrjes;

(d) "angazhimi" është angazhimi i paraqitur në formën e njërit prej llojeve të sigurimeve ose operacioneve të përmendura në nenin 2;

(ç) "Shteti Anëtar i origjinës" është Shteti Anëtar ku ndodhet zyra qendrore e ndërmarrjes së

sigurimeve që mbulon angazhimin;

(f) "Shteti Anëtar i degës" është Shteti Anëtar ku ndodhet dega që mbulon angazhimin;

(g) "Shteti Anëtar i angazhimit" është Shteti Anëtar ku ka vendbanim e përhershëm policëmbajtësi ose, nëse policëmbajtësi është person juridik, Shteti Anëtar ku ndodhet subjekti i tij me të cilin ka të bëjë kontrata;

(h) "Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet" është Shteti Anëtar i angazhimit, nëse angazhimin e mbulon një ndërmarrje sigurimesh ose një degë që ndodhet në një Shtet Anëtar tjetër;

(i) "kontrolli" është marrëdhënia ndërmjet ndërmarrjes mëmë dhe filialit, sipas përkufizimit në nenin 1 të Direktivës së Këshillit 83/349/KEE [12], ose një marrëdhënie e ngjashme ndërmjet një personi fizik a juridik dhe një ndërmarrjeje;

(j) "pjesëmarrja influencuese" është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në një shoqëri sigurimi, i 10 për qind ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë, ose zotërimi i pjesëmarrjes që jep mundësi të ushtrohet influencë e konsiderueshme mbi administrimin e ndërmarrjes në të cilën zotërohet pjesëmarrja;

Në kuptim të këtij përkufizimi, në kuadër të nenit 8 dhe 15 dhe të niveleve të tjera të pjesëmarrjes të përmendura në nenin 15, në konsideratë merren të drejtat e votës të përmendura në nenin 92 të Direktivës 2001/34/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 28 maj 2001, për pranimin e letrave me vlerë në listën e regjistruar të bursës dhe për informacionin që duhet publikuar për këto letra me vlerë [13];

(k) "ndërmarrja mëmë" është ndërmarrja mëmë sipas përkufizimit të nenit 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE;

(l) "filiali" është ndërmarrje e kontrolluar sipas përkufizimit të nenit 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE; çdo filial i ndërmarrjes së kontrolluar konsiderohet filial i ndërmarrjes që është ndërmarrja mëmë në nivelin më të lartë;

(m) "tregu i rregulluar" është:

- në rastin e një tregu që ndodhet në një Shtet Anëtar, tregu i rregulluar sipas përkufizimit të nenit 1 pika 13 të Direktivës 93/22/KEE dhe

- në rastin e një tregu të ndodhet në një vend të tretë, treg financiar që e njeh Shteti Anëtar i origjinës i ndërmarrjes së sigurimeve që përmbush kërkesa të ngjashme.

Çdo instrument financiar i tregtuar në këtë treg duhet të ketë cilësi të krahasueshme me atë të instrumenteve të tregtuara në tregun ose tregjet e rregulluara të Shtetit Anëtar në fjalë;

(n) "autoritetet kompetente" janë autoritetet kombëtare të cilave u është dhënë me akte ligjore ose nënligjore kompetenca për të mbikëqyrur ndërmarrjet e sigurimeve;

(o) "aktivet e përputhura" janë paraqitja e përgjegjësisive të kontraktuara që mund të kërkohen të përputhen në një monedhë të caktuar përmes aktiveve të shprehura ose konvertueshme në të njëjtën monedhë;

(p) "vendndodhja e aktiveve" është ekzistenca e aktiveve, të luajtshme ose të paluajtshme, brenda një Shteti Anëtar, por kjo nuk interpretohet si një kërkesë që aktivet e luajtshme të depozitohen apo që aktivet e paluajtshme t'u nënshtrohen masave kufizuese siç është regjistrimi i barrës hipotekare; aktivet e paraqitura si kërkesa për dëmshpërblim kundrejt debitorëve konsiderohen se ndodhen në Shtetin Anëtar ku janë të konvertueshme;

(q) kapitali i rrezikuar është shuma e pagueshme në momentin e vdekjes minus provigjonet matematikore për riskun kryesor;

(r) lidhje "të ngushta" është situata ku dy a më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur përmes:

(i) pjesëmarrjes, që do të thotë pronësi, e drejtpërdrejtë ose nëpërmjet kontrollit, me 20 për qind ose më shumë të të drejtave të votës apo të kapitalit të ndërmarrjes; ose

(ii) kontrollit, që do të thotë marrëdhënia ndërmjet ndërmarrjes mëmë dhe filialit, në të gjitha rastet e përmendura në nenin 1 pika 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE, ose një marrëdhënie e ngjashme ndërmjet çdo personi fizik ose juridik dhe një ndërmarrjeje; çdo ndërmarrje filial e një ndërmarrjeje filial konsiderohet gjithashtu si filial i ndërmarrjes mëmë që është në krye të atyre ndërmarrjeve.

Edhe situata ku dy a më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur në mënyrë të përhershme me një person të vetëm e të njëjtë, përmes marrëdhënies kontrolluese, konsiderohet se përbën lidhje të ngushtë mes këtyre personave.

2. Sa herë që në këtë direktivë përmendet monedha euro, vlera e këmbimit në monedhën kombëtare që duhet përdorur është, duke filluar nga data 31 dhjetor e çdo viti, vlera e ditës së fundit të muajit paraardhës tetor për të cilën ka të dhëna të disponueshme për vlerat e këmbimit të euros në të gjitha monedhat përkatëse të Komunitetit.

Neni 2

Fusha e veprimit

Kjo direktivë ka të bëjë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së vetëpunësuar të sigurimeve të drejtpërdrejta të ushtruara nga ndërmarrjet e vendosura në një Shtet Anëtar ose që dëshirojnë të vendosen në një Shtet Anëtar, në formën e veprimtarive të përcaktuara më poshtë:

1. Llojet e mëposhtme të sigurimeve kur këto janë në bazë kontrate:

(a) sigurimi i jetës, që është klasa e sigurimeve që përfshin në veçanti sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar, sigurimin për vdekjen, sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme, sigurimin e jetës me kthim të primeve, sigurimin e martesës, sigurimin e lindjes;

(b) anuitete;

(c) sigurimet shtesë të ofruara nga ndërmarrjet e sigurimit të jetës, që janë në veçanti sigurimi ndaj dëmtimit personal duke përfshirë paaftësinë për punë, sigurimin për vdekjen e shkaktuar nga aksidenti dhe sigurimin për invaliditetin e shkaktuar nga aksidenti ose sëmundja, kur këto lloje të ndryshme risqesh merren në sigurim si shtesë ndaj sigurimit të jetës;

(d) lloji i sigurimit që ekziston në Irlandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, i cili njihet si sigurim i përhershëm i shëndetit që nuk mund të anulohet;

2. Operacionet e mëposhtme, kur këto janë në bazë kontrate, për aq sa i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve administrative përgjegjëse për mbikëqyrjen e sigurimeve private:

(a) tontinat, të cilat janë në formën e individëve të bashkuar për qëllime të kapitalizimit të kontributeve të tyre dhe shpërndarjes së mëpasshme të aktiveve në raport me fondet e akumuluar midis personave të mbijetuar ose midis përfituesve të sigurimit në rast vdekjeje të personave të siguruar;

(b) kthimi i kapitalit bazuar në llogaritjet aktuariale, në kuadër të të cilave merren përsipër anagazhime dhe kohëzgjatje dhe vlerë të paracaktuar, në këmbim të një pagese të vetme ose periodike, të rënë dakord paraprakisht;

(c) administrimi i fondeve kolektive të pensionit, pra operacionet që, për ndërmarrjen në fjalë, konsistojnë në administrimin e investimeve dhe në veçanti të aktiveve që përfaqësojnë rezervat e strukturave që bëjnë pagesat pas vdekjes ose mbijetesës ose në rast ndërprerjeje apo kufizimi të

veprimtarisë;

(d) operacionet e përmendura në shkronjën "c" kur shoqërohen me sigurim që mbulon ose ruajtjen e kapitalit ose pagimin e një interesi minimal;

(e) operacionet që kryejnë ndërmarrjet e sigurimit siç janë ato që përmenden në Kreun 1 të Titullit 4 të Librit IV të kodit francez "Code des assurances".

3. Operacionet që lidhen me jetëgjatësinë e njeriut e të cilat kërkohen ose parashikohen në legjislacionin e sigurimeve shoqërore, kur ofrohen ose administrohen nga ndërmarrjet e sigurimeve që e marrin vetë përsipër riskun për to në përputhje me ligjet e Shtetit Anëtar.

Neni 3

Veprimtaritë dhe organet e përjashtuara

Kjo direktivë nuk prek:

1. Në varësi të zbatimit të nenit 2 pika 1 shkronja "c", klasat e përcaktuara në Shtojcën e Direktivës 73/239/KEE.

2. Operacionet e institucioneve të providencës dhe të përfitimit reciprok, pagesat e të cilave ndryshojnë sipas burimeve të disponueshme dhe të cilat kërkojnë nga secili prej anëtarëve të kontribuojnë me shkallën e duhur fikse.

3. Operacionet e ushtruara nga organizata që nuk janë ndërmarrje si ato të përmendura në nenin 2, objekti i të cilave është ofrimi i pagesave për personat e punësuar ose të vetëpunësuar që i përkasin një ndërmarrjeje ose një grupi ndërmarrjesh ose një profesioni apo një grupi profesionesh, në rastin e vdekjes ose mbijetesës, ose në rastin e ndërprerjes ose kufizimit të veprimtarisë, pavarësisht nëse angazhimet që lindin nga operacione të tilla janë të mbuluara ose jo gjatë gjithë kohës me provigjone matematikore.

4. Në varësi të zbatimit të nenit 2 pika 3, sigurimet që bëjnë pjesë në sistemin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore.

5. Organizatat që marrin përsipër të paguajnë shuma vetëm në rast vdekjeje, kur shuma e pagesave të tilla nuk është më e madhe se kostot mesatare të varrimit për një vdekje të vetme ose kur pagesat jepen në natyrë.

6. Fondet kolektive, kur:

- statuti përmban dispozita për kërkimin e kontributeve të tjera shtesë, për zvogëlimin e pagesave ose për kërkimin e asistencës nga persona të tjerë që kanë marrë përsipër një gjë të tillë dhe
- të ardhurat vjetore si kontribut për veprimtaritë që mbulon kjo direktivë nuk janë më shumë se 5 milion euro gjatë tre viteve rresht.

Nëse kjo shumë kalohet gjatë tre viteve rresht, kjo direktivë zbatohet duke filluar nga viti i katërt. Megjithatë, dispozitat e kësaj pike nuk e pengojnë fondin kolektiv të sigurimeve që të paraqesë kërkesë ose të vazhdojë të jetë e licensuar sipas kësaj direktive.

7. "Versorgungsverbanddeutscher Wirtschaftsorganisationen" në Gjermani nëse nuk ndryshohet

legjislacioni i saj për sa i takon objektit të veprimtarisë.

8. Veprimtaritë e pensioneve të ndërmarrjeve të sigurimit të pensionit që kërkohen me ligjin “Për pensionet e punëmarrësve” dhe me legjislacionet e tjera finlandeze të lidhura me këtë, me kusht që:

(a) shoqëritë e sigurimit të pensionit të cilat që më parë sipas legjislacionit finlandez duhet të kenë sisteme të veçuara kontabiliteti dhe administrimi për veprimtaritë e pensionit, duke filluar nga data e aderimit, do të ngrenë subjekte të veçuara juridike për ushtrimin e këtyre veprimtarive;

(b) autoritetet finlandeze duhet t'i lejojnë pa bërë diskriminim të gjithë shtetasit dhe shoqëritë tregtare të Shteteve Anëtare të ushtrojnë në përputhje me legjislacionin finlandez veprimtaritë e përcaktuara në nenin 2 të lidhura me këtë përjashtim nëpërmjet:

- pronësisë ose pjesëmarrjes në një shoqëri ose grup ekzistues sigurimesh,

- krijimit ose pjesëmarrjes në shoqërive ose grupeve të reja të sigurimeve, duke përfshirë shoqëritë e sigurimit të pensionit;

(c) autoritetet finlandeze do t'i paraqesin për miratim Komisionit një raport brenda tre muajve prej datës së aderimit, duke deklaruar masat që janë marrë për t'i veçuar veprimtaritë sipas ligjit “Për pensionet e punëmarrësve” nga veprimtaritë normale të sigurimeve të ushtruara nga shoqëritë finlandeze të sigurimeve në mënyrë që të jenë në konformitet me kërkesat e kësaj direktive.

TITULLI II

FILLIMI I VEPRIMTARISË TREGTARE TË SIGURIMIT TË JETËS

Neni 4

Parimi i autorizimit

Fillimi i veprimtarive që mbulon kjo direktivë bëhet me autorizim zyrtar paraprak.

Këtë autorizim mund ta kërkojë pranë autoriteteve të Shtetit Anëtar të origjinës:

(a) çdo ndërmarrje që e ka vendosur zyrën qendrore në territorin e shtetit në fjalë;

(b) çdo ndërmarrje që, pasi ka marrë autorizimin e përmendur në paragrafin e parë, e shtrin veprimtarinë tregtare në të gjithë klasën ose në klasa të tjera.

Neni 5

Objekti i autorizimit

1. Autorizimi është i vlefshëm në të gjithë Komunitetin.

Ky autorizim i lejon ndërmarrjes të ushtrojë veprimtari tregtare brenda Komunitetit në kuadër të së drejtës së vendosjes ose në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime.

2. Autorizimi jepet për një klasë të veçantë sigurimi sipas klasave të renditura në Shtojcën I. Autorizimi e mbulon të gjithë klasën, nëse subjekti i interesuar nuk dëshiron të mbulojë vetëm disa prej risqeve që i përkasin klasës.

Autoritetet kompetente mund ta kufizojnë autorizimin e kërkuar për njërin prej klasave brenda operacioneve të përcaktuara në skemën e operacioneve të përmendur në nenin 7.

Çdo Shtet Anëtar mund ta japë autorizimin për dy a më shumë klasa, kur ligjet kombëtare e lejojnë ushtrimin e njëkohshëm të klasave të tilla.

Neni 6

Kushtet për marrjen e autorizimit

1. Shteti Anëtar i origjinës i kërkon ndërmarrjes së sigurimeve për të cilën kërkohet autorizimi:

(a) të jetë në njërin nga format e mëposhtme:

- në rastin e Mbretërisë së Belgjikës:

"société anonyme/naamloze vennootschap", "société en commandite par actions/commanditaire vennootschap op aandelen", "association d'assurance mutuelle/onderlinge verzekeringsvereniging", "société coopérative/coöperatieve vennootschap",

- në rastin e Mbretërisë së Danimarkës:

"aktieselskaber", "gensidigeselskaber", "pensionskasseromfattet af lov om forsikringsvirksomhed (tværgående pensionskasser)",

- në rastin e Republikës Federale të Gjermanisë:

"Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit", "öffentlich-rechtliches Wettbewerbsversicherungsunternehmen",

- në rastin e Republikës Franceze:

"société anonyme", "société d'assurance mutuelle", "institution de prévoyance régime par le code de la sécurité sociale", "institution de prévoyance régime par le code rural" dhe "mutuelles régies par le code de la mutualité",

- në rastin e Irlandës:

"incorporated companies limited by shares or by guarantee or unlimited", "societies registered under the Industrial and Provident Societies Acts" dhe "societies registered under the Friendly Societies Acts",

- në rastin e Republikës Italiane:

"società per azioni", "società cooperativa", "mutua di assicurazione",

- në rastin e Dukatit të Madh të Luksemburgut:

"société anonyme", "société en commandite par actions", "association d'assurances mutuelles", "société coopérative",

- në rastin e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta:

"naamloze vennootschap", "onderlingewaarborgmaatschappij",

- në rastin e Mbretërisë së Bashkuar:

"incorporated companies limited by shares or by guarantee or unlimited",
"societies registered under the Industrial and Provident Societies Acts", "societies registered or
incorporated under the Friendly Societies Acts", "the association of underwriters known as Lloyd's",

- në rastin e Republikës Helene:

"ανώνυμη εταιρία",

- në rastin e Mbretërisë së Spanjës:

"sociedad anónima", "sociedad mutua", "sociedad cooperativa",

- në rastin e Republikës Portugeze:

"sociedade anónima", "mútua de seguros",

- në rastin e Republikës së Austrisë:

"Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit",

- në rastin e Republikës së Finlandës:

"keskinäinen vakuutusyhtiö/ömsesidigt försäkringsbolag",

"vakuutusosakeyhtiö/försäkringsaktiebolag", "vakuutusyhdistys/försäkringsförening",

- në rastin e Mbretërisë së Suedisë:

"försäkringsaktiebolag", "ömsesidigt försäkringsbolag", "understödsföreningar".

Ndërmarrja e sigurimeve mund të marrë edhe formën e një shoqërie europiane në momentin e vendosjes. Gjithashtu, sipas rastit, Shtetet Anëtare mund të ngrenë ndërmarrje në çdo formë të parashikuar nga e drejta publike, me kusht që këto organe të kenë si objekt të veprimtarisë operacionet e sigurimeve sipas kushteve të barasvlershme me ato që zbatohen për ndërmarrjet e së drejtës private;

(b) të përfshijë në objekt vetëm veprimtarinë tregtare të parashikuar në këtë direktivë dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt prej saj, duke mos përfshirë asnjë veprimtari tjetër tregtare;

(c) të paraqesë skemën e operacioneve në përputhje me nenin 7;

(d) të ketë fondin minimal të garancisë të parashikuar në nenin 29 pika 2;

(e) të drejtohet efektivisht nga persona me reputacion të mirë e që plotësojnë kushtet e duhura të kualifikimit profesional apo të përvojës.

2. Kur ka lidhje të ngushta ndërmjet ndërmarrjes së sigurimeve dhe personave të tjerë fizikë ose juridikë, autoritetet kompetente e japin autorizimin vetëm nëse këto lidhje nuk e pengojnë ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tyre mbikëqyrëse. Autoritetet kompetente nuk pranojnë ta japin autorizimin edhe nëse aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi joanëtar që rregullojnë një a më shumë persona fizikë ose juridikë me të cilët ka lidhje të ngushta ndërmarrja e sigurimeve ose vështirësitë e lidhura me zbatimin e akteve në fjalë e pengojnë ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tyre mbikëqyrëse. Autoritetet kompetente u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve t'u vendosin në dispozicion informacionet që u kërkojnë për të monitoruar vazhdimisht plotësimin e kushteve të përmendura në këtë pikë.

3. Shtetet Anëtare kërkojnë që zyrat qendrore të ndërmarrjeve të sigurimeve të ndodhen në të

njëjtin Shtet Anëtar ku kanë selinë e regjistruar.

4. Ndërmarrjes së sigurimeve që kërkon autorizim për ta zgjeruar veprimtarinë tregtare në klasa të tjera, apo për ta zgjeruar objektin e autorizimit që mbulon vetëm disa prej risqeve që i përkasin një klase i kërkohet të paraqesë skemën e operacioneve në përputhje me nenin 7.

Gjithashtu, ndërmarrjes në fjalë i kërkohet të paraqesë vërtetim se e ka nivelin e aftësisë paguese të parashikuar në nenin 28 dhe fondin e garancisë të përmendur në nenin 29 pika 1 dhe 2.

5. Shtetet Anëtare nuk miratojnë dispozita që kërkojnë miratimin paraprak apo njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policave, shkallëve të primeve, bazave teknike të përdorura për llogaritjen e shkallëve të primeve dhe provigjoneve teknike, apo të formularëve e dokumenteve të tjera të shtypura, që mendon të përdorë ndërmarrja e sigurimeve në marrëdhëniet e veta me policëmbajtësit.

Pavarësisht paragrafit të parë, për qëllimin e vetëm të verifikimit të pajtueshmërisë me dispozitat kombëtare lidhur me parimet aktuariale, Shteti Anëtar i origjinës mund të kërkojë njoftimin sistematik të bazave teknike të përdorura për llogaritjen e shkallëve të primeve dhe të provigjoneve teknike, por kjo kërkesë nuk mund të përbëjë kusht paraprak që ndërmarrja e sigurimeve të ushtrojë veprimtarinë e vet tregtare.

Dispozitat e kësaj direktive nuk i pengojnë Shtetet Anëtare të mbajnë në fuqi ose të miratojnë akte ligjore, nënligjore a administrative me të cilat të kërkohet miratimi i aktit të themelimit dhe statutit dhe njoftimi i çdo dokumenti tjetër të nevojshëm për ushtrimin normal të mbikëqyrjes.

Jo më vonë se data 1 korrik 1999, Komisioni i paraqet Këshillit një raport për zbatimin e kësaj pike.

6. Dispozitat e përmendura në pikat nga 1 deri në 5 nuk mund të kërkojnë që kërkesat për autorizim të shqyrtohen në dritën e kriterëve ekonomike të tregut.

Neni 7

Skema e operacioneve

Skema e operacioneve e përmendur në nenin 6 pika 1 shkronja "c" dhe pika 4 përfshin të dhëna ose prova:

(a) për natyrën e risqeve që propozon të mbulojë ndërmarrja;

(b) për parimet orientuese në lidhje me risigurimin;

(c) për zërat në përbërje të fondit minimal të garancisë;

(d) për çmuarjet e kostove të ngritjes së shërbimeve administrative dhe për organizimin e sigurimit të veprimtarisë tregtare dhe për burimet financiare me të cilat mendohet të mbulohen këto kosto;

krahas këtyre, për tre vitet e para financiare:

(e) një plan ku jepen çmuarjet e të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë tregtare, marrjen në risigurim dhe cedimin në risigurim;

(f) një parashikim të bilancit;

(g) çmuarjet lidhur me burime financiare me të cilat mendohet të mbulohen pasivet e marrjes në sigurim dhe niveli i aftësisë paguese.

Neni 8

Aksionarët dhe ortakët me pjesëmarrje influencuese

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës nuk ia japin ndërmarrjes autorizimin për fillimin e veprimtarisë tregtare të sigurimeve pa u informuar për identitetin e aksionarëve a të ortakëve, drejtpërdrejt a tërthorazi, pavarësisht nëse këta janë persona fizikë ose juridikë, të cilët kanë pjesëmarrje influencuese në ndërmarrje, dhe pa u informuar për nivelin e pjesëmarrjes influencuese në fjalë.

Këto autoritete nuk e japin autorizimin nëse, duke marrë në konsideratë nevojën për të siguruar një administrim të shëndoshë dhe me maturi të ndërmarrjes së sigurimeve, nuk binden për kualifikimet e aksionarëve ose ortakëve.

Neni 9

Refuzimi i kërkesës për autorizim

Çdo vendim për të refuzuar dhënien e autorizimit shoqërohet me arsyet e përpikta të këtij vendimi dhe i njoftohet ndërmarrjes në fjalë.

Çdo Shtet Anëtar parashikon të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës në rast refuzimi.

Një parashikim i tillë bëhet edhe për ato raste kur autoritetet kompetente nuk i japin përgjigje kërkesës për autorizim brenda afatit prej gjashtë muajsh nga data e marrjes së kërkesës.

TITULLI III

KUSHTET QË RREGULLOJNË VEPRIMTARINË TREGTARE TË SIGURIMEVE

KREU 1

PARIMET DHE METODAT E MBIKËQYRJES FINANCIARE

Neni 10

Autoritetet kompetente dhe objekti i mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja financiare e ndërmarrjes së sigurimeve, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen financiare të veprimtarisë tregtare që ushtron ndërmarrja e sigurimeve përmes degëve ose përmes lirisë për të ofruar shërbime, është përgjegjësi vetëm e Shtetit Anëtar të origjinës.

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të angazhimit, nëse kanë arsye për të menduar se veprimtaritë e ndërmarrjes së sigurimeve mund të prekin situatën financiare të saj, informojnë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës të ndërmarrjes.

Këto të fundit shqyrtojnë nëse ndërmarrja është apo jo në përmbushje të parimeve të maturisë të parashikuara me këtë direktivë.

2. Kjo mbikëqyrje financiare përfshin verifikimin, për sa i takon veprimtarisë së plotë tregtare të ndërmarrjes së sigurimeve, të gjendjes së aftësisë paguese, të krijimit të provigjoneve teknike duke përfshirë edhe provigjonet matematikore dhe të aktiveve në mbulim të tyre, në përputhje me rregullat e parashikuara ose në përputhje me praktikën e ndjekur në Shtetin Anëtar të origjinës sipas dispozitave të miratuara në nivel të Komunitetit.

3. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës i kërkojnë çdo ndërmarrjeje sigurimesh të ketë procedura të shëndosha administrative dhe kontabiliteti dhe mekanizma adekuate të

kontrollit të brendshëm.

Neni 11

Mbikëqyrja e degëve të vendosura në një Shtet Anëtar tjetër

Shteti Anëtar i degës parashikon që, kur ndërmarrja e sigurimeve e autorizuar në një Shtet Anëtar tjetër ushtron veprimtari tregtare nëpërmjet një dege, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, pasi të kenë informuar autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të degës, mund të kryejnë, vetë ose përmes ndërmjetësimit të personave të emëruar prej tyre për këtë qëllim, verifikim në vend të informacioneve të nevojshme për sigurimin e mbikëqyrjes financiare të ndërmarrjes.

Në verifikimin në fjalë mund të marrin pjesë edhe autoritetet e Shtetit Anëtar të degës.

Neni 12

Ndalimi i cedimit të detyrueshëm të një pjese të marrjes në sigurim

Shtetet Anëtare nuk mund t'i kërkojnë ndërmarrjes së sigurimeve të cedojë një pjesë të marrjes në sigurim të veprimtarive të renditura në nenin 2 tek një organizatë ose disa organizata të caktuara me rregulla kombëtare.

Neni 13

Informacionet e kontabilitetit, maturisë dhe statistikave: kompetencat mbikëqyrëse

1. Çdo Shtet Anëtar i kërkon çdo ndërmarrjeje sigurimesh zyra qendrore e së cilës ndodhet në territorin e saj të vendosë në dispozicion një raport vjetor të situatës financiare dhe nivelit të aftësisë paguese, ku të mbulohen të gjitha llojet e operacioneve.

2. Shtetet Anëtare u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve me zyra qendrore në territorin e tyre të paraqesin periodikisht deklarata, së bashku me dokumente statistikore, që janë të nevojshme në funksion të mbikëqyrjes.

Autoritetet kompetente i japin njëri tjetrit çdo dokument dhe informacion të vlefshëm në funksion të mbikëqyrjes.

3. Çdo Shtet Anëtar bën hapat e nevojshëm për t'u kujdesur që autoritetet kompetente të kenë kompetencat dhe mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë tregtare të ndërmarrjeve të sigurimeve me zyra qendrore në territorin e vet, duke përfshirë veprimtaritë e ushtruara jashtë këtij territori, në përputhje me Direktivat e Këshillit që i rregullojnë këto veprimtari dhe me qëllim që të sigurohet që ato të zbatohen.

Këto kompetenca e mjete duhet t'u mundësojnë autoriteteve kompetente në veçanti:

(a) kryerjen e hetimeve të hollësishme lidhur me situatën e ndërmarrjes dhe të gjithë veprimtarinë e saj tregtare, ndër të tjera përmes:

- mbledhjes së informacioneve apo duke kërkuar paraqitjen e dokumenteve të lidhura me veprimtarinë tregtare të sigurimeve,

- kryerjes së hetimeve në vend në mjediset e ndërmarrjes së sigurimeve;

(b) marrjen e masave në lidhje me ndërmarrjen e sigurimeve, anëtarët e këshillit të administrimit ose administratorët e saj apo në lidhje me personat që e kanë në kontroll ndërmarrjen, të cilat të

jenë të duhura dhe të nevojshme për të siguruar që veprimtaria tregtare e ndërmarrjes të vazhdojë të jetë në respektim të akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që duhet të përmbushë ndërmarrja në çdo Shtet Anëtar dhe në veçanti të skemës së operacioneve për aq sa kjo është e detyrueshme për zbatim, si edhe për të parandaluar apo korrigjuar çdo parregullsi që cenon interesat e personave të siguruar;

(c) sigurimin që të zbatohen këto masa, nëse është nevoja edhe përmes masave shtrënguese dhe, sipas rastit, nëpërmjet kanaleve gjyqësore.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë edhe që autoritetet kompetente të marrin çdo informacion në lidhje me kontratat e mbajtura nga ndërmjetësit.

Neni 14

Transferimi i portofolit

1. Sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin kombëtar, çdo Shtet Anëtar autorizon ndërmarrjet e sigurimeve me zyra qendrore në territorin e tij t'ia transferojë të gjithë ose një pjesë të portofolave të kontratave të lidhura në kuadër të së drejtës së vendosjes ose në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime një zyre pranuese brenda Komunitetit, nëse autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës të zyrës pranuese vërtetojnë se pas marrjes parasysht të transferimit të portofolave në fjalë zyra pranuese e ka nivelin e nevojshëm të aftësisë paguese.

2. Kur dega propozon të transferojë të gjithë ose një pjesë të portofolit të kontratave të veta, të lidhura në kuadër të së drejtës së vendosjes apo të lirisë për të ofruar shërbime, për këtë merret mendimi i Shtetit Anëtar të degës.

3. Në rrethanat e përmendura në pikën 1 dhe 2, transferimin e autorizojnë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës të ndërmarrjes që bën kalimin, pasi kanë marrë pëlqimin e autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare të angazhimit.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare që u kërkohet mendim u japin mendimin ose pëlqimin e tyre autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të ndërmarrjes së sigurimeve që bën transferimin brenda tre muajsh pas marrjes së kërkesës; mungesa e një përgjigjeje brenda këtij afati konsiderohet si mendim në favor të transferimit ose si pëlqim në heshtje.

5. Transferimi i autorizuar në përputhje me këtë nen bëhet publik, siç parashikohet në legjislacionin kombëtar në Shtetin Anëtar të angazhimit.

Transferimi në fjalë e fiton automatikisht vlefshmërinë kundrejt policëmbajtësve, personave të siguruar dhe çdo personi tjetër me të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga kontratat e transferuara. Kjo dispozitë nuk cenon të drejtat e Shteteve Anëtare për t'u dhënë policëmbajtësve mundësinë e anulimit të kontratës brenda një afati të caktuar pas transferimit.

Neni 15

Pjesëmarrja influencuese

1. Shtetet Anëtare i kërkojnë çdo personi fizik a juridik që propozon të marrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një pjesëmarrje influencuese në një ndërmarrje sigurimesh, të informojë së pari autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, duke u bërë të ditur nivelin e pjesëmarrjes që

synon të marrë. Personi në fjalë duhet po kështu të informojë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës nëse propozon ta rrisë pjesëmarrjen e vet influencuese në atë nivel ku përqindja e të drejtave të votës apo e kapitalit që zotëron kapërcen kuotat 20, 33 ose 50 për qind, apo në atë nivel ku ndërmarrja e sigurimeve në fjalë do të bëhej shoqëri e kontrolluar e tija.

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës kanë afat jo më shumë se 3 muaj nga data e njoftimit të parashikuar në paragrafin e parë për ta kundërshtuar një plan të tillë nëse, duke mbajtur parasysh nevojën për të siguruar administrimin e shëndoshë dhe të matur të ndërmarrjes së sigurimeve, nuk binden për plotësimin e kushteve kualifikuese nga ana e personit të përmendur në paragrafin e parë. Nëse nuk e kundërshtojnë planin në fjalë, mund të vendosin një afat maksimal për vënien në zbatim të tij.

2. Shtetet Anëtare i kërkojnë çdo personi fizik ose juridik që propozon të heqë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një pjesëmarrje influencuese në një ndërmarrje sigurimesh, të informojë së pari autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, duke u bërë të ditur nivelin e pjesëmarrjes që synon të ketë. Personi në fjalë duhet po kështu të informojë autoritetet kompetente nëse propozon ta zvogëlojë pjesëmarrjen e vet influencuese në atë nivel ku përqindja e të drejtave të votës apo e kapitalit që zotëron bie nën kuotat 20, 33 ose 50 për qind, apo nën atë nivel ku ndërmarrja e sigurimeve në fjalë nuk do të ishte më shoqëri e kontrolluar e tija.

3. Ndërmarrjet e sigurimeve, me të marrë dijeni, informojnë autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të origjinës për çdo marrje në pronësi ose heqje nga pronësia të pjesëmarrjeve në kapitalin e tyre të cilat bëjnë që pjesëmarrja të kalojë ose të bjerë nën nivelet e përmendura në pikën 1 dhe 2. Po kështu, të paktën një herë në vit, ato i informojnë autoritetet në fjalë për emrat e aksionarëve dhe ortakëve që zotërojnë pjesëmarrje influencuese si edhe për nivelin e këtyre pjesëmarrjeve, për shembull në bazë të informacioneve që marrin në mbledhjen vjetore të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve dhe ortakëve apo si pasojë e respektimit të akteve normative që zbatohen për shoqëritë tregtare të regjistruara në bursë.

4. Shtetet Anëtare kërkojnë që, nëse influenca e ushtruar nga personat e përmendur në pikën 1 ka të ngjarë të cenojë administrimin e shëndoshë dhe të matur të ndërmarrjes së sigurimeve, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës të marrin masat e duhura për t'i dhënë fund situatës në fjalë. Në këto masa do të përfshiheshin, për shembull, urdhrat për sigurimin e padisë, sanksionet ndaj anëtarëve të këshillit të administrimit dhe administratorëve ose pezullimi i ushtrimit të së drejtës së votës në lidhje me aksionet që zotërojnë aksionarët apo ortakët në fjalë. Masa të ngjashme zbatohen për personat fizikë ose juridikë që nuk e përmbushin detyrimin për të dhënë paraprakisht informacionin, siç parashikohet në pikën 1. Nëse, përkundër kundërshtimit të autoriteteve kompetente, pjesëmarrja merret në pronësi, Shtetet Anëtare, pavarësisht marrjes së sanksioneve të tjera, parashikojnë ose pezullimin e ushtrimit të të drejtave të votës, ose pavlefshmërinë e votimit apo mundësinë për anulimin e votimit.

Neni 16

Sekreti profesional

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar në autoritetet kompetente, si edhe të gjithë audituesit ose ekspertët që veprojnë për llogari të autoriteteve

kompetente, të jenë objekt i detyrimit të sekretit profesional. Kjo do të thotë që këta persona të mos i japin asnjë informacion konfidencial që mund të marrin gjatë ushtrimit të detyrës asnjë personi apo autoriteti, pa e përpunuar në formë të përmbledhur a të agreguar, në mënyrë të tillë që të mos mund të identifikohen ndërmarrje të veçanta të sigurimeve, pa cenuar këtu rastet që mbulon legjislacioni penal. Por, nëse ndërmarrja e sigurimeve është shpallur në procedurë falimentimi ose është kaluar në procedurë të mbylljes së veprimtarisë, informacioni konfidencial që nuk ka të bëjë me të tretët e përfshirë në përpjekjet për ta shpëtuar ndërmarrjen në fjalë mund të bëhet i ditur në proceset civile apo tregtare.

2. Pika 1 nuk i pengon autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të ndryshme të shkëmbejnë informacione në përputhje me direktivat që zbatohen për ndërmarrjet e sigurimeve.

Një informacion i tillë është objekt i kushteve të sekretit profesional të përmendur në pikën 1.

3. Shtetet Anëtare mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi, ku të parashikojnë shkëmbim informacioni, me autoritetet kompetente të vendeve të treta ose me autoritetet apo organet e vendeve të treta të përkufizuara në pikën 5 dhe 6, vetëm nëse informacioni që jepet është objekt i garancive të sekretit profesional që janë të paktën të barasvlershme me ato që përmenden në këtë nen. Qëllimi i një shkëmbimi të tillë informacioni duhet të jetë kryerja e detyrave mbikëqyrëse të autoriteteve apo organeve të përmendura. Kur informacioni e ka origjinën nga një Shtet Anëtar tjetër, ai nuk mund të bëhet i ditur pa miratimin e dhënë shprehimisht nga autoritetet kompetente që e kanë dhënë fillimisht dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat e kanë dhënë miratimin ato autoritete.

4. Autoritetet kompetente që marrin informacion konfidencial në zbatim të pikës 1 ose 2 mund ta përdorin vetëm në ushtrimin e detyrave:

- për të kontrolluar nëse përmbushen kushtet që rregullojnë fillimin e veprimtarisë tregtare të sigurimeve dhe për të mundësuar monitorimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie tregtare, sidomos në lidhje me monitorimin e provigjoneve teknike, nivelit të aftësisë paguese, procedurave administrative dhe kontabël dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm,
- për të vendosur sanksione,
- në proceset e ankimit administrativ kundër vendimeve të autoriteteve kompetente ose
- në proceset gjyqësore të çelura në zbatim të nenit 67 ose në zbatim të dispozitave të posaçme të parashikuara në këtë direktivë ose në direktivat e tjera të miratuara në fushën e ndërmarrjeve të sigurimeve.

5. Pika 1 dhe 4 nuk e cenon shkëmbimin e informacionit brenda Shtetit Anëtar, kur ka dy a më shumë autoritete kompetente në të njëjtin Shtet Anëtar, ose, ndërmjet Shteteve Anëtare, ndërmjet autoriteteve kompetente dhe:

- autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen zyrtare të institucioneve të kreditimit dhe organizatave të tjera financiare dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare,
- organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e ndërmarrjeve të sigurimeve dhe në procedura të tjera të ngjashme, dhe
- personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe të institucioneve të tjera financiare, gjatë ushtrimit të funksioneve të mbikëqyrjes dhe kur u japin organeve që administrojnë procedurat e mbylljes së detyrueshme të veprimtarisë

tregtare ose fondeve të garancisë informacionet e nevojshme për ushtrimin e detyrave të tyre. Informacioni që marrin këto autoritete, organe dhe persona është objekt i detyrimit të sekretit profesional të parashikuar në pikën 1.

6. Pavarësisht pikave nga 1 deri në 4, Shtetet Anëtare mund të lejojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe:

- autoriteteve përgjegjëse për kontrollin mbikëqyrës të organeve të përfshira në procedurat e likuidimit dhe të falimentimit të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe në procedura të tjera të ngjashme,

- autoriteteve përgjegjëse për kontrollin mbikëqyrës të personave të ngarkuar me detyrën e kryerjes së auditimit ligjor të llogarive të ndërmarrjeve të sigurimeve, institucioneve të kreditimit, firmave të investimeve dhe institucioneve të tjera financiare, ose

- aktuarëve të pavarur të ndërmarrjeve të sigurimeve të cilët kryejnë mbikëqyrjen ligjore të këtyre ndërmarrjeve dhe organeve përgjegjëse për kontrollin mbikëqyrës të aktuarëve në fjalë.

Shtetet Anëtare që e kanë mundësinë e shfrytëzimit të mundësisë së parashikuar në paragrafin e parë kërkojnë plotësimin, si minimum, të kushteve të mëposhtme:

- ky informacion të jetë vetëm me qëllim ushtrimin e kontrollit mbikëqyrës ose të mbikëqyrjes ligjore të përmendur në paragrafin e parë,

- informacioni i marrë në këtë kuadër të jetë objekt i kushteve të sekretit profesional të vendosura në pikën 1,

- kur informacioni e ka origjinën nga një Shtet Anëtar tjetër, ai të mos bëhet i ditur pa miratimin e dhënë shprehimisht nga autoritetet kompetente që e kanë dhënë fillimisht dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat e kanë dhënë miratimin ato autoritete.

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dhe Shteteve Anëtare të tjera emrat e autoriteteve, personave dhe organeve që mund ta marrin informacionin në përputhje me këtë pikë.

7. Pavarësisht pikave nga 1 deri në 4, Shtetet Anëtare, me qëllim fuqizimin e stabilitetit, si edhe të paprekshmërisë, të sistemit financiar, mund të lejojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve ose organeve që u është ngarkuar me ligj përgjegjësia për zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të legjislacionit për shoqëritë tregtare.

Shtetet Anëtare që e kanë mundësinë e shfrytëzimit të mundësisë së parashikuar në paragrafin e parë kërkojnë plotësimin, si minimum, të kushteve të mëposhtme:

- ky informacion të jetë vetëm me qëllim kryerjen e detyrës së përmendur në paragrafin e parë,

- informacioni i marrë në këtë kuadër të jetë objekt i kushteve të sekretit profesional të vendosura në pikën 1,

- kur informacioni e ka origjinën nga një Shtet Anëtar tjetër, ai të mos bëhet i ditur pa miratimin e dhënë shprehimisht nga autoritetet kompetente që e kanë dhënë fillimisht dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat e kanë dhënë miratimin ato autoritete.

Kur në një Shtet Anëtar autoritetet ose organet e përmendura në paragrafin e parë e kryejnë detyrën e zbulimit ose hetimit me ndihmën e personave të tjerë të caktuar për këtë qëllim dhe jo të punësuar në sektorin publik, mundësia e shkëmbimit të informacionit e parashikuar në paragrafin e parë mund të përfshijë edhe persona të tillë, duke zbatuar kushtet e përcaktuara në paragrafin e dytë.

Në mënyrë që të zbatohet nënpika e tretë e paragrafit të dytë, autoritetet ose organet e përmendura në paragrafin e parë u komunikojnë autoriteteve kompetente që e kanë dhënë fillimisht informacionin emrat dhe përgjegjësitë e përpikta të personave të cilëve duhet t'u

dërgohet ky informacion.

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dhe Shteteve Anëtare të tjera emrat e autoriteteve ose organeve që mund ta marrin informacionin në përputhje me këtë pikë.

Komisioni harton një raport për zbatimin e kësaj pike brenda datës 31 dhjetor 2000.

8. Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë autoriteteve kompetente t'u transmetojnë:

- bankave qendrore dhe organeve të tjera me funksion të ngjashëm në cilësinë e tyre si autoritete monetare,

- sipas rastit, autoriteteve të tjera publike përgjegjëse për kontrollin mbikëqyrës të sistemeve të pagesave, informacionet e nevojshme për kryerjen e detyrës së tyre dhe mund t'ua lejojnë autoriteteve ose organeve të tilla t'u komunikojnë autoriteteve kompetente informacione të tilla të cilat mund t'u duhen në funksion të pikës 4.

Informacioni i marrë në këtë kuadër është objekt i kushteve të sekretit profesional të vendosura në këtë nen.

9. Gjithashtu, pavarësisht pikës 1 dhe 4, Shtetet Anëtare mund të autorizojnë, sipas dispozitave të parashikuara me ligj, dhënien e disa informacioneve të caktuara dikastereve të tjera të administratave të tyre qendrore që janë përgjegjëse për legjislacionin për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditimit, institucioneve financiare, shërbimeve të investimit dhe ndërmarrjeve të sigurimeve, si edhe inspektorëve që veprojnë për llogari të këtyre dikastereve. Por këto informacione mund të jepen vetëm kur janë të nevojshme për arsye të kontrollit të matur.

Megjithatë, Shtetet Anëtare parashikojnë që informacioni i marrë sipas pikës 2 dhe 5 dhe ai i marrë nëpërmjet verifikimeve në vend të përmendura në nenin 11, nuk mund të bëhet asnjëherë i ditur në rastet e përmendura në këtë pikë nëse nuk është marrë pëlqimi i autoriteteve kompetente që e kanë dhënë informacionin apo i autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin është kryer verifikimi në vend.

Neni 17

Detyrimet e audituesve

1. Shtetet Anëtare parashikojnë, si minimum, që:

(a) çdo person i autorizuar sipas kuptimit të Direktivës së Këshillit 84/253/KEE [14], që kryen në një ndërmarrje sigurimesh detyrën e përshkruar në nenin 51 të Direktivës së Këshillit 78/660/KEE [15], nenin 37 të Direktivës 83/349/KEE ose nenin 31 të Direktivës së Këshillit 85/611/KEE [16] apo çfarëdo detyre tjetër të kërkuar me ligj, ka për detyrë të kallëzojë menjëherë pranë autoriteteve kompetente çdo fakt apo vendim lidhur me atë ndërmarrje për të cilin ka ardhur në dijeni gjatë ushtrimit të detyrës në fjalë dhe i cili ka të ngjarë:

- që të përbëjë shkelje me rëndësi materiale të akteve ligjore, nënligjore ose administrative ku parashikohen kushtet që rregullojnë autorizimin ose që rregullojnë në mënyrë specifike ndjekjen e veprimtarive të ndërmarrjeve të sigurimeve,

- që të cenojë funksionimin e vazhdueshëm të ndërmarrjes së sigurimeve ose,

- që të sjellë refuzimin për të certifikuar llogaritë ose shprehjen e opinionit me rezerva;

(b) ky person ka po kështu për detyrë të kallëzojë çdo fakt dhe vendim për të cilin vihet në dijeni gjatë ushtrimit të detyrës së përmendur në shkronjën "a" në një ndërmarrje që ka lidhje të ngushta të cilat lindin nga një marrëdhënie kontrolluese me ndërmarrjen e sigurimeve brenda së

cilës është duke kryer detyrën e lartpërmendur.

2. Vënia në dijeni në mirëbesim e autoriteteve kompetente nga ana e personave të autorizuar sipas Direktivës 84/253/KEE për çdo fakt apo vendim të përmendur në pikën 1, nuk përbën shkelje të asnjë kufizimi mbi bërjen të ditur të informacioneve të vendosur me kontratë ose me akte ligjore, nënligjore ose administrative dhe nuk prodhon përgjegjësi të asnjë lloji për këta persona.

Neni 18

Ndjekja e veprimtarive të sigurimeve jetë dhe jo-jetë

1. Pa cenuar pikën 3 dhe 7, asnjë ndërmarrje nuk mund të autorizohet paralelisht, edhe në zbatim të kësaj direktive, edhe në zbatim të Direktivës 73/239/KEE.

2. Në shmangie nga pika 1, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që:

- ndërmarrjet e autorizuar në zbatim të kësaj direktive mund të marrin autorizim, në përputhje me nenin 6 të Direktivës 73/239/KEE, edhe për risqet e klasave 1 dhe 2 të shtojcës së asaj direktive,
- ndërmarrjet e autorizuar në zbatim të nenit 6 të Direktivës 73/239/KEE vetëm për risqet e renditura në klasat 1 dhe 2 të shtojcës së asaj direktive mund të marrin autorizim në zbatim të kësaj direktive.

3. Në varësi të pikës 6, ndërmarrjet e përmendura në pikën 2 dhe ndërmarrjet të cilat më:

- 1 janar 1981 për ndërmarrjet e autorizuar në Greqi,
- 1 janar 1986 për ndërmarrjet e autorizuar në Spanjë dhe Portugali,
- 1 janar 1995 për ndërmarrjet e autorizuar në Austri, Finlandë dhe Suedi dhe,
- 15 mars 1979 për të gjitha ndërmarrjet e tjera

ushtrojnë njëkohësisht veprimtaritë e mbuluara nga kjo direktivë dhe veprimtaritë e mbuluara nga Direktiva 73/239/KEE mund të vazhdojnë t'i ushtrojnë ato njëkohësisht, me kusht që secila veprimtari të administrohet më vete në përputhje me nenin 19 të kësaj direktive.

4. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që ndërmarrjet e përmendura në pikën 2 të zbatojnë rregullat e kontabilitetit që rregullojnë ndërmarrjet e sigurimeve të autorizuar në zbatim të kësaj direktive për të gjitha veprimtaritë e tyre.

Në pritje të bashkërendimit në këtë aspekt, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë gjithashtu që, sa u takon rregullave për mbylljen e veprimtarisë tregtare, veprimtaritë e lidhura me risqet e renditura në klasat 1 dhe 2 të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE të ushtruara nga ndërmarrjet e përmendura në pikën 2 të rregullohen me rregullat e zbatueshme për veprimtaritë e sigurimit të jetës.

5. Kur ndërmarrja që ushtron veprimtaritë e përmendura në shtojcën e Direktivës 73/239/KEE ka lidhje financiare, tregtare apo administrative me një ndërmarrje sigurimesh që ushtron veprimtaritë e mbuluara nga kjo direktivë, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në territorin e të cilave ndodhen zyrat qendrore të atyre ndërmarrjeve sigurojnë që llogaritë e ndërmarrjeve në fjalë të mos shtrembërohen nga marrëveshjet ndërmjet këtyre ndërmarrjeve apo nga asnjë masë e cila do të mund të prekë shpërndarjen e shpenzimeve dhe të ardhurave.

6. Çdo Shtet Anëtar mund t'u kërkojë ndërmarrjeve të sigurimeve me zyra qendrore në territorin e tij të ndërpresin, brenda një afati të përcaktuar nga Shteti Anëtar i interesuar, ndjekjen e njëkohshme të veprimtarive që ushtrojnë më datat e përmendura në pikën 3.

7. Dispozitat e këtij neni rishikohen në bazë të një raporti që Komisioni i paraqet Këshillit në dritën e harmonizimit të ardhshëm të rregullave për mbylljen e veprimtarisë tregtare, por në çdo rast brenda datës 31 dhjetor 1999.

Neni 19

Veçimi i administrimit të sigurimeve jetë dhe jo-jetë

1. Administrimi i veçuar që përmendet në nenin 18 pika 3 duhet të organizohet në mënyrë të atillë që veprimtaritë e mbuluara nga kjo direktivë të jenë të dallueshme nga veprimtaritë e mbuluara nga Direktiva 73/239/KEE, në mënyrë që:

- të mos cenohen interesat respektive të policëmbajtësve të sigurimit jetë dhe të atyre jo-jetë dhe, në veçanti, policëmbajtësit e sigurimit jetë të përfitojnë nga fitimet e sigurimit të jetës njësoj sikur ndërmarrja e sigurimeve të ushtronte vetëm veprimtarinë e sigurimit të jetës,

- detyrimet minimale financiare, në veçanti ato për nivelin e aftësisë paguese, lidhur me njërin prej të dyja veprimtarive, pra të një veprimtarie në zbatim të kësaj direktive dhe të një veprimtarie në zbatim të Direktivës 73/239/KEE, të mos i mbajë veprimtaria tjetër.

Mirëpo, për sa kohë që detyrimet minimale financiare përmbushen sipas kushteve të vendosura në nënpikën e dytë të paragrafit të parë dhe nëse informohen autoritetet kompetente, ndërmarrja mund të përdorë ata zëra eksplicitë të nivelit të aftësisë paguese që mbeten të gatshëm për përdorim për njërin veprimtari ose tjetrën.

Autoritetet kompetente i analizojnë rezultatet e të dyja veprimtarive në mënyrë që të sigurojnë përmbushjen e dispozitave të kësaj pike.

2. (a) Llogaritë hartohen në mënyrë të atillë që të paraqesin burimet e rezultateve për secilën prej dy veprimtarive, sigurimin jetë dhe sigurimin jo-jetë.

Për këtë qëllim të gjitha të ardhurat (në veçanti primet, pagesat nga risiguruesit dhe të ardhurat nga investimet) dhe shpenzimet (në veçanti pagesat nga sigurimet, zmadhimet e provigjoneve teknike, primet e risigurimit, shpenzimet e shfrytëzimit në lidhje me veprimtarinë e sigurimeve) zberthehen sipas origjinës.

Zërat e përbashkët për të dyja veprimtaritë regjistrohen në përputhje me metodat e shpërndarjes të pranuar nga autoriteti kompetent.

(b) Ndërmarrjet e sigurimeve përgatisin, në bazë të llogarive, një pasqyrë ku identifikojnë qartë zërat që përbëjnë secilin nivel të aftësisë paguese, në përputhje me nenin 27 të kësaj direktive dhe nenin 16 pika 1 të Direktivës 73/239/KEE.

3. Nëse është i pamjaftueshëm njëri prej niveleve të aftësisë paguese, autoritetet kompetente zbatojnë për veprimtarinë me mangësi masat e parashikuara në direktivën përkatëse, pavarësisht rezultateve të veprimtarisë tjetër.

Në shmangie të nënpikës së dytë të paragrafit të parë të pikës 1, këto masa mund të përfshijnë autorizimin e një transferimi nga njëra veprimtari në tjetrën.

KAPITULLI 2

RREGULLAT E LIDHURA ME PROVIGJONET TEKNIKE DHE PARAQITJEN E TYRE

Neni 20

Krijimi i provigjoneve teknike

1. Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje sigurimesh të krijojë provigjone të mjaftueshme teknike, duke përfshirë edhe provigjone matematikore, në lidhje me të gjithë veprimtarinë e vet tregtare.

Shuma e këtyre provigjoneve teknike përcaktohet në përputhje me parimet e mëposhtme.

A. (i) shuma e provigjoneve teknike të sigurimit të jetës llogaritet përmes një vlerësimi aktuarial prospektiv me maturi të mjaftueshme, duke marrë në konsideratë të gjitha detyrimet e ardhshme të përcaktuara nga kushtet e policës për çdo kontratë ekzistuese, duke përfshirë:

- të gjitha pagesat e garantuara, përfshirë edhe vlerat e garantuara të heqjes dorë,
 - shpërblimet e fituara bashkërisht ose individualisht nga policëmbajtësit, sido që të jenë përshkruar këto shpërblime të fituara, të shpallura ose të caktuara,
 - të gjitha mundësitë që u vihen në dispozicion policëmbajtësve sipas kushteve të kontratës,
 - shpenzimet, përfshirë edhe komisionet, duke llogaritur edhe primet e ardhshme të arkëtueshme;
- (ii) lejohet përdorimi i një metode retrospektive, nëse mund të vërtetohet se provigjonet teknike që dalin prej saj nuk janë më të vogla se niveli i kërkuar sipas një llogaritjeje prospektive me maturi të mjaftueshme, ose nëse për llojin e kontratës në fjalë nuk mund të përdoret një metodë prospektive;

(iii) vlerësimi me maturi nuk është vlerësim "i çmuarjes më të mirë", por përfshin një marzh të përshtatshëm për shmangien e padëshirueshme të faktorëve të lidhur:

(iv) metoda e vlerësimit për provigjonet teknike nuk duhet jetë vetëm me maturi në vetvete, por duhet të jetë e tillë edhe duke mbajtur në konsideratë metodën e vlerësimit të aktiveve në mbulim të atyre provigjoneve;

(v) provigjonet teknike llogariten më vete për çdo kontratë.

Megjithatë lejohet përdorimi i përafrimeve ose përgjithësimeve të përshtatshme kur kanë të ngjarë të nxjerrin përafërsisht të njëjtin rezultat si edhe llogaritjet e veçanta.

Parimi i llogaritjes më vete nuk pengon në asnjë mënyrë krijimin e provigjoneve shtesë për risqet e përgjithshme që nuk janë të llogaritura veçmas;

(vi) kur vlera e heqjes dorë e një kontrate është e garantuar, shuma e provigjoneve matematikore për këtë kontratë është në çdo kohë të paktën sa vlera e garantuar në momentin përkatës;

B. Norma e interesit e përdorur zgjidhet me maturi.

Ajo përcaktohet në përputhje me rregullat e autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, duke zbatuar parimet e mëposhtme:

(a) për të gjitha kontratat, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës të ndërmarrjes së sigurimeve vendos një ose më shumë norma maksimale interesi, sidomos në përputhje me rregullat e mëposhtme:

(i) kur kontratat përmbajnë garanci për normën e interesit, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës vendos një normë të vetme maksimale interesi.

Kjo normë mund të ndryshojë sipas monedhës me të cilën shprehet kontrata, me kusht që të mos jetë më shumë se 60 për qind e normës së obligacioneve të emetuara nga Shteti i monedhës me të

cilën shprehet kontrata.

Nëse, në zbatim të fjalisë së dytë të paragrafit të parë, Shteti Anëtar vendos të përcaktojë një normë maksimale interesi për kontratat e shprehura me monedhën e një Shteti Anëtar tjetër, ai konsultohet në fillim me autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar të monedhës me të cilën është shprehur kontrata;

(ii) por, kur aktivet e ndërmarrjes së sigurimeve nuk vlerësohen me çmimin e blerjes, Shteti Anëtar mund të lejojë llogaritjen e një ose më shumë normave maksimale të interesit duke marrë në konsideratë kthimin mbi aktivet korresponduese në zotërim, minus një marzh të maturisë dhe, në veçanti për kontratat me prime periodike, duke marrë në konsideratë kthimin e pritur mbi aktivet e ardhshme.

Marzhi i maturisë dhe norma ose normat maksimale të interesit të përdorura për kthimin e pritur mbi aktivet e ardhshme përcaktohen nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës;

(b) vendosja e një norme maksimale interesi nuk do të thotë se ndërmarrja e sigurimeve është e detyruar të përdorë një normë interesi të atij niveli;

(c) Shteti Anëtar i origjinës mund të vendosë të mos e zbatojë shkronjën "a" për kategoritë e mëposhtme të kontratave:

- kontratat e lidhura me njësi,

- kontratat me një prim të vetëm për një periudhë deri në tetë vjet,

- kontratat pa fitime dhe kontratat me pagesa periodike pa vlerë të heqjes dorë.

Në rastet e përmendura në nënpikën e dytë dhe të tretë të paragrafit të parë, gjatë zgjedhjes së normës së interesit të maturisë, mbahet në konsideratë monedha me të cilën është shprehur kontrata dhe aktivet korresponduese në zotërim dhe, kur aktivet e ndërmarrjes vlerësohen me vlerën aktuale të tyre, kthimi i pritur mbi aktivet e ardhshme.

Në asnjë rrethanë nuk mund të përdoret një normë interesi më e lartë se kthimi mbi aktivet i llogaritur në përputhje me rregullat e kontabilitetit të Shtetit Anëtar të origjinës, minus zbritjen e amortizimit;

(d) Shteti Anëtar i kërkon ndërmarrjes së sigurimeve të vendosë në llogaritë e veta një provigjion për të përmbushur angazhimet për normën e interesit kundrejt policëmbajtësve nëse kthimi aktual ose i parashikueshëm mbi aktivet e ndërmarrjes nuk është i mjaftueshëm për t'i mbuluar këto angazhime;

(e) Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare njoftohen, sipas kërkesës, për normat maksimale të interesit të vendosura sipas shkronjës "a";

C. Elementet statistikore të vlerësimit dhe kuota e lejuar për shpenzimet zgjidhen me maturi, duke mbajtur në konsideratë shtetin e angazhimit, llojin e policës dhe kostot administrative e komisionet që priten të lindin;

D. Në rastin e kontratave me pjesëmarrje, metoda e llogaritjes së provigjoneve teknike mund të marrë në konsideratë, në mënyrë të nënkuptuar ose shprehimisht, shpërblimet e ardhshme të çdo lloji, në një mënyrë që të jetë në përputhje me supozimet e tjera për përvojën e ardhshme dhe me metodën aktuale të shpërndarjes së shpërblimeve;

E. Kuota e lejuar për shpenzimet e ardhshme mund të bëhet në mënyrë të nënkuptuar, për shembull duke përdorur primet e ardhshme të cilave u zbriten tarifatat e administrimit.

Por, kuota e lejuar gjithsej, e nënkuptuar ose e paraqitur shprehimisht, nuk mund të jetë më e vogël se çmuarja e bërë me maturi për shpenzimet përkatëse të ardhshme:

F. Metoda e llogaritjes së provigjoneve teknike nuk u nënshtrohet ndërprerjeve nga viti në vit për shkak të ndryshimeve arbitrare të metodës ose bazave të llogaritjes, dhe është e tillë që të njohë shpërndarjen e fitimeve në mënyrë të përshtatshme gjatë kohëzgjatjes së çdo police.

2. Ndërmarrjet e sigurimeve vendosin në dispozicion të publikut bazat dhe metodat e përdorura në llogaritjen e provigjoneve teknike, duke përfshirë provigjonet për shpërblimet.

3. Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje sigurimesh t'i mbulojë provigjonet teknike në lidhje me të gjithë veprimtarinë e vet tregtare me aktive përputhëse sipas nenit 26.

Në lidhje me veprimtarinë e marrjes në sigurim brenda Komunitetit, këto aktive duhet ta kenë vendndodhjen brenda Komunitetit.

Shtetet Anëtare nuk u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve që vendndodhja e aktiveve të tyre të jetë në një Shtet Anëtar të veçantë.

Por Shteti Anëtar i origjinës mund të lejojë lehtësime në rregullat për vendndodhjen e aktiveve.

4. Shteti Anëtar që lejon mbulimin e provigjoneve teknike me kërkesat për dëmshpërblim përcakton përqindjen e lejuar për këtë.

Në këto raste ai nuk mund të përcaktojë vendndodhjen e aktiveve që janë në formën e këtyre kërkesave për dëmshpërblim.

Neni 21

Primet për veprimtarinë e re

Primet për veprimtarinë e re duhet të jenë të mjaftueshme, të mbështetura në supozime të arsyeshme aktuariale, për t'u dhënë mundësi ndërmarrjeve të sigurimeve t'i përmbushin të gjitha angazhimet dhe, në veçanti, të krijojnë provigjone teknike të mjaftueshme.

Për këtë qëllim, mund të merren në konsideratë të gjitha aspektet e situatës financiare të ndërmarrjes së sigurimeve, pa kontributin e burimeve me përjashtim të primeve dhe të ardhurave të fituara mbi to që janë sistematike dhe të përhershme, në mënyrë të tillë që mund të vënë në rrezik aftësinë paguese të ndërmarrjes në periudhën afatgjatë.

Neni 22

Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike

Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike marrin në konsideratë llojin e veprimtarisë që ushtron ndërmarrja e sigurimeve, në mënyrë që të garantohet siguria, kthimi dhe tregtueshmëria e investimeve, për të cilat ndërmarrja kujdeset që të jenë të diversifikuara dhe të shpërndara siç duhet.

Neni 23

Kategoritë e aktiveve të lejuara

1. Shteti Anëtar i origjinës nuk mund t'i autorizojë ndërmarrjet e sigurimeve t'i mbulojnë provigjonet teknike të tyre me asnjë kategori aktivesh me përjashtim të kategorive të mëposhtme:

A. Investime

- (a) letra me vlerë të borxhit, obligacione dhe instrumente të tjera të tregjeve të parasë dhe kapitalit;
- (b) hua;
- (c) aksione dhe pjesëmarrje të tjera me fitim të ndryshueshëm;
- (d) kuota në ndërmarrjet e investimeve kolektive në letra me vlerë të transferueshme dhe në fonde të tjera të investimeve;
- (e) truall, ndërtesa dhe të drejta të pasurive të paluajtshme;

B. Borxhe dhe pretendime

- (f) borxhe të risiguruesve, duke përfshirë edhe pjesën e risiguruesve në provigjonet teknike;
- (g) depozita pranë ndërmarrjeve ceduese dhe borxhe të ndërmarrjeve ceduese;
- (h) borxhe të policëmbajtësve dhe ndërmjetësve të lindura nga operacionet e drejtpërdrejta dhe të risigurimit:
- (i) paradhënie për policat;
- (j) shuma për t'u kthyer nga tatimet;
- (k) kërkesa kundrejt fondit të garancisë;

C. Të tjera

- (l) aktive afatgjata materiale, pa përfshirë toka dhe ndërtesa, të vlerësuar në bazë të një amortizimi me maturi;
- (m) mjete monetare në bankë dhe në arkë, depozita pranë institucioneve të kreditit dhe pranë çdo institucioni tjetër të autorizuar për pranim depozitash;
- (n) kosto të shtyra të marrjes në pronësi;
- (o) interesa dhe qira të llogaritura, të ardhura të tjera të llogaritura dhe parapagesa;
- (p) interesi i kthyeshëm.

2. Në rastin e shoqatës së marrësve në sigurim që njihet me emrin "Lloyd's", kategoritë e aktiveve përfshijnë edhe dorëzanitë dhe letër-kreditë e lëshuara nga institucione kreditimi sipas kuptimit të Direktivës 2000/12/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit [17] ose nga ndërmarrje sigurimesh, së bashku me shumat e verifikueshme që rrjedhin nga policat e sigurimit, për aq sa këto përfaqësojnë funde që u përkasin anëtarëve.

3. Përfshirja e aktiveve apo kategorive të aktiveve të renditura në pikën 1 nuk do të thotë që të gjitha kategoritë e aktiveve pranohen automatikisht si aktive në mbulim të provigjoneve teknike. Shteti Anëtar i origjinës parashikon rregulla më të hollësishme ku të përcaktojë kushtet për përdorimin e aktiveve të pranueshme; në lidhje me këtë, shteti në fjalë mund të kërkojë garanci apo dorëzani të vlefshme, sidomos në rastin e borxheve të risiguruesve.

Gjatë caktimit dhe zbatimit të rregullave që parashikon, Shteti Anëtar i origjinës kujdeset, në veçanti, që të respektohen parimet e mëposhtme:

- (i) aktivet në mbulim të provigjoneve teknike vlerësohen pasi është zbritur borxhi i lidhur me marrjen e tyre;
- (ii) të gjitha aktivet duhen vlerësuar me maturi, duke parashikuar riskun e moskonvertimit të shumave të ndryshme.

Në veçanti, aktivet afatgjata materiale, pa përfshirë toka dhe ndërtesa, mund të pranohen si aktive në mbulim të provigjoneve teknike, vetëm nëse vlerësohen në bazë të amortizimit të kryer

me maturi;

(iii) huatë, pavarësisht nëse u jepen ndërmarrjeve, një shteti apo organizatave ndërkombëtare, apo personave fizikë, mund të pranohen si aktive në mbulim të provigjoneve teknike, vetëm nëse janë të garantuara në mënyrë të mjaftueshme mbështetur në statusin e huamarrësit, me barrë hipotekare, dorëzani bankare ose dorëzani të ndërmarrjeve të sigurimeve apo në forma të tjera garancie;

(iv) instrumente të tilla derivative si, opsionet, kontrata me shitblerje në të ardhmen dhe opsionet e këmbimit të lidhura me aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, mund të përdoren për aq sa kontribuojnë në zvogëlimin e risqeve të investimit apo për aq sa mundësojnë administrimin efikas të portofolit.

Këto instrumente duhen vlerësuar me maturi dhe mund të merren në konsideratë në vlerësimin e aktiveve bazë;

(v) letrat me vlerë të transferueshme, që nuk tregtohen në një treg të rregulluar, mund të pranohen si mbulim për provigjone teknike vetëm nëse mund të konvertohen në para brenda një periudhe të shkurtër ose nëse janë pjesëmarrje në institucione kreditimi, ndërmarrje sigurimesh, brenda kufizimeve që lejon neni 6, ose në ndërmarrje investimesh të vendosura në një Shtet Anëtar;

(vi) borxhet e të tretëve dhe pretendimet ndaj tyre mund të pranohen si mbulim për provigjonet teknike vetëm pasi të jenë zbritur të gjitha shumat që janë të pagueshme tek i njëjti i tretë;

(vii) vlera e çdo borxhi dhe pretendimi të pranuar si mbulim për provigjonet teknike duhet të llogaritet me maturi, duke parashikuar riskun e moskonvertimit të shumave.

Në veçanti, borxhet që kanë policëmbajtësit dhe ndërmjetësit në kuadër të operacioneve të sigurimeve dhe risigurimeve mund të pranohen vetëm për ato shuma që nuk kanë më shumë se tre muaj pa u shlyer;

(viii) kur aktivet e zotëruara përfshijnë një investim në një ndërmarrje të kontrolluar e cila administron të gjitha ose një pjesë të investimeve të ndërmarrjes së sigurimeve për llogari të saj, Shteti Anëtar i origjinës, kur zbaton rregullat dhe parimet e parashikuara me këtë nen, duhet të mbajë në konsideratë aktivet bazë që zotërojnë ndërmarrjet e kontrolluara: Shteti Anëtar i origjinës mund t'i trajtojë në të njëjtën mënyrë aktivet e filialeve të tjera;

(ix) shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim mund të pranohen si mbulim për provigjonet teknike, vetëm për aq sa kjo përputhet me llogaritjen e provigjoneve matematikore.

4. Pavarësisht pikës 1, 2 dhe 3 në rrethana përjashtimore dhe me kërkesën e ndërmarrjes së sigurimeve, Shteti Anëtar i origjinës mund të pranojë përkohësisht dhe me vendim të arsyetuar rregullisht edhe kategori të tjera aktivesh si mbulim për provigjonet teknike, duke zbatuar nenin 22.

Neni 24

Rregullat për diversifikimin e investimeve

1. Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, Shteti Anëtar i origjinës i kërkon çdo ndërmarrjeje sigurimesh të investojë jo më shumë se:

(a) 10 për qind të provigjoneve teknike bruto gjithsej në një truall a ndërtesë ose në disa troje a ndërtesa që ndodhen aq pranë njëra tjetrës, sa të mund të konsiderohen praktikisht një investim i vetëm;

(b) 5 për qind të provigjoneve teknike bruto gjithsej në aksione dhe letra me vlerë të tjera të

negociueshme të trajtuara si aksione, obligacione, letra me vlerë të borxhit dhe instrumente të tjera të tregjeve të parasë dhe kapitalit nga e njëjta ndërmarrje, apo në hua që i jepen të njëjtit huamarrës, ku huatë nuk përfshijnë huatë që i jepen një shteti, autoriteti rajonal a vendor apo një organizate ndërkombëtare në të cilën janë anëtarë një a më shumë Shtete Anëtare.

Ky kufi mund të rritet në 10 për qind nëse ndërmarrja investon jo më shumë se 40 për qind të provigjoneve teknike bruto gjithsej në hua, ose letra me vlerë të organeve emetuese dhe huamarrësve në secilin prej të cilëve nuk investon më shumë se 5 për qind të aktiveve;

(c) 5 për qind të provigjoneve teknike bruto gjithsej në kredi pa garanci, duke përfshirë 1 për qind për çdo kredi të vetme pa garanci, pa përfshirë huatë që u jepen institucioneve të kreditimit, ndërmarrjeve të sigurimeve (për aq sa këtë e lejon neni 6) dhe ndërmarrjeve të investimeve të vendosura në një Shtet Anëtar.

Kufijtë mund të ngrihen, përkatësisht, në 8 për qind dhe 2 për qind me vendim të marrë rast pas rasti nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës;

(d) 3 për qind të provigjoneve teknike bruto gjithsej në formën e mjeteve monetare në arkë;

(e) 10 për qind të provigjoneve teknike bruto gjithsej në aksione, pa përfshirë letrat me vlerë të trajtuara si aksione dhe letra me vlerë të borxhit, të cilat nuk tregohen në një treg të rregulluar.

2. Mungesa e një kufiri në pikën 1 mbi investimet në një kategori të caktuar, nuk do të thotë se aktivet e kategorisë në fjalë do të pranohen si mbulim për provigjonet teknike pa asnjë kufizim.

Shteti Anëtar i origjinës përcakton rregulla më të hollësishme ku vendosen kushtet për përdorimin e aktiveve të pranueshme.

Në veçanti, Shteti Anëtar kujdeset gjatë përcaktimit dhe zbatimit të rregullave në fjalë që të respektohen parimet e mëposhtme:

(i) aktivet në mbulim të provigjoneve teknike duhet të diversifikohen dhe shpërndahen në mënyrë të atillë që të tregohet kujdes që të mos ketë mbështetje të tepruar në një kategori të veçantë të aktiveve, në një treg investimesh apo në një investim të veçantë;

(ii) investimet në lloje të veçanta të aktiveve që shfaqin nivele të larta risku, për shkak të natyrës së aktivit a për shkak të cilësisë së emetuesit, duhet të kufizohen në nivele me maturi;

(iii) kufizimet e vendosura mbi kategori të veçanta të aktiveve duhet të marrin në konsideratë trajtimin e risigurimit gjatë llogaritjes së provigjoneve teknike;

(iv) kur aktivet e zotëruara përfshijnë një investim në një ndërmarrje të kontrolluar e cila administron të gjitha ose një pjesë të investimeve të ndërmarrjes së sigurimeve për llogari të saj, Shteti Anëtar i origjinës, kur zbaton rregullat dhe parimet e parashikuara me këtë nen, duhet të mbajë në konsideratë aktivet bazë që zotërojnë ndërmarrjet e kontrolluara: Shteti Anëtar i origjinës mund t'i trajtojë në të njëjtën mënyrë aktivet e filialeve të tjera;

(v) përqindja e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike që u nënshtrohen investimeve jolikuide duhet të mbahet në një nivel të caktuar me maturi;

(vi) kur në aktivet në zotërim përfshihen hua që u janë dhënë institucioneve të caktuara të kreditimit, apo letra me vlerë të borxhit të emetuara prej këtyre të fundit, Shteti Anëtar i origjinës, gjatë zbatimit të rregullave dhe parimeve të parashikuara në këtë nen, mund të marrë në konsideratë aktivet bazë në zotërim të institucioneve të kreditimit në fjalë.

Ky trajtim mund të zbatohet vetëm kur institucioni i kreditimit e ka zyrën qendrore në një Shtet Anëtar, është tërësisht në pronësi të atij Shteti Anëtar dhe/ose të autoriteteve vendore të atij shteti dhe veprimtaria tregtare e tij, sipas aktit të themelimit dhe statutit, konsiston në dhënien përmes ndërmjetësve të tij të kredive atyre shteteve apo autoriteteve vendore ose të kredive organeve që janë të lidhura ngushtë me shtetin apo me autoritetet vendore.

3. Në kuadër të rregullave të hollësishme ku caktohen kushtet për përdorimin e aktiveve të pranueshme, Shteti Anëtar ushtron trajtim më kufizues për:

- kredinë e pashoqëruar me dorëzani bankare, dorëzani të lëshuar nga një ndërmarrje sigurimesh, garanci hipotekare apo çfarëdo forme tjetër garancie, në krahasim me kreditë që shoqërohen me një kolateral të tillë,

- sipërmarrjet e investimeve kolektive në letra me vlerë të transferueshme jo të bashkërenduara sipas kuptimit të Direktivës 85/611/KEE (13) dhe fondet e tjera të investimeve, në krahasim me sipërmarrjet e investimeve kolektive në letra me vlerë të transferueshme të bashkërenduara sipas kuptimit të direktivës së sipërpërmendur,

- letrat me vlerë që nuk tregtohen në një treg të rregulluar, në krahasim me ato që tregtohen në një treg të rregulluar,

- obligacionet, letrat me vlerë të borxhit dhe instrumentet e tjera të tregjeve të parasë dhe të kapitalit jo të emetuara nga shtetet, autoritetet vendore a rajonale apo ndërmarrje që i përkasin Zonës A sipas përkufizimit në Direktivën 2000/12/KE, apo nga emetues që janë organizata ndërkombëtare tek anëtarët e të cilëve nuk ka të paktën as edhe një Shtet Anëtar, në krahasim me të njëjtat instrumente financiare të emetuara nga organe të tilla.

4. Shtetet Anëtare mund ta ngrenë kufirin e parashikuar në pikën 1 shkronja "b" në 40 për qind për disa letra me vlerë të veçanta borxhi, nëse këto emetohen nga një institucion kreditimi me zyrë qendrore në një Shtet Anëtar që i nënshtrohet me ligj mbikëqyrjes së posaçme zyrtare, që synon të mbrojë zotëruesit e letrave me vlerë të borxhit në fjalë.

Në veçanti, shumat që rrjedhin nga emetimi i letrave të tilla me vlerë të borxhit duhet të investohen në përputhje me ligjin në aktive të cilat gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së letrave me vlerë të borxhit janë në gjendje të mbulojnë detyrimet që lidhen me to dhe të cilat, në rast kolapsi të emetuesit, do të përdoren me prioritet për kthimin e principalit dhe pagesën e interesit të llogaritur.

5. Shtetet Anëtare nuk u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve të investojnë në kategori të veçanta të aktiveve.

6. Pavarësisht pikës 1, në rrethana përjashtimore dhe me kërkesën e ndërmarrjes së sigurimeve, Shteti Anëtar i origjinës mund të lejojë përkohësisht dhe me vendim të arsyetuar në mënyrë të rregullt përjashtime nga rregullat e parashikuara në pikën 1 shkronjat nga "a" në "e", duke zbatuar nenin 22.

Neni 25

Kontratat që kanë lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm ose me indeksin e aksioneve

1. Kur pagesat e parashikuara nga kontrata lidhen drejtpërdrejt me vlerën e kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive për titujt e transferueshëm, ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga ndërmarrja e sigurimeve, zakonisht e pjesëtuar në kuota, provigjonet teknike në lidhje me ato pagesa duhet të paraqiten sa më afërsisht sipas kuotave në fjalë ose, kur nuk mund të përcaktohen kuotat, sipas aktiveve në fjalë.

2. Kur pagesat e parashikuara nga kontrata lidhen drejtpërdrejt me një indeks aksionesh ose me një vlerë tjetër mbështetëse që nuk përfshijnë ato të përmendura në pikën 1, provigjonet teknike në lidhje me ato pagesa duhet të paraqiten sa më afërsisht sipas kuotave në fjalë që mendohet se përfaqësojnë vlerën mbështetëse ose, kur nuk mund të përcaktohen kuotat, sipas aktiveve me garanci dhe tregtueshmëri të përshtatshme të cilat përkrijnë sa më afërsisht me ato mbi të cilat bazohet vlera e veçantë mbështetëse.

3. Neni 22 dhe 24 nuk zbatohet për aktivet e mbajtura në mbulim të përgjegjësive të përputhura të cilat lidhen drejtpërdrejt me pagesat e përmendura në pikën 1 dhe 2.

Me provigjone teknike në nenin 24 kuptohen provigjonet teknike pa përfshirë ato që lidhen me përgjegjësi të tilla.

4. Kur pagesat e përmendura në pikën 1 dhe 2 përfshijnë garanci të ecurisë së investimit ose pagesa të tjera të garantuara, provigjonet teknike korresponduese shtesë u nënshtrohen neneve 22, 23 dhe 24.

Neni 26

Rregullat e përputhjes

1. Në kuptim të nenit 20 pika 3 dhe nenit 54, në lidhje me rregullat e përputhjes Shtetet Anëtare zbatojnë Shtojcën II.

2. Ky nen nuk zbatohet për angazhimet e përmendura në nenin 25.

KAPITULLI 3

RREGULLAT NË LIDHJE ME NIVELIN E AFTËSISË PAGUESE DHE FONDIN E GARANCISË

Neni 27

Niveli i aftësisë paguese në dispozicion

1. Çdo Shtet Anëtar i kërkon çdo ndërmarrjeje sigurimesh, me zyra qendrore në territorin e tij, të ketë në çdo kohë një nivel të mjaftueshëm të aftësisë paguese në dispozicion në lidhje me të gjithë veprimtarinë tregtare, i cili të jetë të paktën sa kërkesat e kësaj direktive.

2. Niveli i aftësisë paguese në dispozicion konsiston në aktive të ndërmarrjes së sigurimeve të cilat nuk janë të zëna me asnjë pasiv të parashikueshëm, duke u zbritur zërat e aktiveve jomateriale, ku përfshihen:

(a) kapitali aksionar i shlyer ose, në rastin e ndërmarrjes kolektive të sigurimeve, fondi themeltar efektiv plus çdo llogari të anëtarëve që përmbushin kriteret e mëposhtme:

(i) në aktin e themelimit dhe në statut duhet të përcaktohet që nga këto llogari anëtarët mund të marrin pagesa vetëm për aq sa kjo nuk shkakton që niveli i aftësisë paguese në dispozicion të bjerë nën nivelin e kërkuar ose, pas prishjes së ndërmarrjes, nëse janë shlyer të gjitha borxhet e tjera të ndërmarrjes;

(ii) në aktin e themelimit dhe në statut duhet të përcaktohet, në lidhje me çdo pagesë të përmendur në nënpikën "i" që bëhet për arsye që nuk kanë të bëjnë me largimin e anëtarit nga

ndërmarrja, se duhen njoftuar autoritetet kompetente të paktën një muaj përpara dhe se këto autoritete mund ta ndalojnë pagesën brenda këtij afati;

(iii) dispozitat përkatëse të aktit të themelimit dhe statutit mund të ndryshohen vetëm pasi autoritetet kompetente të jenë shprehur se nuk kanë asnjë kundërshtim për ndryshimin, pa cenuar kriteret e parashikuara në nën pikën "i" dhe "ii";

(b) rezervat (ligjore dhe të lira) që nuk janë të lidhura me përgjegjësitë e kontraktuara;

(c) fitimi ose humbja e mbartur pasi janë zbritur dividendët për t'u shpërndarë;

(d) për aq sa lejohet në zbatim të legjislacionit kombëtar, rezervat e fitimit të paraqitura në bilanc kur këto mund të përdoren për të mbuluar humbjet që mund të lindin, dhe kur kjo rezervë nuk është vendosur në dispozicion të shpërndarjes për policëmbajtësit.

Niveli i aftësisë paguese në dispozicion zvogëlohet duke i zbritur shumën e aksioneve të veta që mban drejtpërdrejt ndërmarrja e sigurimeve.

3. Niveli i aftësisë paguese në dispozicion mund të përbëhet edhe nga:

(a) kapitali në formë aksionesh progresive me përparësi dhe kapitali i borxhit të varur deri në 50 për qind të nivelit më të ulët të aftësisë paguese në dispozicion, jo më shumë se 25 për qind e të cilit të përbëhet nga borxhe të varura me datë fikse shlyerjeje, ose kapital në formë aksionesh progresive me përparësi me afat fikse, me kusht që të ketë marrëveshje detyruese sipas të cilave, në rast falimentimi apo likuidimi të ndërmarrjes së sigurimeve kapitali në formë borxhi të varur ose kapitali në formë aksionesh me përparësi të renditet pas të drejtave të të gjithë kreditorëve të tjerë dhe të mos shlyhet pa u shlyer të gjitha borxhet e tjera të pashlyera ende.

Kapitali i borxhit të varur duhet të përmbushë edhe këto kushte:

(i) në konsideratë të merren vetëm fondet e paguara plotësisht;

(ii) për kreditë me datë fikse kthimi, afati fillestar i kthimit të jetë të paktën pesë vjet.

Jo më vonë se një vit përpara datës së shlyerjes ndërmarrja e sigurimeve duhet t'u paraqesë për miratim autoriteteve kompetente një plan ku tregohet se do të ruhet apo sigurohet niveli i aftësisë paguese në dispozicion pas afatit të shlyerjes, nëse shkalla e konsiderimit të borxhit si pjesë përbërëse e nivelit të aftësisë paguese në dispozicion nuk zvogëlohet gradualisht gjatë të paktën pesë viteve të fundit përpara datës së shlyerjes.

Autoritetet kompetente mund të autorizojnë shlyerje të hershme të një borxhi të tillë me kusht që të jetë paraqitur kërkesë nga ndërmarrja e sigurimeve që e ka marrë borxhin, dhe me kusht që niveli i aftësisë paguese në dispozicion të mos bjerë nën nivelin e kërkuar;

(iii) borxhi me datë kthimi të pacaktuar duhet të jetë i shlyeshëm vetëm pas një njoftimi paraprak prej pesë vjetësh, me përjashtim të rastit kur borxhi në fjalë nuk konsiderohet më si pjesë përbërëse e nivelit të aftësisë paguese në dispozicion ose me përjashtim të rastit kur kërkohet në mënyrë specifike pëlqimi paraprak i autoriteteve kompetente për shlyerje të hershme.

Në rastin e dytë ndërmarrja e sigurimeve duhet të njoftojë autoritetet kompetente të paktën gjashtë muaj përpara datës së shlyerjes së propozuar, duke përcaktuar nivelin e aftësisë paguese në dispozicion dhe nivelin e aftësisë paguese të kërkuar si përpara ashtu edhe pas shlyerjes në fjalë.

Autoritetet kompetente e autorizojnë shlyerjen vetëm nëse niveli i aftësisë paguese në dispozicion të ndërmarrjes së sigurimeve nuk bie poshtë nivelit të kërkuar;

(iv) kontrata e borxhit nuk duhet të përfshijë asnjë klauzolë e cila parashikon që në rrethanat e përcaktuara, me përjashtim të mbylljes së ndërmarrjes së sigurimeve, borxhi duhet të shlyhet përpara datës së shlyerjes për të cilën është rënë dakord më parë;

(v) kontrata e borxhit mund të ndryshohet vetëm pasi autoritetet kompetente kanë deklaruar se

nuk kanë asnjë kundërshtim për ndryshimin;

(b) letra me vlerë pa datë të përcaktuar shlyerjeje dhe instrumente të tjera, duke përfshirë edhe aksionet progresive me përparësi, përveç atyre të përmendura në shkronjën "a", deri në 50 për qind të nivelit më të ulët të aftësisë paguese në dispozicion për vlerën gjithsej të këtyre letrave me vlerë dhe kapitalit të borxhit varur të përmendur në shkronjën "a", nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme:

(i) nuk mund të shlyhen me nismën e prurësit ose pa pëlqimin paraprak të autoritetit kompetent;

(ii) kontrata e emetimit duhet t'i japë mundësi ndërmarrjes së sigurimeve ta shtyjë në kohë pagimin e interesit mbi borxhin;

(iii) pretendimet e huadhënësit kundrejt ndërmarrjes së sigurimeve duhet të renditet tërësisht pas pretendimeve të kreditorëve jo të varur;

(iv) dokumentet që rregullojnë emetimin e letrave me vlerë duhet të parashikojnë kapacitetin humbje-thithës të borxhit dhe interesit të papaguar, duke i dhënë në të njëjtën kohë mundësi ndërmarrjes së sigurimeve ta vazhdojë veprimtarinë e saj tregtare;

(v) në konsideratë të merren vetëm fondet e paguara plotësisht.

4. Me kërkesë të mbështetur në prova të ndërmarrjes, që i paraqitet autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e atij autoriteti kompetent, niveli i aftësisë paguese në dispozicion mund të përbëhet edhe nga:

(a) deri më 31 dhjetor 2009, një vlerë e barabartë me 50 për qind të fitimeve të ardhshme të ndërmarrjes, por jo më shumë se 25 për qind e nivelit të aftësisë paguese në dispozicion ose të nivelit të aftësisë paguese të kërkuar, cilado qoftë më e vogla.

Vlera e fitimeve të ardhshme gjendet duke shumëzuar fitimin e çmuar vjetor me një koeficient që përfaqëson periudhën e mbetur deri në mbyllje të policave.

Koeficienti i përdorur nuk mund të jetë më i madh se gjashtë.

Fitimi i çmuar vjetor nuk mund të jetë më i madh se mesatarja matematikore e fitimeve të arritura gjatë pesë viteve të fundit financiare në veprimtaritë e renditura në nenin 2 pika 1.

Autoritetet kompetente mund të japin pëlqimin për të përfshirë një shumë të tillë për nivelin e aftësisë paguese në dispozicion vetëm:

(i) kur autoriteteve kompetente u paraqitet një raport aktuarial në të cilin mbështetet probabiliteti i lindjes së këtyre fitimeve në të ardhmen; dhe

(ii) për aq sa kjo pjesë e fitimeve të ardhshme që lind nga rezervat e fshehura neto të përmendura në shkronjën "c" nuk është marrë në konsideratë më parë;

(b) kur nuk përdoret Zillmerizimi ose kur, nëse përdoret, është më pak se tarifa për kostot e blerjes e përfshirë në prim, diferenca mes provigjionit matematikor të Zillmerizuar ose pjesërisht të Zillmerizuar dhe provigjionit matematikor të Zillmerizuar me një normë të barabartë me tarifën për kostot e blerjes përfshirë në prim.

Por kjo shifër nuk mund të jetë më e madhe se 3,5 për qind e shumës së diferencës mes shumave përkatëse të kapitalit të veprimtarive të sigurimit të jetës dhe provigjioneve matematikore, për të gjitha policat për të cilat është i mundshëm Zillmerizimi.

Diferenca zvogëlohet me shumën e çdo kostoje të paamortizuar blerjeje të regjistruar si aktiv;

(c) çdo rezervë e fshehtë neto që lind nga vlerësimi i aktiveve, për aq sa këto rezerva të fshehta neto nuk kanë natyrë të jashtëzakonshme;

(d) një e dyta e fondit themeltar ose kapitalit aksionar të papaguar, pasi pjesa e paguar të përbëjë 25 për qind të fondit ose kapitalit aksionar në fjalë, deri në 50 për qind të nivelit të aftësisë paguese në dispozicion ose të nivelit të aftësisë paguese të kërkuar, cilido qoftë më i ulëti.

5. Shtesat dhe ndryshimet e pikave 2, 3 dhe 4 që do të bëhen për të marrë në konsideratë zhvillimet që justifikojnë një rregullim teknik të elementeve që lejohen të përfshihen në nivelin e aftësisë paguese miratohen në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 65 pika 2.

Neni 28

Niveli i aftësisë paguese i kërkuar

1. Në varësi të nenit 29, niveli i aftësisë paguese të kërkuar përcaktohet sikurse parashikohet në pikat nga 2 deri në 7 në përputhje me klasat e marrjes në sigurim.

2. Për llojet e sigurimit të përmendura në nenin 2 pika 1 shkronja "a" dhe "b" me përjashtim të sigurimeve të lidhura me fondet e investimeve dhe për operacionet e përmendura në nenin 2 pika 3, niveli i aftësisë paguese të kërkuar është i barabartë me shumën e dy rezultateve të mëposhtme:

(a) rezultati i parë: një thyesë prej 4 për qind e provigjoneve matematikore të lidhura me veprimtarinë e drejtpërdrejtë dhe me risigurimin duke përfshirë edhe cedimet në risigurim shumëzohet me raportin, për vitin e fundit financiar, të provigjoneve matematikore gjithsej pasi u janë zbritur cedimet në risigurim mbi provigjonet matematikore gjithsej bruto.

Ky raport nuk mund të jetë asnjëherë më i vogël se 85 për qind;

(b) rezultati i dytë: për policat mbi të cilat kapitali në rrezik nuk është shifër negative, një thyesë prej 0,3 për qind e këtij kapitali të marrë në sigurim nga ndërmarrja e sigurimeve shumëzohet me raportin, për vitin e fundit financiar, të kapitalit gjithsej në rrezik të mbajtur si pasiv i ndërmarrjes pas cedimeve në risigurim dhe retrocedimeve mbi kapitalin gjithsej në rrezik që përfshin edhe risigurimin; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më i vogël se 50 për qind.

Për sigurimin e përkohshëm të vdekjes me afat maksimal tre vjet kjo thyesë është 0,1 për qind.

Për një sigurim të tillë me periudhë më të gjatë se tre vjet por jo më shumë se pesë vjet thyesa e mësipërme është 0,15 për qind.

3. Për sigurimet shtesë të përmendura në nenin 2 pika 1 shkronja "c", niveli i aftësisë paguese të kërkuar është i barabartë me nivelin e aftësisë paguese të kërkuar për ndërmarrjet e sigurimeve të parashikuar në nenin 16 a të Direktivës 73/239/KEE, pa përfshirë dispozitat e nenit 17 të asaj direktive.

4. Për sigurimin e përhershëm të shëndetit që nuk mund të anulohet sipas parashikimit në nenin 2 pika 1 shkronja "d" niveli i aftësisë paguese të kërkuar është i barabartë me:

(a) një thyesë prej 4 për qind të provigjoneve matematikore, llogaritur në përputhje me pikën 2 shkronja "a" të këtij neni; plus

(b) nivelin e aftësisë paguese të kërkuar për ndërmarrjet e sigurimeve të parashikuar në nenin 16 a të Direktivës 73/239/KEE, pa përfshirë dispozitat e nenit 17 të asaj direktive.

Por kushti që parashikon neni 16a pika 8 shkronja "b" e asaj direktive se duhet krijuar një provigjon për rritjen e moshës, mund të zëvendësohet me një kërkesë që veprimtaria tregtare të ushtrohet në bazë grupi.

5. Për operacionet e riblerjes së kapitalit, të përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "b", niveli i aftësisë paguese të kërkuar është i barabartë me një thyesë prej 4 për qind të provigjoneve

matematikore llogaritur në përputhje me nenin 2 shkronja "a" të këtij neni.

6. Për tontinat, të përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "a", niveli i aftësisë paguese të kërkuar është i barabarë me 1 për qind të aktiveve të tyre.

7. Për sigurimet e mbuluara me nenin 2 pika 1 shkronja "a" dhe "b" të lidhura me fondet e investimeve, dhe për operacionet e përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "c", "d" dhe "e", niveli i aftësisë paguese të kërkuar është i barabartë me shumën e të mëposhtmeve:

(a) për aq sa ndërmarrja e sigurimeve mban risk investimi, një thyesë prej 4 për qind e provigjoneve teknike, llogaritur në përputhje me pikën 2 shkronja "a" të këtij neni;

(b) për aq sa ndërmarrja e sigurimeve nuk mban risk investimi por shpërndarja e shpenzimeve të administrimit është e përcaktuar për një periudhë më të gjatë se pesë vjet, një thyesë prej 1 për qind e provigjoneve teknike, llogaritur në përputhje me pikën 2 shkronja "a" të këtij neni;

(c) për aq sa ndërmarrja e sigurimeve nuk mban risk investimi por shpërndarja e shpenzimeve të administrimit është e përcaktuar për një periudhë më të gjatë se pesë vjet, një vlerë e barabartë me 25 për qind të shpenzimeve administrative neto të vitit të fundit financiar që i përketin kësaj veprimtarie tregtare;

(d) për aq sa ndërmarrja e sigurimeve mbulon risk vdekjeje, një thyesë prej 0,3 për qind e kapitalit në rrezik, llogaritur në përputhje me pikën 2 shkronja "b" të këtij neni.

Neni 29

Fondi i garancisë

1. Një e treta e nivelit të aftësisë paguese të kërkuar sipas nenit 28 përbën fondin e garancisë.

Ky fond përbëhet nga zërat e renditur në nenin 27 pika 2, pika 3 dhe, me pëlqimin e autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, pika 4 shkronja "c".

2. Fondi i garancisë nuk mund të jetë më i vogël se 3 milion euro.

Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë një zvogëlim prej një të katërtat e fondit minimal të garancisë në rastin e fondeve të përbashkëta dhe të fondeve të ngjashme me to dhe në rastin e tontinave.

Neni 30

Shqyrtimi i shumës së fondit të garancisë

1. Shuma në euro e parashikuar në nenin 29 pika 2 shqyrtohet çdo vit duke filluar nga data 20 shtator 2003, për të marrë në konsideratë ndryshimet e indeksit evropian të çmimeve të konsumit duke përfshirë të gjitha Shtetet Anëtare i cili publikohet nga Eurostati.

Kjo shumë përshtatet automatikisht, duke e rritur shumën bazë në euro me ndryshimin në përqindje të indeksit të lartpërmendur gjatë periudhës nga data 20 mars 2002 dhe datës së shqyrtimit dhe duke e rrumbullakosur në një shumëfish të 100 mijë eurove.

Nëse ndryshimi në përqindje pas përshtatjes më të fundit është më i vogël se 5 për qind, nuk bëhet asnjë përshtatje.

2. Komisioni informon çdo vit Parlamentin Evropian dhe Këshillin për këtë shqyrtim dhe për shumën e përshtatur të përmendur në pikën 1.

Neni 31

Aktivet që nuk përdoren në mbulim të provigjoneve teknike

1. Shtetet Anëtare nuk përcaktojnë asnjë rregull lidhur me zgjedhjen e aktiveve që nuk është nevoja të përdoren si aktive në mbulim të provigjoneve teknike të përmendura në nenin 20.
2. Në varësi të nenit 20 pika 3, nenit 37 pika 1, 2, 3 dhe 5 dhe paragrafit të dytë të pikës 1 të nenit 39, Shtetet Anëtare nuk e kufizojnë përdorimin e lirë të atyre aktiveve, të luajtshme ose jo, që janë pjesë e aktiveve të ndërmarrjeve të autorizuara të sigurimeve.
3. Pikat 1 dhe 2 nuk përjashtojnë asnjë masë që Shtetet Anëtare, duke mbrojtur interesat e personave të siguruar, kanë të drejtë marrin si pronare ose ortakë të ndërmarrjes së sigurimeve në fjalë.

KAPITULLI 4

LEGJISLACIONI PËR KONTRATAT DHE KUSHTET E SIGURIMIT

Neni 32

Legjislacioni i zbatueshëm

1. Legjislacioni i zbatueshëm për kontratat në lidhje me veprimtaritë e përmendura në këtë direktivë është legjislacioni i Shtetit Anëtar të angazhimit.
Por, kur e lejon legjislacioni i shtetit të lartpërmendur, palët mund të zgjedhin legjislacionin e një vendi tjetër.
2. Kur policëmbajtësi është person fizik dhe e ka vendbanimin e përhershëm në një Shtet Anëtar që nuk është Shteti Anëtar shtetas i të cilit është, palët mund të zgjedhin legjislacionin e Shtetit Anëtar shtetas i të cilit është policëmbajtësi.
3. Kur një shtet ka disa njësi territoriale, të cilat kanë rregullat e veta ligjore në lidhje me detyrimet kontraktore, secila njësi konsiderohet si një vend në kuptimin e identifikimit të legjislacionit të zbatueshëm sipas kësaj direktive.
Shteti Anëtar, në të cilin disa njësi të ndryshme territoriale kanë rregullat e veta ligjore, në lidhje me detyrimet kontraktore, nuk është i detyruar t'i zbatojë dispozitat e kësaj direktive për konfliktet që lindin midis legjislacioneve të njëjësive në fjalë.
4. Asnjë parashikim i këtij neni nuk e pengon zbatimin e rregullave ligjore të forumit kur janë të detyrueshme, pavarësisht nga legjislacioni që zbatohet përndryshe për kontratën.
Nëse parashikohet nga legjislacioni i Shtetit Anëtar, rregullat e detyrueshme të legjislacionit të Shtetit Anëtar të angazhimit mund të zbatohen, në qoftë se dhe për aq sa, sipas legjislacionit të atij Shteti Anëtar këto rregulla duhen zbatuar, pavarësisht legjislacionit të zbatueshëm për kontratën.
5. Në varësi të pikave nga 1 deri në 4, Shtetet Anëtare zbatojnë, për kontratat e sigurimeve të përmendura në këtë direktivë, rregullat e tyre të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare private

në lidhje me detyrimet kontraktore.

Neni 33

E mira e përgjithshme

Shteti Anëtar i angazhimit nuk e pengon policëmbajtësin që të lidhë kontratë me një ndërmarrje sigurimesh të autorizuar sipas kushteve të nenit 4, nëse kjo nuk bie ndesh me dispozitat ligjore që mbrojnë të mirën e përgjithshme në Shtetin Anëtar të angazhimit.

Neni 34

Rregullat në lidhje me kushtet e sigurimit dhe shkallët e primeve

Shtetet Anëtare nuk miratojnë dispozita që kërkojnë miratimin paraprak apo njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policave, shkallëve të primeve, bazave teknike të përdorura për llogaritjen e shkallëve të primeve dhe provigjoneve teknike, apo të formularëve e dokumenteve të tjera të shtypura që mendon të përdorë ndërmarrja e sigurimeve në marrëdhëniet e veta me policëmbajtësit.

Pavarësisht paragrafit të parë, për qëllimin e vetëm të verifikimit të pajtueshmërisë me dispozitat kombëtare lidhur me parimet aktuariale, Shteti Anëtar i origjinës mund të kërkojë njoftimin sistematik të bazave teknike të përdorura, në veçanti për llogaritjen e shkallëve të primeve dhe të provigjoneve teknike, por kjo kërkesë nuk mund të përbëjë kusht paraprak që ndërmarrja e sigurimeve të ushtrojë veprimtarinë e vet tregtare.

Jo më vonë se data 1 korrik 1999, Komisioni i paraqet Këshillit një raport për zbatimin e këtyre dispozitave.

Neni 35

Afati i anulimit

1. Çdo Shtet Anëtar parashikon që policëmbajtësi që lidh një kontratë individuale të sigurimit të jetës të ketë në dispozicion një afat prej 14 deri në 30 ditë nga koha kur është informuar për lidhjen e kontratës, brenda të cilit të mund ta anulojë kontratën.

Dhënia e njoftimit të anulimit nga ana e policëmbajtësit e çliron atë prej çdo detyrimi të ardhshëm që lind nga kontrata.

Pasojat e tjera ligjore dhe kushtet e anulimit përcaktohen nga legjislacioni i zbatueshëm për kontratën sipas parashikimeve të nenit 32, sidomos në lidhje me rregullimet për informimin e policëmbajtësit për lidhjen e kontratës.

2. Shtetet Anëtare nuk e kanë të nevojshme ta zbatojnë pikën 1 për kontratat me kohëzgjatje gjashtë muaj ose më pak dhe as atëherë kur, për shkak të statusit të policëmbajtësit ose të rrethanave në të cilat lidhet kontrata, policëmbajtësi nuk ka nevojë për këtë mbrojtje të veçantë.

Shtetet Anëtare përcaktojnë në rregullat e tyre se kur nuk zbatohet pika 1.

Neni 36

Informimi i policëmbajtësve

1. Përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, policëmbajtësit i njoftohet të paktën informacioni i

renditur në Shtojcën III Pjesa "A".

2. Policëmbajtësi mbahet i informuar gjatë gjithë periudhës së kontratës, për çdo ndryshim që ka të bëjë me informacionin e renditur në Shtojcën III Pjesa "B".

3. Shteti Anëtar i angazhimit mund t'u kërkojë ndërmarrjeve të sigurimeve të vendosin në dispozicion informacione të tjera krahas atyre që renditen në Shtojcën III, vetëm nëse janë të nevojshme që policëmbajtësi të kuptojë siç duhet elementet thelbësore të angazhimit.

4. Rregullat e hollësishme për vënien në zbatim të këtij neni dhe të Shtojcës III parashikohen nga Shteti Anëtar i angazhimit.

KAPITULLI 5 NDËRMARRJET E SIGURIMEVE NË SITUATË TË VËSHTIRË OSE NË SITUATË PARREGULLSIE

Neni 37

Ndërmarrjet e sigurimeve në vështirësi

1. Nëse ndërmarrja e sigurimeve nuk i përmbush dispozitat e nenit 20, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës mund ta ndalojë përdorimin e lirë të aktiveve të ndërmarrjes pasi ua ka komunikuar këtë vendim autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare të angazhimit.

2. Në funksion të rimëkëmbjes së situatës financiare të ndërmarrjes së sigurimeve niveli i aftësisë paguese të së cilës ka rënë poshtë nivelit minimal që kërkon neni 28, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës kërkon paraqitjen për miratim të një plani për rivendosjen e një situatë financiare të shëndoshë.

Në rrethana përjashtimore, autoriteti kompetent mund ta kufizojë apo ndalojë përdorimin e lirë të aktiveve të ndërmarrjes së sigurimeve, nëse është i mendimit se situata financiare e ndërmarrjes së sigurimeve do të përkeqësohet edhe më tej.

Autoriteti në fjalë informon autoritetet e Shteteve Anëtare në territorin e të cilave ushtron veprimtari tregtare ndërmarrja e sigurimeve, për çdo masë që ka marrë, dhe këto autoritete marrin të njëjtat masa me kërkesën e autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës.

3. Nëse niveli i aftësisë paguese bie nën nivelin e fondit të garancisë të përcaktuar në nenin 29, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës i kërkon ndërmarrjes së sigurimeve të paraqesë për aprovim prej tij një skemë financimi afatshkurtër.

Autoriteti në fjalë mund të kufizojë a ndalojë edhe përdorimin e lirë të aktiveve të ndërmarrjes së sigurimeve.

Autoriteti në fjalë informon për këtë autoritetet e Shteteve Anëtare në territorin e të cilave ushtron veprimtari tregtare ndërmarrja e sigurimeve dhe këto autoritete marrin të njëjtat masa me kërkesën e autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës.

4. Autoritetet kompetente mund të marrin gjithashtu të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e personave të siguruar në rastet e parashikuara në pikën 1, 2 dhe 3.

5. Çdo Shtet Anëtar merr masat e nevojshme që, në përputhje me legjislacionin e vet kombëtar, të mund të ndalojë përdorimin e lirë të aktiveve që ndodhen në territorin e tij, në rastet e parashikuara në pikën 1, 2 dhe 3, me kërkesën e Shtetit Anëtar të origjinës të ndërmarrjes së sigurimeve i cili përcakton aktivet që janë objekt i këtyre masave.

Neni 38

Plani i rimëkëmbjes financiare

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë tagrin për të kërkuar një plan të rimëkëmbjes financiare, për ato ndërmarrje të sigurimeve në të cilat autoritetet kompetente mendojnë se të drejtat e policëmbajtësve ndodhen në rrezik.

Plani i rimëkëmbjes financiare duhet të përfshijë të paktën informacione ose prova të lidhura me tre vitet e ardhshme financiare në lidhje me:

- (a) çmuarjet e shpenzimeve të administrimit, sidomos çmuarjet e shpenzimeve të përgjithshme korente dhe të komisioneve;
- (b) një plan ku jepen çmuarjet e të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë tregtare, marrjen në risigurim dhe cedimin në risigurim;
- (c) një parashikim të bilancit;
- (d) çmuarjet e burimeve financiare me të cilat mendohet të mbulohen përgjegjësitë e kontraktuara dhe niveli i aftësisë paguese të kërkuar;
- (e) politikën e përgjithshme të risigurimit.

2. Kur të drejtat e policëmbajtësve vihen në rrezik, ngaqë po përkeqësohet pozicioni financiar i ndërmarrjes, Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë tagrin për t'i detyruar ndërmarrjet e sigurimeve të kenë një nivel më të lartë të kërkuar të aftësisë paguese, në mënyrë që të sigurojnë që ndërmarrja e sigurimeve të jetë në gjendje t'i përmbushë kërkesat e aftësisë paguese në të ardhmen e afërt.

Shkalla e këtij niveli më të lartë të aftësisë paguese të kërkuar bazohet në një plan të rimëkëmbjes financiare të përmendur në pikën 1.

3. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë tagrin për të zvogëluar të gjitha elementet që mund të përfshihen në nivelin e aftësisë paguese në dispozicion, sidomos, kur ka pasur një ndryshim të ndjeshëm të vlerës së tregut të këtyre elementeve pas mbylljes së vitit të fundit financiar.

4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë tagrin për ta ulur zvogëlimin, e bazuar te risigurimi, të nivelit të aftësisë paguese të përcaktuar në përputhje me nenin 28 kur:

- (a) natyra ose cilësia e kontratave të risigurimit ka ndryshuar ndjeshëm pas mbylljes së vitit të fundit financiar;
- (b) ka një kalim të papërfillshëm të riskut në bazë të kontratave të risigurimit ose nuk ka fare një kalim të tillë të riskut në bazë të këtyre kontratave.

5. Nëse autoritetet kompetente kanë kërkuar një plan të rimëkëmbjes financiare për ndërmarrjen e sigurimeve në përputhje me pikën 1, ato nuk e japin certifikatën sipas nenit 14 pika 1, nenit 40 pika 3 paragrafi i dytë dhe nenit 42 pika 1 shkronja "a", për sa kohë mendojnë se të drejtat e policëmbajtësve janë në rrezik sipas pikës 1.

Neni 39

Tërheqja e autorizimit

1. Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës mund ta tërheqë autorizimin që i ka dhënë ndërmarrjes së sigurimeve nëse kjo e fundit:

(a) nuk e shfrytëzon këtë autorizim brenda 12 muajve, heq dorë shprehimisht prej tij ose e pushon veprimtarinë tregtare për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, me përjashtim të rasteve kur Shteti Anëtar në fjalë ka parashikuar skadimin e autorizimit në raste të tilla;

(b) nuk i përmbush më kushtet e pranimit;

(c) nuk ka mundur, brenda afatit të lejuar, të marrë masat e parashikuara në planin e rimëkëmbjes ose në skemën e financimit të përmendur në nenin 37;

(d) ka mospërmbushje serioze të detyrimeve që rrjedhin nga aktet normative objekt i të cilave është.

Në rast tërheqjeje ose skadimi të autorizimit, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës njofton për këtë autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të tjera dhe këto të fundit marrin masat e duhura që të mos e lejojnë ndërmarrjen e sigurimeve të rinisë operacione të reja në territorin e tyre në kuadër të lirisë së vendosjes apo të lirisë për të ofruar shërbime.

Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës, në bashkëpunim me këto autoritete, merr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e personave të siguruar dhe, sidomos, kufizon përdorimin e lirë të aktiveve të ndërmarrjes së sigurimeve në përputhje me nenin 37 pika 1, pika 2 paragrafi i dytë ose pika 3 paragrafi i dytë.

2. Çdo vendim për tërheqje autorizimi duhet të jetë i mbështetur në arsye precize dhe duhet t'i njoftohet ndërmarrjes së sigurimeve në fjalë.

TITULLI IV

DISPOZITAT E LIDHURA ME TË DREJTËN E VENDOSJES DHE LIRINË PËR TË OFRUAR SHËRBIME

Neni 40

Kushtet për vendosjen e degës

1. Ndërmarrja e sigurimeve që propozon të vendosë një degë në territorin e një Shteti Anëtar tjetër njofton autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës.

2. Shtetet Anëtare i kërkojnë çdo ndërmarrjeje sigurimesh që propozon të vendosë një degë në territorin e një Shteti Anëtar tjetër të japë informacionin e mëposhtëm në kuadër të njoftimit të parashikuar në pikën 1:

(a) Shtetin Anëtar në territorin e të cilit propozon të vendosë degën;

(b) një skemë të operacioneve ku, ndër të tjera, paraqiten llojet e veprimtarive tregtare të parashikuara dhe organizimi strukturor i degës;

(c) adresa e degës në Shtetin Anëtar nga e cila mund të merren dhe të dorëzohen dokumentet, nëse kjo do të jetë adresa ku do të bëhen të gjitha komunikimet me agjentin e autorizuar;

(d) emri i agjentit të autorizuar të degës, i cili duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për të vepruar në emër dhe për llogari të ndërmarrjes së sigurimeve përpara të tretëve dhe për ta

përfaqësuar në marrëdhëniet me autoritetet dhe gjykatat e Shtetit Anëtar të degës.

Për sa i takon subjektit "Lloyd's", në rast padie në Shtetin Anëtar të degës të ngritur në lidhje me angazhimet e marra në sigurim, personat e siguruar nuk duhen trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se ç'do të ishin trajtuar sikur padia të ishte ngritur kundër subjekteve tregtare të një natyre konvencionale.

Për rrjedhojë, agjenti i autorizuar duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për t'u paditur dhe, në këtë cilësi, duhet të jetë në gjendje të veprojë në emër dhe për llogari të sigurveve në fjalë të anëtarësuar në "Lloyd's".

3. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, nëse nuk kanë arsye për të vënë në dyshim mjaftueshmërinë e strukturës administrative, situatën financiare të ndërmarrjes së sigurimeve apo reputacionin e mirë dhe kualifikimet a përvojën e anëtarëve të këshillit të administrimit, administratorëve apo agjentit të autorizuar, duke pasur parasysh veprimtarinë e planifikuar tregtare, ua komunikojnë informacionin e përmendur në pikën 2 autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të degës brenda tre muajve pas marrjes së informacionit në fjalë dhe informojnë për këtë ndërmarrjen në fjalë.

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës vërtetojnë gjithashtu se ndërmarrja e sigurimeve e ka nivelin minimal të aftësisë paguese të llogarit në përputhje me nenin 28 dhe 29.

Kur autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës nuk pranojnë t'ua komunikojnë informacionin e përmendur në pikën 2 autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të degës ato i japin arsyet e refuzimit ndërmarrjes së sigurimeve në fjalë brenda tre muajve pas marrjes së informacionit në fjalë.

Kundër këtij refuzimi apo mosveprimi mund të bëhet ankesë përpara gjykatës në Shtetin Anëtar të origjinës.

4. Përpara se dega e ndërmarrjes së sigurimeve të fillojë veprimtarinë tregtare, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të degës informojnë brenda dy muajve pas marrjes së informacionit të përmendur në pikën 3 autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, nëse duhet, për kushtet me të cilat duhet ushtruar veprimtaria tregtare në fjalë në Shtetin Anëtar të degës në interes të së mirës së përgjithshme.

5. Pas marrjes së komunikimit nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të degës ose, nëse nuk merret komunikim prej tyre, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 4, dega mund të vendoset dhe të fillojë veprimtarinë tregtare.

6. Në rast të një ndryshimi në të dhënat e komunikuar në zbatim të pikës 2 shkronja "b", "c" ose "d", ndërmarrja e sigurimeve njofton me shkrim për këtë ndryshim autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës dhe të Shtetit Anëtar të degës, të paktën një muaj përpara bërjes së ndryshimit, në mënyrë që autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës dhe autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të degës të mund të përmbushin rolet e tyre respektive sipas pikës 3 dhe 4.

Ndërmarrja e sigurimeve që synon të ushtrojë veprimtari tregtare për herë të parë në një a më shumë Shtete Anëtare, në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime, informon së pari autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, duke u bërë të ditur natyrën e angazhimeve që propozon të mbulojë.

Neni 42

Liria për të ofruar shërbime: njoftimi nga Shteti Anëtar i origjinës

1. Jo më vonë se një muaj pas njoftimit të parashikuar në nenin 41, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës i komunikojnë Shtetit Anëtar ose Shteteve Anëtare në territorin e të cilave ndërmarrja e sigurimeve synon të ushtrojë veprimtari tregtare përmes lirisë për të ofruar shërbime:

(a) një vërtetim se ndërmarrja e sigurimeve e ka nivelin minimal të aftësisë paguese të llogaritur në përputhje me nenin 28 dhe 29;

(b) klasat e sigurimeve të cilat është autorizuar të ofrojë ndërmarrja e sigurimeve;

(c) natyrën e angazhimeve që ndërmarrja e sigurimeve propozon të mbulojë në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet.

Në të njëjtën kohë, ato e informojnë ndërmarrjen e sigurimeve për këtë.

2. Kur autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës nuk e komunikojnë informacionin e përmendur në pikën 1 brenda afatit të parashikuar, ato i japin arsyet e refuzimit ndërmarrjes së sigurimeve brenda të njëjtit afat.

Kundër këtij refuzimi mund të bëhet ankesë përpara gjykatës në Shtetin Anëtar të origjinës.

3. Ndërmarrja e sigurimeve mund ta fillojë veprimtarinë tregtare më datën e certifikuar kur është informuar për komunikimin e parashikuar në paragrafin e parë të pikës 1.

Neni 43

Liria për të ofruar shërbime: ndryshimet në natyrën e angazhimeve

Çdo ndryshim që synon të bëjë ndërmarrja e sigurimeve në informacionin e përmendur në nenin 41 i nënshtrohet procedurës së parashikuar në nenin 41 dhe 42.

Neni 44

Gjuha

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të degës apo të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet mund të kërkojnë që informacionin që kjo direktivë i autorizon të kërkojnë, në lidhje me veprimtarinë tregtare të ndërmarrjeve të sigurimeve që ushtrojnë veprimtari në territorin e shtetit në fjalë, ta marrin në gjuhën ose gjuhët zyrtare të shtetit në fjalë.

Neni 45

Rregullat në lidhje me kushtet e sigurimit dhe shkallët e primeve

Shteti Anëtar i degës ose Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet nuk miraton dispozita që kërkojnë miratimin paraprak apo njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të

policave, shkallëve të primeve, bazave teknike të përdorura për llogaritjen e shkallëve të primeve dhe provigjoneve teknike apo të formularëve e dokumenteve të tjera të shtypura që mendon të përdorë ndërmarrja e sigurimeve në marrëdhëniet e veta me policëmbajtësit.

Me qëllim verifikimin e pajtueshmërisë me dispozitat kombëtare në lidhje me kontratat e sigurimeve, shteti në fjalë mund të kërkojë që ndërmarrja e sigurimeve që propozon të ushtrojë veprimtarinë tregtare të sigurimeve në territorin e tij, në kuadër të së drejtës së vendosjes apo të lirisë për të ofruar shërbime, të bëjë vetëm njoftim josistematik të kushteve të policave dhe dokumenteve të tjera të shtypura, por kjo kërkesë nuk mund të përbëjë kusht paraprak për ushtrimin e veprimtarisë tregtare nga ana e ndërmarrjes së sigurimeve.

Neni 46

Ndërmarrjet e sigurimeve që nuk përmbushin dispozitat ligjore

1. Çdo ndërmarrje sigurimesh që ushtron veprimtari tregtare, në kuadër të së drejtës së vendosjes apo lirisë për të ofruar shërbime, u paraqet autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të degës dhe/ose të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet të gjitha dokumentet që i kërkohen në funksion të këtij neni, për aq sa edhe ndërmarrjet e sigurimeve me zyra qendrore në Shtetet Anëtare në fjalë janë të detyruara ta zbatojnë një kërkesë të tillë.

2. Nëse autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar konstatojnë se ndërmarrja e sigurimeve që ka vendosur degë ose që ushtron veprimtari tregtare në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime në territorin e tij nuk i respekton dispozitat ligjore, objekt i të cilave është në shtetin në fjalë, ato i kërkojnë ndërmarrjes së sigurimeve në fjalë ta ndreqë parregullsinë.

3. Nëse ndërmarrja e sigurimeve në fjalë nuk merr masat e nevojshme, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në fjalë informojnë për këtë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës. Këto të fundit marrin, në rastin më të parë, të gjitha masat e duhura për të siguruar që ndërmarrja e sigurimeve në fjalë ta ndreqë parregullsinë.

Natyra e këtyre masave u komunikohet autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar në fjalë.

4. Nëse, përkundër masave që merr Shteti Anëtar i origjinës apo ngaqë këto masa duket se janë të pamjaftueshme apo mungojnë në atë shtet, ndërmarrja e sigurimeve vazhdon të veprojë në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi në Shtetin Anëtar në fjalë, ky i fundit, pasi informon autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, mund të marrë masat e duhura për të parandaluar apo ndëshkuar parregullsitë e mëtejshme, duke përfshirë, aq sa është vetëm e nevojshme, moslejimin që ndërmarrja të vazhdojë të lidhë kontrata të reja sigurimesh në territorin e tij.

Shtetet Anëtare kujdesen që në territorin e tyre të jetë e mundshme të vihen në dispozicion dokumentet ligjore të duhura për këto masa për ndërmarrjet e sigurimeve.

5. Pikat 2, 3 dhe 4 nuk e prekin kompetencën e jashtëzakonshme të Shteteve Anëtare në fjalë për të marrë masat e duhura për parandalimin e parregullsive të kryera në territorin e tyre.

Kjo përfshin edhe mundësinë për të mos i lejuar ndërmarrjet e sigurimeve të vazhdojnë të lidhin kontrata të reja sigurimesh në territorin e tyre.

6. Pikat 2, 3 dhe 4 nuk i prekin kompetencat e jashtëzakonshme të Shteteve Anëtare për të

ndëshkuar shkeljet në territorin e tyre.

7. Nëse ndërmarrja e sigurimeve që ka kryer shkeljen ka një subjekt ose zotëron prona në Shtetin Anëtar në fjalë, autoritetet mbikëqyrëse të këtij të fundit mund të zbatojnë, në përputhje me legjislacionin kombëtar, sanksionet e parashikuara për shkeljen në fjalë duke marrë masa shtrënguese kundër subjektit ose pronave në fjalë.

8. Çdo masë e miratuar sipas pikave nga 3 deri në 7 që përfshijnë sanksione ose kufizime mbi ushtrimin e veprimtarisë tregtare të sigurimeve duhet justifikuar rregullisht dhe i duhet komunikuar ndërmarrjes së sigurimeve në fjalë.

9. Çdo dy vjet Komisioni i paraqet Komitetit të Sigurimeve një raport me një përmbledhje të numrit dhe llojit të rasteve në të cilat, në secilin Shtet Anëtar, janë refuzuar autorizime sipas nenit 42 ose janë marrë masa në përputhje me pikën 4 të këtij neni. Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me Komisionin duke i dhënë këtij të fundit informacionin e nevojshëm për këtë raport.

Neni 47 **Publiciteti**

Asnjë dispozitë e kësaj direktive nuk i pengon ndërmarrjet e sigurimeve me zyra qendrore në Shtete Anëtare të tjera që të bëjnë publicitet për shërbimet e tyre përmes të gjitha mjeteve të mundshme të komunikimit, në Shtetin Anëtar të degës ose në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet, në varësi të normave që rregullojnë formën dhe përmbajtjen e një publiciteti të tillë të miratuara në interesin e të mirës së përgjithshme.

Neni 48 **Mbyllja e veprimtarisë tregtare**

Në rast të mbylljes së veprimtarisë të një ndërmarrjeje sigurimesh, angazhimet e lindura nga kontratat e nënshkruara në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime përmbushen njësoj sikur të kishin lindur nga kontratat e tjera të sigurimeve të ndërmarrjes në fjalë, pa bërë dallim në bazë të shtetësisë për aq sa u takon jetëve të siguruara dhe përfituesve.

Neni 49 **Informacioni statistikor për veprimtaritë ndërkufitare**

Çdo ndërmarrje sigurimesh informon autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, veçmas në lidhje me transaksionet e realizuara në kuadër të së drejtës së vendosjes dhe të transaksioneve të realizuara në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime, pa zbritur risigurimet, sipas Shtetit Anëtar dhe sipas çdo klase nga I deri në IX, të përcaktuara në Shtojcën I. Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës ua përcjell këtë informacion, brenda një afati të arsyeshëm dhe në formë të agreguar, autoriteteve kompetente të secilit Shtet Anëtar në fjalë që e kërkon një gjë të tillë.

Neni 50

Tatimet mbi primin

1. Pa cenuar asnjë harmonizim të mëpasshëm, çdo kontratë sigurimi u nënshtrohet vetëm tatimeve të tërthorta dhe taksave parafiskale mbi primet e sigurimit në Shtetin Anëtar të angazhimit, si edhe, në rastin e Spanjës, taksave shtesë të vendosura ligjërisht në favor të entit spanjoll "Consortio de compensación de Seguros" për përmbushjen e funksioneve të këtij të fundit në lidhje me dëmshpërblimin e humbjeve që lindin nga ngjarjet e jashtëzakonshme në këtë Shtet Anëtar.
2. Legjislacioni i zbatueshëm për kontratat sipas nenit 32 nuk i cenon rregullimet fiskale të zbatueshme.
3. Në pritje të harmonizimit të ardhshëm, çdo Shtet Anëtar zbaton për ndërmarrjet që mbulojnë angazhime në territorin e tij dispozitat e veta kombëtare për të siguruar mbledhjen e tatimeve të tërthorta dhe taksave parafiskale që kërkohen sipas pikës 1.

TITULLI V

RREGULLAT E ZBATUESHME PËR AGJENCITË OSE DEGËT E VENDOSURA BRENDË KOMUNITETIT QË U PËRKASIN NDËRMARRJEVE ME ZYRA QENDRORE JASHTË KOMUNITETIT

Neni 51

Parimet dhe kushtet e autorizimit

1. Çdo Shtet Anëtar ia nënshton autorizimit zyrtar ushtrimin e veprimtarive të përmendura në nenin 2 nga ana e ndërmarrjes me zyrë qendrore jashtë Komunitetit.
2. Shteti Anëtar mund ta japë autorizimin nëse ndërmarrja përmbush të paktën këto kushte:
 - (a) ka të drejtë të ushtrojë veprimtaritë e sigurimeve që mbulon neni 2 në bazë të legjislacionit të vet kombëtar;
 - (b) vendos një agjenci ose një degë në territorin e Shtetit Anëtar;
 - (c) merr përsipër të krijojë në vendin e administrimit të agjencisë ose degës llogari të veçanta për veprimtarinë që ushtron në atë vend dhe të mbajë në atë vend të gjitha evidencat e lidhura me veprimtarinë tregtare të realizuar;
 - (d) cakton një përfaqësues të përgjithshëm, për t'u aprovuar nga autoritetet kompetente;
 - (e) zotëron në Shtetin Anëtar ku ushtron veprimtarinë, aktive me një shumë të barabartë në vlerë me të paktën një të dytën e shumës minimale të parashikuar në nenin 29 pika 2 paragrafi i parë, në lidhje me fondin e garancisë dhe depoziton një të katërtën e shumës minimale si garanci;
 - (f) merr përsipër të mbajë një nivel të aftësisë paguese në zbatim të nenit 55;
 - (g) paraqet një skemë të operacioneve në përputhje me dispozitat e pikës 3.
3. Skema e operacioneve e agjencisë ose degës, e përmendur në pikën 2 shkronja "g", duhet të përmbajë informacione ose prova:
 - (a) për natyrën e angazhimeve që propozon të mbulojë ndërmarrja;
 - (b) për parimet orientuese në lidhje me risigurimin;
 - (c) për gjendjen e nivelit të aftësisë paguese dhe fondit të garancisë të ndërmarrjes të përmendur

në nenin 55;

(d) për çmuarjet e kostos së ngritjes së shërbimeve administrative dhe për organizimin e sigurimit të veprimtarisë tregtare dhe për burimet financiare me të cilat mendohet të mbulohen këto kosto; dhe, krahas këtyre, për tre vitet e para financiare:

(e) një plan ku jepen çmuarjet e të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë tregtare, marrjen në risigurim dhe cedimin në risigurim;

(f) një parashikim të bilancit;

(g) çmuarjet lidhur me burimet financiare me të cilat mendohet të mbulohen përgjegjësitë e kontraktuara dhe niveli i aftësisë paguese.

4. Shteti Anëtar i origjinës mund të kërkojë njoftimin sistematik të bazave teknike të përdorura për llogaritjen e shkallëve të primeve dhe të provigjoneve teknike, por kjo kërkesë nuk mund të përbëjë kusht paraprak që ndërmarrja e sigurimeve të ushtrojë veprimtarinë e vet tregtare.

Neni 52

Rregullat e zbatueshme për degët e ndërmarrjeve të vendeve të treta

1. (a) Në varësi të shkronjës "b", agjencitë dhe degët e përmendura në këtë titull nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht veprimtaritë e përmendura në Shtojcën e Direktivës 73/239/KEE dhe veprimtaritë që mbulon kjo direktivë.

(b) Në varësi të shkronjës "c", Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që agjencitë dhe degët e përmendura në këtë titull, të cilat më datën përkatëse të përmendur në nenin 18 pika 3, i kanë ushtruar të dyja veprimtaritë në mënyrë të njëkohshme në një Shtet Anëtar, mund të vazhdojnë ta bëjnë këtë gjë me kusht që secila veprimtari të administrohet më vete në përputhje me nenin 19.

(c) Çdo Shtet Anëtar i cili, në zbatim të nenit 18 pika 6, u kërkon ndërmarrjeve të vendosura në territorin e vet të pushojnë ndjekjen e njëkohshme të veprimtarive në të cilat kanë qenë të angazhuara më datën përkatëse të përmendur në nenin 18 pika 3, duhet ta vendosë këtë detyrim edhe për agjencitë dhe degët e përmendura në këtë titull të cilat janë vendosur në territorin e tij dhe të cilat i ushtrojnë në këtë territor këto veprimtari në mënyrë të njëkohshme.

(d) Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që agjencitë dhe degët e përmendura në këtë titull zyra qendrore e të cilave ushtron në mënyrë të njëkohshme të dyja veprimtaritë dhe të cilat, më datat e përmendura në nenin 18 pika 3, ushtrojnë në territorin e një Shteti Anëtar vetëm veprimtarinë e mbuluar nga kjo direktivë, të mund ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre atje.

Nëse ndërmarrja dëshiron të ushtrojë në atë territor veprimtarinë e përmendur në Direktivën 73/239/KEE, ajo mund ta ushtrojë veprimtarinë e mbuluar nga kjo direktivë vetëm përmes një filiali.

2. Neni 13 dhe 37 zbatohen me përshtatjet sipas rastit për agjencitë dhe degët e përmendura në këtë titull. Në funksion të zbatimit të nenit 37, autoriteti kompetent që mbikëqyr aftësinë paguese të përgjithshme të agjencive ose degëve trajtohet në të njëjtën mënyrë me autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra qendrore.

3. Në rast të tërheqjes së autorizimit nga autoriteti i përmendur në nenin 56 pika 2, ky autoritet njofton autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të tjera ku ushtron veprimtari ndërmarrja, dhe këto të fundit marrin masat e duhura.

Nëse arsyeja për tërheqjen e autorizimit është pamaftueshmëria e nivelit të aftësisë paguese të

llogaritur në përputhje me nenin 56 pika 1 shkronja "a", autorizimet i tërheqin edhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të tjera në fjalë.

Neni 53

Transferimi i portofolit

1. Sipas kushteve të vendosura me ligj kombëtar, çdo Shtet Anëtar i autorizon agjencitë dhe degët e ngritura në territorin e tij dhe të mbuluara nga ky titull t'ia transferojnë një zyre pranuese të vendosur në të njëjtin Shtet Anëtar të gjithë ose një pjesë të portofolave të kontratave, nëse autoritetet kompetente të atij Shteti Anëtar ose, sipas rastit, të Shtetit Anëtar të përmendur në nenin 56 vërtetojnë se zyra pranuese zotëron nivelin e nevojshëm të aftësisë paguese pas pranimit të transferimit.

2. Sipas kushteve të vendosura nga ligji kombëtar, çdo Shtet Anëtar i autorizon agjencitë dhe degët e ngritura në territorin e tij dhe të mbuluara nga ky titull t'ia transferojnë një ndërmarrjeje sigurimesh me zyrë qendrore në një Shtet Anëtar tjetër të gjithë ose një pjesë të portofolave të kontratave, nëse autoritetet kompetente të atij Shteti Anëtar vërtetojnë se zyra pranuese zotëron nivelin e nevojshëm të aftësisë paguese duke mbajtur parasysht transferimin në fjalë.

3. Nëse, sipas kushteve të vendosura nga ligj kombëtar, Shteti Anëtar autorizon agjenci dhe degë të ngritura në territorin e vet dhe të mbuluara nga ky titull që të transferojnë të gjithë ose një pjesë të portofolave të tyre të kontratave një agjencie ose një dege të mbuluar nga ky titull dhe të ngritura në territorin e një Shteti Anëtar tjetër, sigurohet që autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra pranuese ose, sipas rastit, të Shtetit Anëtar të përmendur në nenin 56 të vërtetojnë që duke marrë në konsideratë transferimin e portofolit zyra pranuese e zotëron nivelin e aftësisë paguese, që ligji i Shtetit Anëtar të zyrës pranuese e lejon një transferim të tillë dhe që ai shtet ka rënë dakord për transferimin.

4. Në rrethanat e përmendura në pikën 1, 2 dhe 3, transferimin e autorizojnë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ndodhet agjencia apo dega që bën transferimin, pasi kanë marrë pëlqimin e autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të angazhimit, nëse ky nuk është Shteti Anëtar ku ndodhet agjencia apo dega që bën transferimin.

5. Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare që u kërkohet mendim u japin mendimin ose pëlqimin e tyre autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës të ndërmarrjes së sigurimeve që bën transferimin brenda tre muajsh pas marrjes së kërkesës; mungesa e një përgjigjeje nga autoritetet e konsultuara brenda këtij afati konsiderohet si mendim në favor të transferimit ose si pëlqim në heshtje.

6. Transferimi i autorizuar në përputhje me këtë nen bëhet publik, siç parashikohet në legjislacionin kombëtar në Shtetin Anëtar të angazhimit.

Transferimi në fjalë e fiton automatikisht vlefshmërinë kundrejt policëmbajtësve, personave të siguruar dhe çdo personi tjetër me të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga kontratat e transferuara. Kjo dispozitë nuk cenon të drejtën e Shteteve Anëtare për t'u dhënë policëmbajtësve mundësinë e anulimit të kontratës brenda një afati të caktuar pas transferimit.

Neni 54
Provigjonet teknike

Shtetet Anëtare u kërkojnë ndërmarrjeve të krijojnë provigjone, sipas parashikimeve të nenit 20, të mjaftueshme për të mbuluar përgjegjësitë e kontraktuara në territorin e tyre.

Shtetet Anëtare kujdesen që agjencia ose dega t'i mbulojë këto provigjone me aktive ekuivalente me provigjone të tilla dhe me aktive përputhëse në përputhje me Shtojcën II.

Legjislacioni i Shtetit Anëtar është i zbatueshëm për llogaritjen e provigjoneve të tilla, përcaktimin e kategorive të investimeve dhe vlerësimin e aktiveve dhe, sipas rastit, për përcaktimin e shkallës me të cilën mund të përdoren këto aktive për mbulimin e provigjoneve të tilla.

Shteti Anëtar në fjalë kërkon që aktivet në mbulim të këtyre provigjoneve ta kenë vendndodhjen në territorin e tij. Sidoqoftë zbatohen dispozitat e nenit 20, pika 4.

Neni 55
Niveli i aftësisë paguese dhe fondi i garancisë

1. Çdo Shtet Anëtar u kërkon agjencive ose degëve të ngritura në territorin e tij një nivel të aftësisë paguese të përbërë nga zërat e renditur në nenin 27.

Niveli i aftësisë paguese llogaritet në përputhje me nenin 28.

Por, për llogaritjen e këtij niveli, merren në konsideratë vetëm operacionet e kryera nga agjencia ose dega në fjalë.

2. Një e treta e nivelit minimal të aftësisë paguese përbën fondin e garancisë.

Por shumica e këtij fondi nuk mund të jetë më e vogël se një e dyta e minimumit të kërkuar në zbatim të nenit 29 pika 2 paragrafi i parë. Depozita fillestare e bërë në përputhje me nenin 51 pika 2 shkronja "e" merret parasysh si pjesë e këtij fondi të garancisë. Përbërja e fondit të garancisë dhe minimumi i këtij fondi duhet të jetë në përputhje me nenin 29.

3. Aktivet që përfaqësojnë nivelin minimal të aftësisë paguese duhen mbajtur brenda Shtetit Anëtar ku kryhen veprimtaritë deri në shumën e fondit të garancisë dhe pjesa tjetër duhen mbajtur brenda Komunitetit.

Neni 56
Përparësitë për ndërmarrjet e autorizuar në më shumë se një Shtet Anëtar

1. Çdo ndërmarrje që ka kërkuar ose ka marrë autorizim nga më shumë se një Shtet Anëtar mund të paraqesë kërkesë për përparësitë e mëposhtme të cilat mund të jepen vetëm paralelisht:

(a) niveli i aftësisë paguese të përmendur në nenin 55 llogaritet në lidhje me të gjithë veprimtarinë tregtare që ushtron brenda Komunitetit: në këtë rast, për këtë llogaritje në konsideratë merren vetëm operacionet e kryera nga të gjitha agjencitë ose degët e vendosura brenda Komunitetit;

(b) depozita që kërkon neni 51 pika 2 shkronja "e" bëhet vetëm në njërin prej këtyre Shteteve Anëtare;

(c) aktivet që përfaqësojnë fondin e garancisë duhet ta kenë vendndodhjen në cilindo Shtet

Anëtar ku ushtron veprimtari.

2. Kërkesa për të përfitur nga përparësitë e parashikuara në pikën 1 u paraqitet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare në fjalë. Kërkesa duhet të përcaktojë autoritetin e Shtetit Anëtar i cili do të mbikëqyrë në të ardhmen aftësinë paguese të të gjithë veprimtarisë tregtare të agjencive ose degëve të vendosura brenda Komunitetit. Duhet dhënë arsyet përse ndërmarrja ka zgjedhur autoritetin në fjalë. Depozita duhet të bëhet në atë Shtet Anëtar.

3. Përparësitë e parashikuara në pikën 1 mund të jepen vetëm nëse japin pëlqimin autoritetet kompetente të të gjitha Shteteve Anëtare ku është paraqitur kërkesa. Përparësitë fillojnë të zbatohen duke filluar nga koha kur autoriteti kompetent i përzgjedhur informon autoritetet e tjera kompetente se do të mbikëqyrë gjendjen e aftësinë paguese të të gjithë veprimtarisë tregtare të agjencive ose degëve brenda Komunitetit. Autoriteti kompetent i përzgjedhur merr nga Shtetet Anëtare të tjera informacionet e nevojshme për mbikëqyrjen e aftësisë paguese të përgjithshme të agjencive dhe degëve të vendosura në territorin e tyre.

4. Me kërkesë të një ose më shumë Shteteve Anëtare në fjalë, përparësitë e dhëna në zbatim të këtij neni revokohen në mënyrë të njëkohshme nga të gjitha Shtetet Anëtare në fjalë.

Neni 57

Marrëveshjet me vendet e treta

Komuniteti, përmes marrëveshjeve të lidhura në zbatim të Traktatit me një ose më shumë vende të treta, mund të pranojë zbatimin e dispozitave që janë të ndryshme prej atyre që parashikohen në këtë titull, me qëllim sigurimin, në bazë reciprociteti, të mbrojtjes adekuate të policëmbajtësve në Shtetet Anëtare.

TITULLI VI

RREGULLAT E ZBATUESHME PËR FILIALET E NDËRMARRJEVE MËMA QË RREGULLOHEN NGA LIGJET E NJË VENDI TË TRETË DHE RREGULLAT E ZBATUESHME PËR MARRJEN NË PRONËSI TË PJESËMARRJEVE NGA ANA E NDËRMARRJEVE MËMA TË LARTPËRMENDURA

Neni 58

Informacioni që Shtetet Anëtare i japin Komisionit

Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare informojnë Komisionin:

(a) për çdo autorizim të një filiali të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ndërmarrjeve mëma të cilat rregullohen nga ligjet e një vendi të tretë.

Komisioni informon për këtë Komitetin e përmendur në nenin 65 pika 1;

(b) sa herë që ndërmarrja mëmë merr një pjesëmarrje në një ndërmarrje sigurimesh të Komunitetit e cila do ta shndërronte këtë të fundit në shoqëri të kontrolluar.

Komisioni informon për këtë Komitetin e përmendur në nenin 65 pika 1.

Kur i jepet autorizim një filiali të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një ose më shumë ndërmarrjesh mëmë të rregulluara nga legjislacioni i vendeve të treta, në njoftimin që autoritetet kompetente i dërgojnë Komisionit specifikohet struktura e grupit.

Trajtimi që u bëjnë vendet e treta ndërmarrjeve të sigurimeve të Komunitetit

1. Shtetet Anëtare e informojnë Komisionin për çdo vështirësi të përgjithshme që hasin ndërmarrjet e sigurimeve në vendosjen ose ushtrimin e veprimtarive të tyre në një vend të tretë.

2. Periodikisht, Komisioni përpilon një raport ku shqyrtohet trajtimi që u bëhet ndërmarrjeve të sigurimeve të Komunitetit në vendet e treta, sipas kushteve të përmendura në pikat 3 dhe 4, sa i takon vendosjes dhe ushtrimit të veprimtarive të sigurimeve, si edhe marrja në pronësi e pjesëmarrjeve në ndërmarrjet e sigurimeve të vendeve të treta. Komisioni ia dorëzon këto raporte Këshillit, së bashku me propozimet e duhura, nëse ka.

3. Komisioni, kur krijon përshtypjen, në bazë të raporteve të përmendura në pikën 2 ose në bazë të informacioneve të tjera, se një vend i tretë nuk u jep ndërmarrjeve të sigurimeve të Komunitetit hyrje në treg të ngjashme me atë që Komuniteti u jep ndërmarrjeve të sigurimeve nga ai vend i tretë, mund t'i paraqesë Këshillit propozime për mandatin e duhur të negocimit, me qëllim që të arrihen mundësi konkurruese të ngjashme për ndërmarrjet e sigurimeve të Komunitetit. Këshilli vendos me shumicë të cilësuar.

4. Komisioni, kur krijon përshtypjen, në bazë të raporteve të përmendura në pikën 2 ose në bazë të informacioneve të tjera, se ndërmarrjet e sigurimeve të Komunitetit në një vend të tretë nuk përfitojnë trajtimin e brendshëm që ofron të njëjtat mundësi konkurruese me ato që mund të përfitojnë ndërmarrjet vendase të sigurimeve dhe se nuk përmbushen kushtet për hyrje të efektshme në treg, mund të çelë negociatave me qëllim korrigjimin e situatës.

Në rrethanat e përmendura në paragrafin e parë, mund të vendoset, gjithashtu, në çdo kohë dhe krahas çeljes së negociatave, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 65 pika 2, që autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare t'i kufizojnë ose pezullojnë vendimet:

- lidhur me kërkesat ende të pazgjidhura në momentin e vendimit ose lidhur me kërkesat e ardhshme për autorizim dhe
- lidhur me marrjen e pjesëmarrjeve nga ndërmarrjet mëma të drejtpërdrejta ose të tërthorta të cilat janë kompetencë e vendit të tretë në fjalë.

Kohëzgjatja e masave të përmendura nuk mund të jetë më shumë se tre muaj. Përpara se të mbarojë afati tremujor dhe duke mbajtur në konsideratë rezultatet e negociatave, Këshilli, me propozim të Komisionit dhe me shumicë të cilësuar, mund të vendosë se cilat masa do të vazhdojnë.

Një kufizim apo pezullim i tillë nuk mund të zbatohet për ngritjen e shoqërive të kontrolluara nga ndërmarrjet e sigurimeve apo nga shoqëritë e kontrolluara të tyre, apo për marrjen e pjesëmarrjeve në ndërmarrjet e sigurimeve të Komunitetit nga këto ndërmarrje apo shoqëri të kontrolluara.

5. Shtetet Anëtare, kur Komisioni krijon përshtypjen se ka lindur njëra prej situatave të përmendura në pikën 3 dhe 4, e informojnë Komisionin, me kërkesën e këtij të fundit:

- (a) për çdo kërkesë për autorizim të një filiali të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ndërmarrjeve mëma të cilat rregullohen nga ligjet e vendit të tretë në fjalë;
- (b) për çdo plan që ka një ndërmarrje për të marrë pjesëmarrje në një ndërmarrje sigurimesh të

Komunitetit përmes së cilës kjo e fundit do të bëhej ndërmarrje e kontrolluar e së parës. Ky detyrim për të dhënë informacion nuk zbatohet sa herë që arrihet një marrëveshje me vendin e tretë të përmendur në pikën 3 ose 4 kur pushojnë së zbatuari masat e përmendura në paragrafin e dytë dhe të tretë të pikës 4.

6. Masat e marra në zbatim të këtij neni respektojnë detyrimet që ka Komuniteti në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe të cilat rregullojnë fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të ndërmarrjeve të sigurimeve.

TITULLI VII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË TJERA

Neni 60

Përrjashtime dhe heqja e masave kufizuese

1. Ndërmarrjet e krijuara në Mbretërinë e Bashkuar me Urdhër Mbretëror, me akt privat ose me akt publik të posaçëm mund ta vijojnë veprimtarinë e tyre me formën ligjore me të cilën janë themeluar më 15 mars 1979 për një afat të pakufizuar. Mbretëria e Bashkuar përpilon një listë të këtyre ndërmarrjeve dhe ua komunikon atë Shteteve të tjera Anëtare dhe Komisionit.

2. Shoqëritë e regjistruara në Mbretërinë e Bashkuar në zbatim të Akteve të Shoqërive Miqësore mund t'i vijojnë veprimtaritë e sigurimit të jetës dhe operacionet e kursimeve të cilat, në përputhje me objektin e tyre, i ushtronin më 15 mars 1979.

Neni 61

Vërtetimi i reputacionit të mirë

1. Kur Shteti Anëtar u kërkon shtetasve të vet vërtetim për reputacion të mirë dhe vërtetim që nuk kanë patur rast të mëparshëm falimentimi, ose njërin prej këtyre vërtetimeve, ky Shtet Anëtar pranon si provë të mjaftueshme, në rastin e shtetasve të Shteteve të tjera Anëtare, një ekstrakt të “dosjes gjyqësore” ose në mungesë të tij, një dokument të barasvlershëm të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor ose administrativ i Shtetit Anëtar të origjinës apo Shtetit Anëtar prej nga vjen shtetasi i huaj, ku tregohet se janë përmbushur këto kërkesa.

2. Kur Shteti Anëtar i origjinës ose Shteti Anëtar prej nga vjen shtetasi i huaj nuk e lëshon dokumentin e përmendur në pikën 1, ky vërtetim mund të zëvendësohet me një deklaratë të dhënë nën betim ose në shtetet ku nuk parashikohet deklarata e dhënë nën betim, me një deklaratë solemne, të cilën e jep personi i interesuar përpara autoritetit kompetent gjyqësor a administrativ ose, sipas rastit, përpara noterit, në Shtetin Anëtar të origjinës ose në Shtetin Anëtar prej nga vjen personi; autoriteti ose noteri në fjalë lëshon një dokument për vërtetësinë e deklaratës së bërë nën betim ose të deklaratës solemne.

Deklarata për mospasje procedure të mëparshme falimentimi mund të bëhet edhe përpara një organi kompetent profesional në vendin në fjalë.

3. Dokumentet e lëshuara në përputhje me pikën 1 dhe 2 nuk duhet të paraqiten më tepër se tre muaj pas datës së lëshimit.

4. Shtetet Anëtare caktojnë autoritetet dhe organet kompetente për lëshimin e dokumenteve të përmendura në pikën 1 dhe 2 dhe informojnë për këtë Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin. Çdo Shtet Anëtar i informon Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin edhe për autoritetet ose organet të cilave duhet t'u paraqiten dokumentet e përmendura në këtë nen, në mbështetje të kërkesës për të ushtruar në territorin e këtij Shteti Anëtar veprimtaritë e përmendura në nenin 2.

TITULLI VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 62

Bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit

Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare bashkëpunojnë nga afër me qëllim mundësimin e mbikëqyrjes së llojeve të sigurimeve dhe operacioneve të përmendura në këtë direktivë brenda Komunitetit.

Çdo Shtet Anëtar e informon Komisionin për çdo vështirësi madhore që lind nga zbatimi i kësaj direktive, ndër të tjera nëse Shteti Anëtar vihet në dijeni të një transferimi jonormal të veprimtarisë tregtare të përmendur në këtë direktivë në dëm të ndërmarrjeve të vendosura në territorin e tij dhe në fitim të agjencive dhe degëve që ndodhen në anën tjetër të kufijve të tij.

Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në fjalë i shqyrtojnë këto vështirësi sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të gjejnë një zgjidhje të duhur. Komisioni i paraqet, sipas rastit, propozimet e duhura Këshillit.

Neni 63

Raportet për zhvillimin e tregut në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime

Komisioni i përcjell Parlamentit European dhe Këshillit raporte të rregullta, të parin prej të cilëve më 20 nëntor 1995, në lidhje me zhvillimin e tregut të sigurimeve dhe operacioneve të realizuara sipas kushteve të lirisë për të ofruar shërbime.

Neni 64

Rregullimet teknike

Rregullimet e mëposhtme teknike që duhen t'i bëhen kësaj direktive miratohen në përputhje me procedurën e vendosur në nenin 65 pika 2:

- shtrirja e formave ligjore të parashikuara në nenin 6 pika 1 shkronja "a",
- shtesat dhe ndryshimet në listën e vendosur në Shtojcën I, ose përshtatja e terminologjisë së përdorur në këtë listë për të marrë në konsideratë zhvillimin e tregjeve të sigurimeve,
- sqarimi i zërave përbërës të nivelit të aftësisë paguese të renditur në nenin 27 për të marrë në konsideratë krijimin e instrumenteve të reja financiare,
- ndryshimi i fondit minimal të garancisë të parashikuar në nenin 29 pika 2 për të marrë në konsideratë zhvillimet ekonomike dhe financiare,
- shtesat dhe ndryshimet e listës së aktiveve të pranueshme si mbulim i provigjoneve teknike të vendosura në nenin 23 dhe shtesat dhe ndryshimet e rregullave për shpërndarjen e instrumenteve të parashikuara në nenin 24,

- ndryshimet në lehtësimin e rregullave të parashikuara në Shtojcën II, për të marrë në konsideratë zhvillimin e instrumenteve të reja për mbrojtjen e pozicionit valutor apo përparimin e arritur drejt bashkimit ekonomik dhe monetar,
- sqarimi i përkufizimeve në mënyrë që të sigurohet një zbatim i njëtrajtshëm i kësaj direktive në të gjithë Komunitetin,
- rregullimet teknike të nevojshme të rregullave për vendosjen e kufirit maksimal të zbatueshëm për normat e interesit, në përputhje me nenin 20, në veçanti për të marrë në konsideratë progresin e arritur në bashkimin ekonomik dhe monetar.

Neni 65

Procedura e Komitetit

1. Komisionin e asiston Komiteti i Sigurimeve i ngritur me Direktivën 91/675/KEE.
2. Kur përdoret kjo pikë, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke respektuar dispozitat e nenit 8 të tij. Afati i parashikuar në nenin 5 pika 6 të Vendimit 1999/468/KE është tre muaj.
3. Komiteti miraton rregulloren e vet të punës.

Neni 66

Të drejtat e fituara nga degët dhe ndërmarrjet ekzistuese të sigurimeve

1. Degët të cilat e kanë filluar veprimtarinë tregtare përpara datës 1 korrik 1994, në përputhje me dispozitat në fuqi në Shtetin Anëtar të degës, konsiderohen se i janë nënshtruar procedurës së parashikuar në nenin 40 pikat nga 1 deri në 5. Këto degë, duke filluar nga data e lartpërmendur, rregullohen nga neni 13, 20, 37, 39 dhe 46.
2. Neni 41 dhe 42 nuk i prekin të drejtat e fituara nga ndërmarrjet e sigurimeve që ushtronin veprimtari në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime përpara datës 1 korrik 1994.

Neni 67

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës

Shtetet Anëtare sigurojnë që kundër vendimeve të marra në lidhje me një ndërmarrje sigurimesh në bazë të akteve ligjore, nënligjore dhe administrative të miratuara në përputhje me këtë direktivë të mund të bëhet ankesë në gjykatë.

Neni 68

Shqyrtimi i shumave të shprehura në euro

1. Komisioni i paraqet Këshillit përpara datës 15 mars 1985 një raport ku trajtohet ndikimi i kërkesave financiare që vendos kjo direktivë, në situatën e tregjeve të sigurimeve të Shteteve Anëtare.
2. Këshilli, me propozimin e Komisionit, shqyrton çdo dy vjet dhe, sipas rastit, rishikon shumat e

shprehura në euro në këtë direktivë, në vartësi të mënyrës si është zhvilluar situata ekonomike dhe monetare e Komunitetit.

Neni 69

Zbatimi i dispozitave të reja

1. Shtetet Anëtare miratojnë dhe zbatojnë aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të nevojshme për të qenë në përmbushje të nenit 1 pika 1 shkronja "m", nenin 18 pika 2, nenin 51 pika 2, shkronja "g", dhe pika 3 dhe 4, nenin 60 pika 2 dhe nenin 66 pika 1, jo më vonë se data 19 qershor 2004. Shtetet Anëtare informojnë menjëherë në lidhje me këtë Komisionin.

2. Shtetet Anëtare miratojnë dhe zbatojnë aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të nevojshme për të qenë në përmbushje të nenit 16 pika 3 jo më vonë se data 17 nëntor 2002. Shtetet Anëtare informojnë menjëherë Komisionin në lidhje me këtë. Përpara kësaj date, Shtetet Anëtare zbatojnë dispozitën e përmendur në Shtojcën IV pika 1.

3. Shtetet Anëtare miratojnë brenda datës 20 shtator 2003 aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të nevojshme për të qenë në përmbushje të nenit 3 pika 6, nenin 27, 28, 29, 30 dhe 38. Shtetet Anëtare njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë. Shtetet Anëtare parashikojnë që dispozitat e përmendura në paragrafin e parë të zbatohen në fillim për mbikëqyrjen e llogarive të viteve financiare që fillojnë më 1 janar 2004 ose gjatë atij viti kalendarik. Përpara kësaj date, Shtetet Anëtare zbatojnë dispozitat e përmendura në Shtojcën IV pika 2 dhe 3.

4. Kur Shtetet Anëtare miratojnë masat e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3, ato citojnë titullin e kësaj direktive ose shoqërohen me titullin e cituar në rastet e botimit zyrtar të tyre. Shtetet Anëtare vendosin për mënyrën se si do ta citojnë titullin e kësaj direktive.

5. Jo më vonë se data 1 janar 2007, Komisioni i paraqet Parlamentit European dhe Këshillit një raport për zbatimin e nenit 3 pika 6, nenit 27, 28, 29, 30 dhe 38 dhe, nëse është e nevojshme, për nevojën për harmonizim të mëtejshëm. Në raport bëhet e ditur se si i kanë shfrytëzuar Shtetet Anëtare mundësitë që japin këto nene dhe, në veçanti, nëse kompetencat diskrecionare që u jepen autoriteteve mbikëqyrëse kombëtare kanë çuar në dallime mbikëqyrëse madhore në tregun e vetëm.

Neni 70

Informimi i Komisionit

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar që ata miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

Neni 71

Periudha kalimtare për nenin 3 pika 6, nenin 27, 28, 29, 30 dhe 38

1. Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë ndërmarrjeve të sigurimeve që, më 20 mars 2002, kanë ofruar sigurime në territorin e tyre në një ose më shumë prej klasave të përmendura në Shtojcën I, një afat prej pesë vjet, duke filluar po nga ajo datë, në mënyrë që ato të vijnë në përmbushje të

kërkesave të parashikuara në nenin 3 pika 6, nenin 27, 28, 29, 30 dhe 38.

2. Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë ndërmarrjeve të përmendura në pikën 1, të cilat pas përfundimit të afatit pesëvjeçar nuk e kanë krijuar nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, një afat shtesë jo më të gjatë se dy vjet për ta bërë një gjë të tillë, me kusht që këto ndërmarrje, në përputhje me nenin 37, t'u kenë paraqitur për miratim autoriteteve kompetente, masat që propozojnë të marrin për këtë qëllim.

Neni 72

Direktivat e shfuqizuara dhe korrelacioni i tyre me këtë direktivë

1. Direktivat e renditura në Shtojcën V pjesa A shfuqizohen, pa cenuar detyrimet e Shteteve Anëtare lidhur me afatet për kthimin në legjislacion kombëtar dhe për zbatimin e direktivave të lartpërmendura e të renditura në Shtojcën V pjesa B.

2. Citimi i direktivave të shfuqizuara interpretohet sikur të jetë citim i kësaj direktive dhe duhet interpretuar në përputhje me tabelën e korrelacionit në Shtojcën VI.

Neni 73

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 74

Entitetet të cilave u drejtohet direktiva

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.
Nënshkruar në Bruksel, më 5 nëntor 2003.

Për Parlamentin European
Presidenti
P. COX
Për Këshillin
Presidenti
T. Pedersen

[1] GZ C 365 E, 19.12.2000, fq.1.

[2] GZ C 123, 25.4.2001, fq. 24.

[3] Opinioni i Parlamentit European, datë 15 mars 2001 (GZ C 343, 5.12.2002, fq. 202), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 27 maj 2002 (GZ C 170 E, 16.7.2002, fq. 45) dhe Vendimi i Parlamentit European, datë 25 shtator 2002 (i papublikuar ende në Gazetën Zyrtare).

[4] GZ L 63, 13.3.1979, fq. 1. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga Direktiva 2002/12/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 77, 20.3.2002, fq. 11).

[5] GZ L 330, 29.11.1990, fq. 50. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 92/96/KEE (GZ L 360, 9.12.1992, fq. 1).

[6] GZ L 360, 9.12.1992, fq. 1. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 2000/64/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 290, 17.11.2000, fq. 27).

[7] GZ L 374, 31.12.1991, fq. 7.

[8] GZ L 228, 16.8.1973, fq. 3. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 77, 20.3.2002, fq. 17).

[9] GZ L 141, 11.6.1993, fq. 27. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga Direktiva 2000/64/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit.

[10] GZ L 184, 17.7.1999, fq. 23.

[11] GZ L 374, 31.12.1991, fq. 32.

[12] GZ L 193, 18.7.1983, fq. 1. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga Direktiva 2001/65/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (GZL 283, 27.10.2001, fq. 28).

[13] GZ L 184, 6.7.2001, fq. 1.

[14] GZ L 126, 12.5.1984, fq. 20.

[15] GZ L 222, 14.8.1978, fq. 11. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga Direktiva 2001/65/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (GZL 283, 27.10.2001, fq. 28).

[16] GZ L 375, 31.12.1985, fq. 3. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga Direktiva 2001/108/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (GZL 41, 13.2.2002, fq. 35).

[17] GZ L 126, 26.5.2000, fq. 1. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 2000/28/KE (GZ L 275, 27.10.2000, fq. 37).

SHTOJCA I

Klasat e sigurimeve

I. Sigurimet e përmendura në nenin 2 pika 1 shkronja "a", "b" dhe "c", me përjashtim të atyre të përmendura në pjesën II dhe III.

II. Sigurim martese – lindjeje

III. Sigurimet e përmendura në nenin 2 pika 1 shkronja "a" dhe "b", të cilat lidhen me fondet e investimeve

IV. Sigurimi i përhershëm i shëndetit, i përmendur në nenin 2 pika 1 shkronja "d"

V. Tontinat, e përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "a"

VI. Operacionet e kthimit të kapitalit, të përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "b"

VII. Administrimi i fondeve të pensioneve të grupeve, të përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "c" dhe "d"

VIII. Operacionet e përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "e"

IX. Operacionet e përmendura në nenin 2 pika 3

SHTOJCA II

Rregullat e përputhjes

Monedha, me të cilën janë të pagueshme angazhimet e siguresit, përcaktohet në përputhje me rregullat e mëposhtme.

1. Kur mbulimi i parashikuar me kontratë shprehet në formën e një monedhe të caktuar, konsiderohet se angazhimet e siguresit janë të pagueshme me atë monedhë.

2. Shtetet Anëtare mund t'u autorizojnë ndërmarrjeve të sigurimeve të mos i mbulojnë provigjonet teknike, duke përfshirë provigjonet matematikore, me aktive përputhëse nëse zbatimi i procedurave të mësipërme do të sillte si rezultat që ndërmarrja të detyrohej që, në përmbushje të parimit të përputhjes, të mbante aktive në një monedhë që nuk zë më shumë se 7 për qind të aktiveve ekzistuese në monedha të tjera.

3. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve të zbatojnë parimin e përputhjes kur angazhimet janë të pagueshme me një monedhë që nuk është monedha e njërit prej Shteteve Anëtare, nëse investimet në atë monedhë janë të rregulluara, nëse monedha është objekt i kufizimeve mbi dërgesat apo nëse, për arsye të ngjashme, nuk është e përshtatshme

për mbulimin e provigjoneve teknike.

4. Ndërmarrjet e sigurimeve lejohen të mos zotërojnë aktive të përputhura për të mbuluar një shumë që nuk është më e madhe se 20 për qind e angazhimeve të tyre në një monedhë të caktuar. Por aktivet gjithsej në të gjitha monedhat së bashku duhet të jenë të paktën sa angazhimet gjithsej në të gjitha monedhat së bashku.

5. Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë që sa herë që një angazhim, sipas procedurave të mësipërme, duhet të mbulohet me aktive të shprehura me monedhën e një Shteti Anëtar, kjo kërkesë të konsiderohet se është përmbushur edhe nëse aktivet janë të shprehura në euro.

SHTOJCA III

Informimi i policëmbajtësve

Informacioni i mëposhtëm, i cili duhet t'i komunikohet policëmbajtësit përpara lidhjes së kontratës (A) ose gjatë periudhës së kontratës (B), duhet të jepet në mënyrë të qartë dhe të saktë, me shkrim, në gjuhën zyrtare të Shtetit Anëtar të angazhimit.

Megjithatë, ky informacion mund të jetë në një gjuhë tjetër nëse këtë gjë e kërkon policëmbajtësi dhe e lejon ligji i Shtetit Anëtar ose nëse policëmbajtësi është i lirë ta zgjedhë vetë legjislacionin e zbatueshëm.

A. Përpara lidhjes së kontratës

TABELA

B. Gjatë periudhës së kontratës

TABELA

SHTOJCA IV

1. Sekretit profesional

Deri më 17 nëntor 2002, Shtetet Anëtare mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi, ku të parashikojnë shkëmbim informacioni, me autoritetet kompetente të vendeve të treta vetëm nëse informacioni që jepet është objekt i garancive të sekretit profesional që janë të paktën të barasvlershme me ato që përmend neni 16 i kësaj direktive.

2. Veprimtaritë dhe organet e përjashtuara nga kjo direktivë

Deri më 1 janar 2004, kjo direktivë nuk ka të bëjë me fondet kolektive, kur:

- statuti përmban dispozita për kërkimin e kontributeve të tjera shtesë, për zvogëlimin e pagesave ose për kërkimin e asistencës nga persona të tjerë që kanë marrë përsipër një gjë të tillë dhe
- të ardhurat vjetore si kontribut për veprimtaritë që mbulon kjo direktivë nuk janë më shumë se 500 000 euro gjatë tre viteve rresht.

Nëse kjo shumë kalohet gjatë tre viteve rresht kjo direktivë zbatohet duke filluar nga viti i katërt.

3. Deri më 1 janar 2004, Shtetet Anëtare zbatojnë dispozitat e mëposhtme:

A. Niveli i aftësisë paguese

Çdo Shtet Anëtar i kërkon çdo ndërmarrjeje sigurimesh me zyra qendrore në territorin e tij të ketë një nivel të mjaftueshëm të aftësisë paguese në lidhje me të gjithë veprimtarinë e saj tregtare.

Niveli i aftësisë paguese përbëhet nga:

1. Aktivitet e ndërmarrjes së sigurimeve të cilat nuk janë të zëna me asnjë pasiv të parashikueshëm, duke u zbritur zërat e aktiveve jomateriale. Në veçanti, përfshihen zërat e mëposhtëm:

- kapitali aksionar i shlyer ose, në rastin e ndërmarrjes kolektive të sigurimeve, fondi fillestar efektiv plus çdo llogari të anëtarëve që përmbushin kriteret e mëposhtme:

(a) në aktin e themelimit dhe në statut duhet të përcaktohet që nga këto llogari anëtarët mund të marrin pagesa vetëm për aq sa kjo nuk shkakton që niveli i aftësisë paguese të bjerë nën nivelin e kërkuar ose, pas prishjes së ndërmarrjes, nëse janë shlyer të gjitha borxhet e tjera të ndërmarrjes;

(b) në aktin e themelimit dhe në statut duhet të përcaktohet në lidhje me çdo pagesë që bëhet për arsye që nuk kanë të bëjnë me largimin e anëtarit nga ndërmarrja se duhen njoftuar autoritetet kompetente të paktën një muaj përpara dhe se këto autoritete të mund ta ndalojnë pagesën brenda këtij afati;

(c) dispozitat përkatëse të aktit të themelimit dhe statutit mund të ndryshohen vetëm pasi autoritetet kompetente të jenë shprehur se nuk kanë asnjë kundërshtim për ndryshimin, pa cenuar kriteret e parashikuara në shkronjën "a" dhe "b",

- një e dyta e kapitalit aksionar të pashlyer ose e fondit fillestar, pasi pjesa e shlyer të ketë arritur 25 për qind të kapitalit aksionar ose të fondit,

- rezervat (rezervat ligjore dhe rezervat e lira) që nuk janë të lidhura me përgjegjësitë e kontraktuara,

- çdo fitim i mbartur,

- kapitali në formë aksionesh progresive me përparësi dhe kapitali në formën e borxhit të varur mund të përfshihen por deri në 50 për qind të nivelit, jo më shumë se 25 për qind e të cilit të përbëhet nga borxhe të varura me datë fikse shlyerjeje, ose kapital në formë aksionesh progresive me përparësi me afat fikse, nëse përmbushen kriteret e mëposhtme minimale:

(a) në rast falimentimi apo likuidimi të ndërmarrjes së sigurimeve, duhet të ketë kontrata ligjore sipas të cilave kapitali në formë borxhi të varur ose kapitali në formë aksionesh me përparësi të renditet pas pretendimeve të gjithë kreditorëve të tjerë dhe të mos shlyhet pa u shlyer të gjitha borxhet e tjera të pashlyera ende.

Kapitali në formë borxhi të varur duhet të përmbushë edhe këto kushte:

(b) në konsideratë të merren vetëm fondet e paguara plotësisht;

(c) për kreditë me datë fikse kthimi, afati origjinal i kthimit të jetë të paktën pesë vjet.

Jo më vonë se një vit përpara datës së shlyerjes ndërmarrja e sigurimeve duhet t'u paraqesë për aprovim autoriteteve kompetente një plan ku tregohet se do të ruhet apo sigurohet niveli i aftësisë paguese pas afatit të shlyerjes, nëse shkalla e konsiderimit të borxhit si pjesë përbërëse e nivelit të aftësisë paguese nuk zvogëlohet gradualisht gjatë të paktën pesë viteve të fundit përpara datës së shlyerjes.

Autoritetet kompetente mund të autorizojnë shlyerje të hershme të një borxhi të tillë, me kusht që të jetë paraqitur kërkesë nga ndërmarrja e sigurimeve që e ka marrë borxhin dhe me kusht që

niveli i aftësisë paguese të mos bjerë nën nivelin e kërkuar;

(d) borxhi me datë kthimi të pacaktuar duhet të jetë i shlyeshëm vetëm pas një njoftimi paraprak prej pesë vjetësh, me përjashtim të rastit kur borxhi në fjalë nuk konsiderohet më si pjesë përbërëse e nivelit të aftësisë paguese ose me përjashtim të rastit kur kërkohet në mënyrë specifike pëlqimi paraprak i autoriteteve kompetente për shlyerje të hershme.

Në rastin e dytë ndërmarrja e sigurimeve duhet të njoftojë autoritetet kompetente të paktën gjashtë muaj përpara datës së shlyerjes së propozuar, duke përcaktuar nivelin faktik dhe atë të kërkuar të aftësisë paguese si përpara ashtu edhe pas shlyerjes në fjalë.

Autoritetet kompetente e autorizojnë shlyerjen vetëm nëse niveli i aftësisë paguese të ndërmarrjes së sigurimeve nuk bie poshtë nivelit të kërkuar;

(e) kontrata e borxhit nuk duhet të përfshijë asnjë klauzolë e cila parashikon që në rrethanat e përcaktuara, me përjashtim të mbylljes së ndërmarrjes së sigurimeve, borxhi duhet të shlyhet përpara datës së shlyerjes për të cilën është rënë dakord më parë;

(f) kontrata e borxhit mund të ndryshohet vetëm pasi autoritetet kompetente të kenë deklaruar se nuk kanë asnjë kundërshtim për ndryshimin;

- letrat me vlerë pa datë të përcaktuar shlyerjeje dhe instrumentet e tjera që përmbushin kushtet e mëposhtme, duke përfshirë edhe aksionet progresive me përparësi përveç atyre të përmendura në nënpikën e pestë, deri në 50 për qind të nivelit për vlerën gjithsej të këtyre letrave me vlerë dhe kapitalit në formë borxhi të varur të përmendur në nënpikën e pestë:

(a) nuk mund të shlyhen me nismën e prurësit ose pa pëlqimin paraprak të autoritetit kompetent;

(b) kontrata e emetimit duhet t'i japë mundësi ndërmarrjes së sigurimeve ta shtyjë në kohë pagimin e interesit mbi borxhin;

(c) të drejtat e huadhënësit kundrejt ndërmarrjes së sigurimeve duhet të renditen tërësisht pas pretendimeve të kreditorëve jo të varur;

(d) dokumentet që rregullojnë emetimin e letrave me vlerë duhet të parashikojnë kapacitetin humbje-thithës të borxhit dhe interesit të paguar, duke i dhënë në të njëjtën kohë mundësi ndërmarrjes së sigurimeve ta vazhdojë veprimtarinë e saj tregtare;

(e) në konsideratë të merren vetëm fondet e paguara plotësisht.

2. Për aq sa lejohet në zbatim të legjislacionit kombëtar, rezervat e fitimit të paraqitura në bilanc kur këto mund të përdoren për të mbuluar humbjet që mund të lindin dhe kur kjo rezervë nuk është vendosur në dispozicion të shpërndarjes për policëmbajtësit.

3. Me kërkesën e ndërmarrjes dhe me paraqitjen e provave mbështetëse të cilat ndërmarrja ia paraqet autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar ku ka zyrën qendrore, dhe me pëlqimin e këtij autoriteti:

(a) një shumë të barabartë me 50 për qind të fitimeve të ardhshme të ndërmarrjes; shuma e fitimeve të ardhshme gjendet duke shumëzuar fitimin vjetor të çmuar me një koeficient që përfaqëson periudhën mesatare të mbetur të policave; koeficienti i përdorur nuk mund të jetë më i madh se 10; fitimi i çmuar vjetor nuk mund të jetë më i madh se mesatarja aritmetikore e fitimeve të arritura gjatë pesë viteve të fundit në veprimtarinë e renditura në nenin 2 të kësaj direktive.

Bazat për llogaritjen e koeficientit me të cilin duhet shumëzuar fitimi vjetor i çmuar dhe zërat në përbërje të fitimeve përcaktohen me marrëveshje të përbashkët nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në bashkëpunim me Komisionin.

Në pritje të kësaj marrëveshjeje, këto zëra përcaktohen në përputhje me ligjet e Shtetit Anëtar të origjinës.

Kur autoritetet kompetente të kenë përkufizuar konceptin e fitimeve të realizuara, Komisioni paraqet propozime për harmonizimin e këtij koncepti me anë të një direktive për harmonizimin e llogarive vjetore të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe për bashkërendimin e parashikuar në nenin 1 pika 2 të Direktivës 78/660/KEE;

(b) kur nuk përdoret Zillmerizimi ose kur, nëse përdoret, është më pak se tarifa për shpenzimet e marrjes në sigurim e përfshirë në prim, diferenca mes provigjionit matematikor të Zillmerizuar ose pjesërisht të Zillmerizuar dhe provigjionit matematikor të Zillmerizuar me një normë të barabartë me tarifën për shpenzimet e marrjes në sigurim të përfshirë në prim; por kjo shifër nuk mund të jetë më e madhe se 3,5 për qind e shumës së diferencave mes shumave përkatëse të kapitalit të veprimtarive të sigurimit të jetës dhe provigjioneve matematikore për të gjitha policat për të cilat është i mundshëm Zillmerizimi; diferenca zvogëlohet me shumën e çdo kostoje të paamortizuar blerjeje të regjistruar si aktiv;

(c) kur jepet miratimi nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në fjalë ku ushtron veprimtaritë ndërmarrja e sigurimeve, çdo rezervë që del si rezultat i nënvlerësimit të aktiveve dhe mbivlerësimit të pasiveve, pa përfshirë provigjionet matematikore, për aq sa këto rezerva të fshehta nuk janë të një natyre të jashtëzakonshme.

B. Niveli minimal i aftësisë paguese

Në varësi të seksionit C, niveli minimal i aftësisë paguese përcaktohet sikurse parashikohet më poshtë në përputhje me klasat e marrjes në sigurim.

(a) Për llojet e sigurimit të përmendura në nenin 2 pika 1 shkronja "a" dhe "b" me përjashtim të sigurimeve të lidhura me fondet e investimeve dhe për operacionet e përmendura në nenin 2 pika 3 të kësaj direktive, duhet të jetë i barabartë me shumën e dy rezultateve të mëposhtme:

- rezultati i parë:

një thyesë prej 4 për qind e provigjioneve matematikore të lidhura me veprimtarinë e drejtpërdrejtë dhe me risigurimin duke përfshirë edhe cedimet në risigurim dhe me pranimet në risigurim shumëzohet me raportin, për vitin e fundit financiar, të provigjioneve matematikore gjithsej pasi u janë zbritur cedimet në risigurim me provigjionet matematikore gjithsej bruto të përcaktuara më lart; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më i vogël se 85 për qind.

- rezultati i dytë:

për policat mbi të cilat kapitali në rrezik nuk është shifër negative, një thyesë prej 0,3 për qind e këtij kapitali të marrë në sigurim nga ndërmarrja e sigurimeve shumëzohet me raportin, për vitin e fundit financiar, të kapitalit gjithsej në rrezik të mbajtur si pasiv i ndërmarrjes pas cedimeve në risigurim dhe retrocedimeve mbi kapitalin gjithsej në rrezik që përfshin edhe risigurimin; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më i vogël se 50 për qind.

Për sigurimin e përkohshëm të vdekjes me afat maksimal tre vjet kjo thyesë është 0,1 për qind; për një sigurim të tillë me periudhë më të gjatë se tre vjet por jo më shumë se pesë vjet thyesa e mësipërme është 0,15 për qind.

(b) Për sigurimin shtesë të përmendur në nenin 2 pika 1 shkronja "c" të kësaj direktive, është i barabartë me rezultatin e llogaritjes së mëposhtme:

- mblidhen bashkë primet ose kontributet (duke përfshirë pagesat që u shtohen primeve ose kontributeve) të arkëtueshme në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë tregtare gjatë vitit të fundit financiar në lidhje me të gjitha vitet financiare,

- kësaj shume i mblidhim shumën e primeve të pranuar për të gjitha risigurimet gjatë vitit të fundit financiar,

- nga kjo shumë zbrësim shumë gjithsej të primeve ose kontributeve të anuluar gjatë vitit të fundit financiar si edhe shumë gjithsej të tatimeve dhe detyrimeve fiskale të lidhura me primet ose kontributet që janë futur në shumë e mësipërme.

Shuma e nxjerrë në këtë mënyrë ndahet në dy pjesë, e para deri në 10 milion euro, e dyta përbëhet nga ajo që mbetet; përkatësisht, 18 për qind dhe 16 për qind e këtyre pjesëve llogariten dhe mbledhen bashkë.

Rezultati gjendet duke shumëzuar shumë e llogaritur në këtë mënyrë me raportin ekzistues në lidhje me vitin e fundit financiar midis shumë së dëmeve që mbeten të mbulohen nga ndërmarrja e sigurimeve pasi janë zbritur transferimet për risigurimin dhe shumë bruto të dëmeve; ky raport në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 50 për qind.

Në rastin e shoqatës së marrësve në sigurim që njihet me emrin "Lloyd's", llogaritja e nivelit të aftësisë paguese bëhet në bazë të primeve neto, të cilat shumëzohen me një përqindje të sheshtë të fiksuar çdo vit nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra qendrore. Kjo përqindje e sheshtë duhet të llogaritet në bazë të të dhënave më të fundit statistikore për komisionet e paguara. Informacionet e hollësishme së bashku me llogaritjet përkatëse u dërgohen autoritetet kompetente të vendeve ku është e vendosur shoqata "Lloyd's".

(c) Për sigurimin e përhershëm të shëndetit që nuk mund të anulohet të përmendur në nenin 2 pika 1 shkronja "d" të kësaj direktive dhe për operacionet e rimarrjes së kapitalit, të përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "b" të kësaj direktive, është i barabartë me një thyesë prej 4 për qind të provigjoneve matematikore llogaritur në përputhje me kushtet e parashikuara në shkronjën "a" të këtij seksioni.

(d) Për tontinat, të përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "a" të kësaj direktive, është i barabartë me 1 për qind të aktiveve të tyre.

(e) Për sigurimet e mbuluara me nenin 2 pika 1 shkronja "a" dhe "b" të kësaj direktive të lidhura me fondet e investimeve dhe për operacionet e përmendura në nenin 2 pika 2 shkronja "c", "d" dhe "e" të kësaj direktive, është i barabartë me:

- një thyesë prej 4 për qind të provigjoneve matematikore llogaritur në përputhje me kushtet e parashikuara në shkronjën "a" të këtij seksioni, për aq sa ndërmarrja e sigurimeve mban risk investimi, dhe një thyesë prej 1 për qind të provigjoneve të llogaritura në të njëjtën mënyrë për aq sa ndërmarrja e sigurimeve nuk mban risk investimi por shpërndarja e shpenzimeve të administrimit është e përcaktuar për një periudhë më të gjatë se pesë vjet, plus

- një thyesë prej 0,3 për qind e kapitalit në rrezik, llogaritur në përputhje me kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të rezultatit të dytë të shkronjës "a" të këtij seksioni (d) për aq sa ndërmarrja e sigurimeve mbulon risk vdekjeje.

C. Fondi i garancisë

1. Një e treta e nivelit të aftësisë paguese të kërkuar sipas seksionit B përbën fondin e garancisë. Në varësi të pikës 2 të këtij seksioni, të paktën 50 për qind e këtij fondi përbëhet nga zërat e renditur në seksionin A pika 1 dhe 2.

2. (a) Fondi i garancisë nuk mund të jetë, gjithsesi, më i vogël se 800 000 milion euro.

(b) Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë që minimumi i fondit të garancisë të zvogëlohet në 600 000 euro në rastin e fondeve të përbashkëta dhe të fondeve të ngjashme me to dhe në rastin e tontinave.

(c) Për fondet kolektive të përmendura në fjalinë e dytë të nënpikës së dytë të nenit 3 pika 6 të

kësaj direktive, në momentin që bien në objektin e kësaj direktive, dhe për tontinat, çdo Shtet Anëtar mund të lejojë krijimin e në minimumi të fondit të garancisë prej 100 000 euro i cili mund të rritet progresivisht deri në shumën e vendosur në shkronjën "b" të këtij seksioni me breza prej 100 000 euro sa herë që kontributi rritet me 500 000 euro.

(d) Minimumi i fondit të garancisë të përmendur në shkronjën "a", "b" dhe "c" të këtij seksioni duhet të përbëhet nga zërat e renditur në seksionin A pika 1 dhe 2.

3. Fondet kolektive që dëshirojnë ta zgjerojnë veprimtarinë tregtare sipas kuptimit të nenit 6 pika 4 ose sipas nenit 40 të kësaj direktive nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë nëse nuk përmbushin menjëherë kërkesat e pikës 2 shkronja "a" dhe "b" të këtij seksioni.

SHTOJCA V

PJESA A

Direktivat e shfuqizuara së bashku me shtesat dhe ndryshimet e njëpasnjëshme të tyre (të përmendura në nenin 72)

Direktiva e Këshillit 79/267/KEE

Direktiva e Këshillit 90/619/KEE

Direktiva e Këshillit 92/96/KEE

Direktiva 95/26/KEE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (vetëm neni 1 nënpika e dytë, neni 2 pika 2 nënpika e katërt dhe neni 3 pika 1 për lidhjet që bëhen me Direktivën 79/267/KEE)

Direktiva 2002/12/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit

Direktiva e Dytë e Këshillit 90/619/KEE

Direktiva e Tretë e Këshillit 92/96/KEE

Direktiva e Tretë e Këshillit 92/96/KEE

Direktiva 95/26/KEE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (vetëm neni 1 nënpika e dytë, neni 2 pika 1 nënpika e tretë, neni 4 pika 1, 3 dhe 5 dhe neni 5 nënpika e tretë për lidhjet që bëhen me Direktivën 92/96/KEE)

Direktiva 2000/64/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (neni 2, për sa i takon tekstit referues që bën lidhjen me Direktivën 92/96/KEE)

Direktiva 2002/12/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (neni 2)

PJESA B

Afatet për zbatimin(të përmendura në nenin 72)

Direktiva

Afati minimal për kthimin në legjislacion të brendshëm

Afati minimal për zbatimin 79/267/KEE (GZ L 63, 13. 3.1979, fq. 1. 15 shtator 1980, 15 shtator 1981, 90/619/KEE (GZ L 330, 29.11.1990, fq. 50) 20 nëntor 1992, 20 maj 1993, 92/96/KEE (GZ L 360, 9.12.1992, fq. 1) 31 dhjetor 1993, 1 korrik 1994, 95/26/KE (GZ L 168, 18.7.1995, fq. 7) 18 korrik 1996, 18 korrik 1996, 2000/64/KE (GZ L 290, 17.11.2000, fq. 27) 17 nëntor 2002, 17 nëntor 2002, 2002/12/KE (GZ L 77, 20.3.2002, fq. 11) 20 shtator 2003, 1 janar 2004

SHTOJCA VI

Tabela e korrelacionit

